



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË BELSH

JANAR 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit përfundimtarë të Auditimit	5-5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	6-8
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-10
II.	HYRJA	10-10
1.	Objekti i auditimit.....	10-10
2.	Qëllimi i auditimit	10-10
3.	Identifikimi i çështjes	11-11
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11-11
5.	Përgjegjësitë e audituesve	11-11
6.	Kriteret e vlerësimit	12-12
7.	Standardet e auditimit	12-12
8.	Metodat e auditimit	13-13
9.	Dokumentimi i auditimit	13-13
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14
a.	Informacion i përgjithshëm	14-90
b.	Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	15-15
1.	Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditin e brendshëm	15-15
1.1	Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, Infrmimi dhe komonikimi si dhe monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.	15-26
1.2	Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik.	
1.3	Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.	
2.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit,si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.	26-26
2.1	Programimi i PBA 2018-2019-2020 dhe programimi i buxhetit vjetor 2018,2019 dhe 2020;	26-28
2.2	Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.	28-30
2.3	Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet periodike të monitorimit.	
2.4	Vlerësimi i rrisqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të ardhurave (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike të detajuara me nr. fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, ministritë e linjës etj.).	30-33

2.5	Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;	33-33
2.6	Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor e nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe nxjerrja e detyrimeve tatimore e ndarë sipas viteve.	33-47
3.	Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitet financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme”.	47-50
3.1	Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;	
3.2	Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë;	50-54
3.3	Opinionin mbi pasqyrat financiare;	54-62
4.	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla si dhe zbatimin e kontratave të punimeve	62-67
4.1	Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve;	
4.2	Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara;	67-85
4.3	Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);	
4.4	Auditim mbi hartimin zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipaskontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.	85-87
5.	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	
5.1	Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.	
5.2	Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rrillogaritja e pagesës së bërë në fazën e situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj	87-94
6.	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore .	
6.1	Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.	
6.2	Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative, dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMT.	94-96
6.3	Auditim mbi procedurat e ndjekura nga IMT lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit.....	
7.	Të ndryshme të dala gjatë auditimit.	96-96
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	96-104
V.	ANEKSET	104-114

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LP	Listëpagesa
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik

PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 971/1, datë 08.11.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 13.10.2023 deri në datën 13.11.2023, për periudhën nga 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022 në subjektin: Bashkia Belsh, u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe i Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje: Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. V. B. Përgjegjës Grupi
2. Sh H. Anëtar
3. A. V. Anëtar
4. E. S. Anëtar

Auditimi u krye mbi bazë rrishtu

Fushat mbi të cilat është shtrirë auditimi, sipas programit të auditimit, janë pasqyrat financiare, për të cilat u auditua regjistrimi i të dhënave dhe mbajtjen e kontabilitetit, saktësia e pasqyrave financiare, aplikimin e parimeve kontabël si dhe nëse transaksionet janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit, ngritja dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e njësisë së auditit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimi për të ardhurat dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave për punë publike, shërbime dhe mallra, zbatimi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm. Për këto u analizuan evidencat e marra nga subjekti i audituar, si dhe u përdorën testet e nevojshme si pjesë e procedurës së auditimit. Për pasqyrat financiare, auditimi u krye për pasqyrat e vitit 2021. Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë mbajtur 12 akte konstatimi dhe 3 akt verifikime, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit Bashkia Belsh brenda afatit të periudhës së auditimit. Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe Raportit Përfundimtar dhe janë marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat janë të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për

rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes. Mbështetur në punën audituesve në terren, në evidencat e marra të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituesve, mbështetur në Raportin Përfundimtar të auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituesve përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar të Auditimit si më poshtë.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a në raportin përfundi mtar (Nr. Fq)	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Në Bashkinë Belsh në fund të vitit 2022 rezulton të jetë debitorë në shumën 89,275,785 lekë, nga e cila:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Debitorë subjektësh fizik/juridik në vlerën 9,448,862 lekë, kjo për 160 subjekte. - Debitorë familjarë për taksë toke, ndërtese, trualli dhe tarifa vendore në vlerën 5,359,512 lekë, kjo për 1452 familje. - Debitorë të taksës së tokës bujqësore në vlerën 69,946,681 lekë, kjo për 2847 familje. - Debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë (ndërtimet pa leje), në vlerën 4,520,730 lekë, kjo për 120 persona. <p>debitorë e zënë debitorët e taksës së tokës bujqësore me 78% të totalit. Sektori i Tatimit Taksave Vendore në Bashkinë Belsh, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe asnjë procedurë tjetër, ku dhe kjo procedurë që në fillimet e saj rezulton e dështuar pasi sidomos për abonentët familjarë nuk kanë të deklaruar pranë sektorit të taksave nr. llogarie bankare për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime ne llogarit bankare;</p>	Fq 41-48	E lartë	<p>Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Belsh të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizikë/juridikë e abonentët familjarë në rezulton se në fund të vitit 2022 ato janë në shumën 89,275,785 lekë, nga e cila:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Debitorë subjektësh fizik/juridik në vlerën 9,448,862 lekë, kjo për 160 subjekte. - Debitorë familjarë për taksë toke, ndërtese, trualli dhe tarifa vendore në vlerën 5,359,512 lekë, kjo për 1452 familje. - Debitorë të taksës së tokës bujqësore në vlerën 69,946,681 lekë, kjo për 2847 familje. - Debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë (ndërtimet pa leje), në vlerën 4,520,730 lekë, kjo për 120 persona. <p>debitorë e zënë debitorët e taksës së tokës bujqësore me 78% të totalit, duke ndjekur rrugët ligjore.</p>

	<p>- T'i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);</p> <p>- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;</p> <p>- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjekte nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe "Sektori Juridik", të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</p>			
2	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të hidrokarbureve (pikë shitje karburanti), rezulton se në këtë njësi vendore ushtrojnë aktivitet 7 subjekte të cilat janë pajisur me autorizim për tregtim karburanti, por që nuk kanë likuiduar të plotë vlerën e tarifës së autorizimit në shumën 5,800,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Belsh, konkretisht: Subjekti "M. -V." shpk, në shumën 600,000 lekë; Subjekti "H." shpk në shumën 600,000 lekë; Subjekti "M. O." shpk në shumën 600,000 lekë; Subjekti "Z." shpk në shumën 1,000,000 lekë; Subjekti "D. O." në shumën 1,000,000 lekë; Subjekti "G. O." shpk në shumën 1,000,000 lekë dhe Subjekti "D. O." shpk në shumën 1,000,000 lekë.</p> <p>Veprime në kundërshtim me VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar", kreu II, pika 3</p>	Fq 77-83	E mesme	<p>Sektoria e Ardhurave vendore Bashkia Belsh, të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën në ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, të papaguara nga 7 subjektet në vlerën 5,800,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Belsh, konkretisht:</p> <p>Subjekti "M.V."shpk, në shumën 600,000 lekë.</p> <p>Subjekti "H." shpk në shumën 600,000 lekë.</p> <p>Subjekti "M.O." shpk në shumën 600,000 lekë</p> <p>Subjekti "Z." shpk në shumën 1,000,000 lekë</p> <p>Subjekti "D. O." në shumën 1,000,000 lekë</p> <p>Subjekti "G." shpk në shumën 1,000,000 lekë.</p>
3	<p>Nga auditimi u konstatua se, në bashkinë Belsh nga auditimi u konstatua se, duke analizuar analitikun e paraqitur nga Drejtoria e Financës për llogarinë nr. 468 "Debitorë të ndryshëm nga sistemi i taksave dhe tarifave vendore r</p>	Fq 53-58	E lartë	<p>Drejtorja e Financës Bashkia Belsh, të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të</p>

	Bashkinë Belsh konstatohet se vlera debitorëve të nxjerrë nga Klsh (vetëm për taks dhe tarifatat që mbliidhen nga Drejtoria Taksave) për vitin 2020 dhe 2021 për 11 subjekte është në shumën prej 8,391,446 lek Shumë kjo, e cila nuk është e pasqyruar në bilanc, në llogarinë nr.468 “Debitorë ndryshëm”.			Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në shumën prej 8,391,446 lekë, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.
4	Nga auditimi u konstatua se , nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Marrje me qera mjete për sistemimin, asfaltimin e rrugëve të fshatit Idrizaj dhe fshatit Hardhi” me fond limit 739,900 lekë pa t.v.sh u konstatua se OE fitues, “HB G. C. Sh.P.K” nuk ka objekt të aktivitetit të tij dhënien me qira të mjeteve për sistemimin, asfaltimin e rrugëve.	Fq 40-42	E lartë	Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla në Bashkinë Belsh të ndjek procedurat e prokurimit në zbatim të përcaktimeve ligjore
5	Nga auditimi u konstatua se , janë transferuar në Bashkinë Belsh 13 ekonomi pyjore/kullosore.Nga këto janë regjistruar vetëm 7 ekonomi pyjore, ndërsa 6 ekonomi, nuk janë regjistruar në DVASHK Belsh veprime jo në përputhje të VKM-së, nr. 433 datë 08.06.2006 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit”, të ndryshua dhe nga ana e bashkisë, sektori i pyjeve nuk janë marrë masa për të miratuar plane mbarështimi për menaxhimin e tyre me qëllim dhënien në përdorim,sipas parashikimeve të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” dhe Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.	Fq 35-37	E Lartë	Titullari i Institucionit në bashkinë Belsh në bashkëpunim me Drejtorinë e pyjeve/kullota, të marri masa për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim dhe regjistrimin e ekonomive pyjore, të një numri të madhe të pronave të pa inventarizuara dhe të pa reregjistruara, çka bën të pa qartë numrin e pronave sipas listave të inventarëve, pronë të bashkisë, për verifikim në terren në nëse këto prona janë të lira të zaptuara ose dhe të tjetërsuara nga palë të treta.
6	Nga auditimi u konstatua se, miratimit i procedurave të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 3 rastet e audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, më konkretisht: -Për objektin “Objekt banimi 2 kate dhe 1 kat nëntokë”; -Për objektin “Banesë 2 kate me çati të pashfrytëzueshme +podrum”; -Për objektin “Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore”, mungon studimi sizmik dhe gjeologjik, kjo në kundërshtim me			Nga DPKZHT Belsh të merre masa për të kërkuar studimi sizmik dhe gjeologjik të projekti në çdo rast që aplikohet për të pajisur me leje ndërtimi.

	VKM nr. 1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi",			
7	Nga auditimi u konstatua se, për procedurat miratimit të certifikatave të përdorimit konstatua se në 2 raste, dokumentacioni nevojshëm për pajisje me certifikatë përdorin nuk është i plotë, më konkretisht: -Për objektin "Certifikatë përdorimi për godin shërbimi 1 kat, fabrika përpunimi të ullirit dhe kantinë për prodhimin e rakisë", mungon akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane. -Për objektin "ndërtim magazinë 1 kat+ndërtim ekspozite 2 kat", mungon akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane.	Fq33-47		Titullari i Institucionit në bashkinë Belsh në bashkëpunim me Drejtorinë e pyjeve/kullota, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim dhe regjistrimin e ekonomive pyjore, të një numri të madhe të pronave të pa inventarizuara dhe të pa reregjistruara, çka bën të pa qartë numrin e pronave sipas listave të inventarëve, pronët bashkisë, për verifikim në terren në nëse këto prona janë të lira të zaptuara ose dhe të tjetërsuara nga palë të treta.

3. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare të vitit 2022

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Belsh për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion **të modifikuar me rezerve** për llogaritë vjetore të Bashkisë Belsh, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2022 të shprehura në bazën për opinion.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-nr. 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit për shpenzimet e vitit 2022 prej 11.9 milion lekë, si dhe anomalitë e konstatuara, si vijon:

-Ilogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në vlerën 8,391,446 lekë, është e pa pasqyruar në bilanc;
-Ilogaria 202 “*Studime dhe Kërkime*” vlerën projekti është dhuratë me marrëveshje bashkëpunimi, por nuk është kryer regjistrimi në kontabilitet.

II. Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë.

Në kemi audituar përputhshmërinë e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmerisë të ligjeve rregullave dhe rregulloreve, termave apo kushteve të vendosura, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në përfundim rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar (modifikuar) të përputhshmërisë, të shprehura këto në bazën e opinionit.

Baza për opinion e kualifikuar (modifikuar)

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë*”, pjesë e projekt raportit tonë. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit dhe materialitet, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Në procesin e zbatimit të buxhetit për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Belsh. Nga auditimi i dokumentacionit mbi detyrimet e taksave/tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë, rezulton se në fund të vitit 2022 ato janë në shumën 89,275,785 lekë, nga e cila:

- Debitorë subjektësh fizik/juridik në vlerën 9,448,862 lekë, kjo për 160 subjekte.

- Debitorë familjarë për taksë toke, ndërtese, trualli dhe tarifa vendore në vlerën 5,359,512 lekë, kjo për 1452 familje.

- Debitorë të taksës së tokës bujqësore në vlerën 69,946,681 lekë, kjo për 2847 familje.

- Debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë (ndërtimet pa leje), në vlerën 4,520,730 lekë, kjo për 120 persona.

Nga të dhënat e mësipërme peshën më ta madhe për detyrimet debitorë e zënë debitorët e taksës së tokës bujqësore me 78% të totalit. -Nuk është hartuar regjistri i taksapaguesve familjarë dhe privat për taksën mbi tokën bujqësore, duke mos evidentuar në mënyrë të saktë të ardhurat reale dhe detyrimet për këtë taksë.

Në një rast, në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar anomali në hartimin e kriteve të veçanta të dokumenteve të tenderit dhe në kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorit ekonomik.

-Nuk është kryer inventarizimi i asetëve (pronave) të bashkisë dhe nuk janë marrë masa për regjistrimin e tyre në ASHK.

- Nuk ka regjistër kontabël për këto pasuri, si dhe për të gjitha aktivet e tjera të njësisë vendore.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Belsh: Strukturat drejtuese të Bashkisë Belsh janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullat në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Belsh janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për drejtimin dhe për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së: Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme³, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II.HYRJE

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Belsh kishte si objektiva kryesore: Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Belsh është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Belsh dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
 - Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.04.2020-31.12.2022.
 - Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
 - Mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Belsh
 - Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Bashkinë Belsh

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Belsh, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Belsh është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Belsh. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, u ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- V.K.M nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”;
- V.K.M nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Belsh grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Belsh me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënive mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Belsh

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit,

² ISSAI 1315

³ *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit*

të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Belsh, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Belsh etj. Aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Belsh.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Bashkia e re e Belshit kufizohet në veri me bashkinë Peqin, në lindje me bashkinë Cërrik, në jug me Bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me Bashkinë Lushnje. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Belshit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 19,503 banorë dhe densitet prej 99.28 banorë për km², ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki ka një popullsi prej 32.389 vetë dhe densitet prej 168.88 banorë për km². Sipërfaqja e bashkisë së re është 196,44 km².

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Belshi, Grekani, Kajani, Fierza dhe Rrasa. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 34 fshatra.

b. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Në zbatim të pikës nr.1. i të programit të auditimit nr. 971/1, datë 08.11.2023:

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.”

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Baza ligjore ku mbështetet auditimi mbi MFK është:

Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar

“Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016;

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar

Ligji nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018

VKM nr.710/2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”

VKM nr.117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelite të regjistrimit qendror të personelit”.

Në zbatim të **nënpikës 2.1** të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:
1. Procedurat për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara;

2. Vendimi për miratimin e strukturës organizative. Ndryshimet në strukturë për periudhën objekt auditimi nëse ka pasur, dhe nëse po, a është reflektuar edhe në rregullore;
3. Rregullorja e brendshme e miratuar, rregulla të brendshme të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.
4. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
5. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
6. Lista ose harta e proceseve të punës;
7. Koordinatorin për të drejtën e informimit;
8. Raportet e monitorimit, deklaratat dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
9. Pyetësi i Vetëvlerësimit

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.

Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Belsh, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtuëshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Poliçan si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë jo mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të MFK-së në mënyrë të detajuar argumentohet si më poshtë vijim:

1. MJEDISI I KONTROLLIT. Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

Mjedisi i kontrollit. (Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010) -Bashkia Belsh, ka ushtruar veprimtarinë e sajë me rregulloren e vitit 2016 rregullore e cila është miratuar me Vendim nr. 325 datë 29.08.2016, rregullore e cila është përditësuar në Janar 2022“ të Kryetarit të Bashkisë z. A. T.

Për vitin 2022 numri i punonjësve është miratuar me Vendimin nr. 68 e Këshillit Bashkiak, datë 24.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”, shkresa nr. 63 prot, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1441/1 prot., datë 07.01.2022 dhe niveli i pagave është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 66 datë 24.12.2021, “konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan, me shkresën nr. 1420/1 prot., datë 06.01.2022.

-Konstatohet se struktura organizative nuk ka pasur ndryshime nga viti në vit si dhe nga ana e drejtorive apo sektorëve janë hartuar rregullore të veçantë të funksionimit të tyre sipas kërkesave të nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

✓ **Njësia publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlera etike.**

- Nëpunësit e Bashkisë Belsh duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” e Punës.

Nga bashkia raportohet se nuk ka pasur raste të shkeljes së etikës.

-Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë Bashkisë ato depozitohen në zyrën e marrëdhënieve me publikun, e cila i adreson tek kryetari i bashkisë dhe përgjigja kthehet nga zyra përkatëse, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Kjo procedurë është e përfshirë në nenin 20 të Rregullores së brendshme.

-Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë”, vlerësimi i punonjësve kryhet në periudha 6 mujore, me këtë procedurë merren burimet njerëzore.

Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës, drejtuar Titullarit (NA) dhe raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit për KB, analizës së veprimtarisë të Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkrjetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë.

- Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale e protokoll.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

Konstatim-Nga ana e bashkisë Belsh nuk bëhen raportime mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike si dhe veprime këto që bien ndesh me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

✓ **Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.**

✓ - Për bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

- Bashkia Belsh ushtron veprimtarinë e sajë me rregulloren e brendshme të vitit 2016, rregullore e cila është miratuar me Vendim nr. 325 datë 29.08.2016

Konstatim

-Njësia publike nuk ka të përcaktuar në dokumentin e strategjisë një plan konkret për monitorimin dhe arritjen e objektivave.

- **Për vitin 2022** numri i punonjësve është miratuar me Vendimin nr. 68 e Këshillit Bashkiak, datë 24.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”, shkresa nr. 63 prot, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1441/1 prot., datë 07.01.2022 dhe niveli i pagave është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 66 datë 24.12.2021, “konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan, me shkresën nr. 1420/1 prot., datë 06.01.2022.

-Organigrama e Bashkisë Belsh është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 2 nënkryetarët, drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me Administratorët e NJA si dhe Titullarët e institucioneve të varësisë varen direkt nga Kryetari i Bashkisë, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në vijë horizontale.

Ndërsa në nivelin më të ulët si specialist, përgjegjës sektori, llogaridhënia është në vijë vertikale.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë së saj. Për çdo drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialisti.

-Bashkia Belsh ka faqen e saj zyrtare në ëeb në të cilën janë paraqitur të gjitha informacionet e njësive vendore si dhe dokumentet e rëndësishme.

Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

-Nëpunësit e Bashkisë Belsh i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist, me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij.

Për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit (inspektor terreni, punonjës bujqësie, topograf, inxhinier pyjesh, inspektor pyjesh, punonjës sporti, punonjës shërbimi etj.) i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Konstatim

Nga auditimi, dokumentacioni dhe informacioni i marë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore rezultoi se;

Rekrutimi i punonjësve me status të nëpunësit civil nuk është kryer në përputhje Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Nga 71 vende pune me statusin e nëpunësit civil, vetëm 54 punonjës kanë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në vendin e punës dhe kategorisë që i korrespondon.

U konstatua se 17 vendet që janë vakante në pozicionin e nëpunësit civil janë plotësuar me punonjës të cilët nuk i përjasin kategorisë së vendeve vakante por thjeshtë janë punësuar për të plotësuar numrin e punonjësve i cili është miratuar me Vendimin nr. 68 të Këshillit Bashkiak, datë 24.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”.

71 vende pune me statusin e nëpunësit civil, paraqite më poshtë:

1 pozicion i kategorisë së lartë

7 pozicione të kategorisë së mesme drejtues (1 vakant)

17 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (5 vakant)
 46 pozicione të kategorive ekzekutive (11 vakant)
 Vendet vakante me statusin e nëpunësit civil janë plotësuar si më poshtë vijon:
 1 pozicion i kategorisë së lartë (1 Nëpunës Civil)
 7 pozicione të kategorisë së mesme drejtues (1 Nëpunës Civil) dhe (1 Kod Pune i cili është ish Drejtori Ndihmës Ekonomike dhe nga Tetori 2022 Drejtor i Emergjencës Civile). Vlen të theksohet se për këtë vënd pune nuk është bërë kërkesë për shpallje për vend të lirë pune Institucionit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Titulli i gjetjes	Parregullsi në plotësimin e vendeve vakante të cilat janë më status të nëpunësit civil
Situata:	<p>- Nga auditimi, dokumentacioni dhe informacioni i marë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore rezultoi se; Rekrutimi i punonjësve me status të nëpunësit civil nuk është kryer në përputhje Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se: Nga 71 vende pune me statusin e nëpunësit civil, vetëm 54 punonjës kanë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në vendin e punës dhe kategorisë që i korrespondon. U konstatua se 17 vendet që janë vakante në pozicionin e nëpunësit civil janë plotësuar me punonjës të cilët nuk i përkasin kategorisë së vendeve vakante por thjeshtë janë punësuar për të plotësuar numrin e punonjësve i cili është miratuar me Vendimin nr. 68 të Këshillit Bashkiak, datë 24.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022” 71 vende pune me statusin e nëpunësit civil, paraqite më poshtë: 1 pozicion i kategorisë së lartë 7 pozicione të kategorisë së mesme drejtues (1 vakant) 17 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (5 vakant) 46 pozicione të kategorive ekzekutive (11 vakant) Vendet vakante me statusin e nëpunësit civil janë plotësuar si më poshtë vijon: 1 pozicion i kategorisë së lartë (1 Nëpunës Civil) 7 pozicione të kategorisë së mesme drejtues (1 Nëpunës Civil) dhe (1 Kod Pune i cili është ish Drejtori Ndihmës Ekonomike dhe nga Tetori 2022 Drejtor i Emergjencës Civile). Vlen të theksohet se për këtë vënd pune nuk është bërë kërkesë për shpallje për vend të lirë pune Institucionit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. 17 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (12 Nëpunës Civil) (5 Kod Pune nga të cilët 1 Përgjegjës Ndihmës Ekonomike, 1 Përgjegjës One Stop Shop, 1 Përgjegjës i Kulturës, 1 Përgjegjës i Shërbimeve, 1 Përgjegjës i Arsimit të Bashkisë) 46 pozicione të kategorive ekzekutive (35 Nëpunës Civil) (11 Kod Pune të cilët janë punësuar në vende jo korrespondente me vendet vakante)</p>
Kriteri:	<p>- Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” - Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti	Risk për realizimin e detyrave sipas funksioneve të përcaktuara në strukturën e Bashkisë Belsh.
Shkaku	Plotësimi numrit të punonjësve të Bashkisë Belsh sipas strukturës fakt dhe jo sipas detyrave funksionale të tyre.
Rëndësia	E Lartë

Rekomandim	Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Belsh të marrë masa për rekrutimin e punonjësve dhe plotësimin e vendeve vakante sipas detyrave funksionale nëpërmjet shpalljeve në Shërbimin Kombëtar të Punësimit.
-------------------	---

pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (12 Nëpunës Civil) (5 Kod Pune nga të cilët 1 Përgjegjës Ndihmës Ekonomike, 1 Përgjegjës One Stop Shop, 1 Përgjegjës i Kulturës, 1 Përgjegjës i Shërbimeve, 1 Përgjegjës i Arsimit të Bashkisë)
46 pozicione të kategorive ekzekutive (35 Nëpunës Civil) (11 Kod Pune të cilët janë punësuar në vende jo korrespondente me vendet vakante)

Konstatim

-Për sa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, punonjësit e Bashkisë Belsh nuk kanë kryer trajnime për përmirësimin e aftësitësive të tyre profesionale, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neni nr. 42, pika nr. 3, i cili thekson “Nëpunësi civil ka detyrimin të përmirësojë aftësitë profesionale nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike.”

Titulli i gjetjes	Mungesa e kryerjes së trajnimeve për përmirësimin dhe formimin e aftësitë profesionale.
Situata:	- Nga auditimi u konstatua se për sa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, punonjësit e Bashkisë Belsh nuk kanë kryer trajnime për përmirësimin e aftësive të tyre profesionale, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neni nr. 42, pika nr. 3, i cili thekson “Nëpunësi civil ka detyrimin të përmirësojë aftësitë profesionale nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike.”
Kriteri:	- Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil”
Ndikimi/Efekti	Mos ngritja profesionale e punonjësve.
Shkaku	Neglizhencë për kryerjen e trajnimeve.
Rëndësia	E Mesme
Rekomandim	Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Belsh të marrë masa dhe të nxisë përmirësimin e aftësive dhe formimit profesional të punonjësve në Bashkinë Belsh nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.

Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç për integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

- Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, si dhe të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e programit Buxhetor afatmesëm vendor 2023 – 2025” është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si më poshtë:

1. M. Ç. (Kryetar), 2. A. N. (Sekretar), 3. A. B, 4. I. H, 5. D. P, 6. A. S, 7. A. H, 8. Q. R, 9. N. Q, 10. O. N, 11. A. U, 12. A. H, 13. D. A, 14. N. Q, 15. D. H, 16. R. P, 17. K. G, 18. B. H.

Konstatim

Konstatohet se në përbërje të GMS nuk është as Kryetari i Bashkisë Belsh dhe as Nënkryetarët e saj, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Neni nr. 27, pika nr. 2, “Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje”.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Belsh nuk është as Kryetari i GMS, veprime këto në kundërshtim me “Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 2.2.6., “GMS përbëhet nga titullari i njësisë (i cili është gjithashtu kryetar i grupit), zëvendës titullarët, NA, NZ dhe nga të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë (niveli me i lartë në vartësi të organizimit të njësisë publike).

Gjithashtu është konstatuar se nuk është bërë asnjë delegim detyre nga ana e Titullarit dhe nënkryetarëve të Bashkisë Belsh.

-Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Nga ana e Bashkisë Belsh ekzistojnë rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, veprime këto në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II.

Titulli i gjetjes	Parregullsi në ngritjen e Grupit të Menaxhimit Financiar sipas funksioneve përkatëse.
Situata:	- Nga auditimi se për sa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, punonjësit e Bashkisë Belsh nuk kanë kryer trajnime për përmirësimin e aftësive të tyre profesionale, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neni nr. 42, pika nr. 3, i cili thekson “Nëpunësi civil ka detyrimin të përmirësojë aftësitë profesionale nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike.”
Kriteri:	- Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil”
Ndikimi/Efekti	Mos ngritja profesionale e punonjësve.
Shkaku	Neglizhencë për kryerjen e trajnimeve.
Rëndësia	E Mesme
Rekomandim	Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Belsh të marrë masa dhe të nxisë përmirësimin e aftësive dhe formimit profesional të punonjësve në Bashkinë Belsh nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.

2. MENAXHIMI I RISKUT

Njësia publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontroleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut. Koordinator i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinator i Riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike.

Menaxhimi i riskut mundëson vendim marrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura. Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të silllet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

Konstatim-Bashkia Belsh nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut si dhe nuk janë përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut.

Gjithashtu Bashkia Belsh nuk ka identifikuar dhe krijuar një regjistër risku. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, si dhe “Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II, pika 2.5.2, “Menaxhimi i riskut”.

Titulli i gjetjes	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e MFK .
Situata:	<ul style="list-style-type: none"> - Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se: - Bashkia Belsh për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 deri 31.12.2022 nuk ka hartuar Regjistrin e Riskut. - Referuar mbledhjeve të GMS konstatohet se nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citohet se; “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që kandryshime thelbësore të mjedisit të riskut”. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si silllet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. - GMS në Bashkinë Belsh nuk është mbledhur dhe marrë vendime të cilat duhet të jenë në interes të publikut në përputhje me standardet në sektorin Publik, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësinë publike”, Pika 2.2.4, “Roli i GMS në sistemin e MFK” pika 3, “GMS duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit.”
Kriteri:	- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe

	Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin - - Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”
Ndikimi/Efekti	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e MFK , ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm, duke riskuar përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve financiare publike. Gjithashtu ka ndikuar negativisht në performancën institucionale për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë.
Shkaku	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor nga titullari i Institucionit, Nëpunësi Autorizues dhe personat e tjerë përgjegjës për MFK.
Rëndësia	E Mesme
Rekomandim	- Nga Titullari i Bashkisë Belsh, të merren masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. - GMS duhet të kryej mbledhje periodike dhe të marrë vendime të cilat duhet të jenë në interes të publikut në përputhje me standardet në sektorin Publik

3. AKTIVITET E KONTROLLIT. Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, përfshirë edhe shitjen e pronës, urdhër-shërbimet, dhe kryerja e pagesës, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa. Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit. Sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare. Të gjithat angazhimet likuidimet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues.

Sipas Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, parashikohet se: Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës. Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës.

Titullarët e njësisë kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi.

Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese.
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi.
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive.

- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, që duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit.
- Procedurat e sinjalizimit.

Konstatim

Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 20.

4. MONITORIMI

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efçente me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të brendshëm. Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetësonin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës. Në deklaratë, Nëpunësi Autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar. Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm. Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

Me shkresën nr. 627 prot., datë 28.02.2023, nga Bashkia Belsh është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

Me shkresë nr. 627 prot., datë 28.02.2023, Bashkia Belsh ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësonin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli, në përputhje me Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli

V, Shtojca 2 “Pyetësoni i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Konstatim

Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III.

5. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjësi të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Duhet Theksuar se në Bashkinë Belsh shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

Titulli i gjetjes	Mangësi në funksionimin e sistemit të MFK dhe mosfunksionimi i sistemeve të kontrollit.
Situata:	<p>- Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me komponentët e MFK-së si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen. - Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm. - Nuk janë përcaktuar objektivat konkret, të matshëm, për secilën drejtori

	<p>sipas funksioneve që ato mbulojnë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve të përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij. - Bashkia Belsh nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. - Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. - Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. - Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. - Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. - Nuk ka sektor të auditit të brendshëm, për rrjedhojë nuk ka vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin - Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” - Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Belsh dhe Njësive Administrative”, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 325, datë 09.08.2016.
Ndikimi/Efekti	Mosnjohje e plotë dhe sa duhet i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Shkaku	Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të MFK dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.
Rëndësia	E Mesme
Rekomandim	<ul style="list-style-type: none"> - Nga Titullari i Bashkisë Belsh, të merren masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij. - Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

6. AUDITI I BRENDSHËM

Konstatim

Bashkia Belsh nuk ka përcaktuar edhe miratimin strukturës së punës për Njësinë e Auditit të

Brendshëm. Sipas informacionit të paraqitur nga personi përgjegjës, kjo ka ardhur si shkak i mungesës së kapaciteteve njerëzore për të kryer këtë detyrë pranë kësaj bashkie. Gjithashtu nuk është lidhur asnjë marrëveshje me njësi tjera publike të cilat kanë njësi auditit të brendshëm dhe kapacitete të nevojshme për kryerje të auditit të brendshëm, kjo në kundërshtim me nenin 10 pika c të ligjit me nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, dhe nenin 6 pika a të VKM-së me nr. 83 datë 03.02.2016 “Për Miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Titulli i gjetjes	Mbi mos krijimin dhe mosfunksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik.
Situata:	- Bashkia Belsh, nuk ka strukturë funksionale për kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm. - Kryetari i Bashkisë Belsh, në mungesë të strukturës funksionale të auditit të brendshëm, nuk ka marrë masa për të lidhur marrëveshje me njësi tjera publike që kanë audit të brendshëm, për të realizuar kryerjen e shërbimit të auditimit të njësisë.
Kriteri:	- Ligji nr. 114/2015 "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" - VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.
Ndikimi/Efekti	Sistem jo funksional i kontrollit të brendshëm, duke mos dhënë siguri titullarit për aktivitetet kryesore të veprimtarisë së institucionit.
Shkaku	Mosnjohje e ligjit nr. 114/2015 "Për auditin e brendshëm në sektorin publik. Mos shpallja e vakancës për vendin e punës së audituesit të brendshëm.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa për organizimin e shërbimit të Auditimit të Brendshëm, në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor, në Bashkinë Belsh, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.3. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.4. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

2.5. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të programit të auditimit,

Sipas Çështjet e audituara sipas pikës së programit:

1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2022;
2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;
3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;
4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të ardhurave; (Faturat e

palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF)

5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHS, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.
6. Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

Dokumentacioni i audituar si më poshtë:

1. Dokumentacioni i hartimit të programeve buxhetore afatmesme PBA 2023-2025 miratimet e PBA-ve dhe korrespondenca.;
2. Dokumenti i programimit buxhetit vjetor për vitin 2022 të miratuara me VKB, fondet e transferues së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë këtyre viteve buxhetore.;
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Belsh për shpenzimet dhe të ardhurat;
4. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve si fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore.
5. Dokumentacionet e hartuara periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022;
6. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet te ardhurat etj.)
7. Evidencat e realizimit të planit të vitit 2022 për të ardhurat vendore.
8. Regjistrat dhe dosjet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Belsh.
9. Regjistrat e subjekteve debitorë.
10. Të tjera dokumente mbështetëse.

Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

1.Programimi i PBA 2023 - 2025 dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

-Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023 - 2025, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve me nr.29 dt.08.04.2023.

-Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si menaxhimi i mbetjeve dhe shërbimeve publike, pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, mirëmbajtja e segmenteve rrugore, programi i administrimit të pyjeve dhe bujqësisë, mirëmbajtja e kushteve për infrastrukturën arsimore, konvikteve, promovimi i politikave kulturore dhe sociale, zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe ekspozitave. Është bërë analiza për pagat dhe janë llogaritur pesha specifike e këtyre llojeve të shpenzimit me totalin.

-Fushat me prioritet në shpenzimet për investime:

- a. Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit
- b. Ndërtimi i veprave publike (ujësjellës)
- c. Rikonstruktion të objekteve shkollore.
- d. Mirëmbajtje të rrugëve dhe ndriçimi i tyre.
- e. Ndërtime për park lojërash për qytetin.

Këto programe buxhetore afatmesme janë hartuar bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të qeverisjes vendore”. Janë organizuar seanca dëgjimore me qytetarët si dhe nuk është prezantuar dokumenti i PBA me shoqërinë civile. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, sektorët e Bashkisë, Sektori i Shërbimeve etj. gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktik të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative, sektorët e Bashkisë, sektori i shërbimeve etj. gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktik të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

PBA dhe buxheti vjetor 2022 janë miratuar në Këshillin Bashkiak, konkretisht:

PBA 2023 – 2025 është dhe buxheti vjetor 2022, është miratuar me VKB nr.63, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.1441 datë 07.01.2022.

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2022	
		Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti parardhës	26,722,365.99	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti parardhës	27,895,725.29	
3	Trashëguar nga transfera specifike	4,716,002.00	
4	Të trashëguara nga FZHR	0.00	
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	102,000,000.00	
6	Granti	124,982,705.00	
7	Transferta e kushtëzuar	466,656,942.00	
8	Transferta specifike	66,970,165.00	
9	Shtesë transfera specifike 2022	4,856,877.00	
10	Shtesë grandit për vitin 2022	8,559,000.00	
11	Trashëgimi pa destinacion	0.00	
12	Fonde nga OJF	22,197,328.00	
13	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)	151,950,620.00	140,820,360.00
14	Shpenzime operative (602)	90,797,188.05	68,248,594.00
15	Investime (230+231)	302,835,121.09	232,954,621.00
16	Shpenzime (603+604)	14,511,781.14	4,978,468.00
17	Transfertë e kushtëzuar (606)	295,462,400.00	288,324,996.00
Totali i buxhetit		855,557,110.28	735,327,039.00

Tabela a1: Planifikimi i të ardhurave & Shpenzimeve

Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023 - 2025 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Plan përfundimtar 2022	Sipas PBA 2023 - 2025	Diferenca
1	Shpenzimet për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	159,469,932.00	161,664,512.70	-2,194,580.00
2	Shpenzimet (602, 604, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	80,700,495.00	86,326,237.14	-5,625,742.00
3	Investime – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	57,789,443.00	62,132,774.74	-4,343,331.74
4	Transfertë e kushtëzuar, ndihma ekonomike	48,559,000.00	79,521,240.00	-30,962,240.00
Total i planit fillestar		346,518,870.00	389,644,764.58	-43,125,893.74
Shtesat dhe ndryshimet gjatë vitit				
5	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	-7,519,312.00	0.00	
6	Shpenzime (602, 604, 606,609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	271,511,874.19	0.00	
7	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	60,241,076.00	0.00	
Totali shtesa + ndryshime		324,233,638.19	0.00	0.00
Plani përfundimtar				
8	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	151,950,620.00	161,664,512.70	-2,194,580.00
9	Shpenzime (602, 604,606, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	400,811,369.19	165,847,477.14	234,963,892.05
10	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	118,030,519.00	62,132,774.74	55,897,745.00
11	Investime nga FZSH	148,085,810.00	0.00	148,085,810.00
12	Pagesa 5 % garanci	7,301,607.00	0.00	7,301,607.00
13	Donacione	22,197,328.00	0.00	22,197,328.00
Shuma e planit vjetor		848,377,253.19	389,644,764.58	466,251,802.05

Tabela a2: Plani Përfundimtar dhe PBA

2.Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të celura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Qeverisja Qendrore të granteve nëpërmjet transfertës të pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet

për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të KB.

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr. datë	Vlera	Nr.datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli				
					Shtesa.Art.	Shuma	Pakësim.Art.	Shuma	
Viti 2022	VKB nr.63 24.12.2021	293,952,87 0	Shtese Buxheti		602	8,930,164.05		8,930,164.05	
			V.K.B.nr.05 date 31.01.2022	59,334,093.28	604 230 231	3,446,653.14 500,000.00 46,457,276.09		3,446,653.14 500,000.00 46,457,276.09	
			Shkrese titullari nr.773 dt.11.03.2022	280,000	604	280,000	602	280,000	280,000
			VKB nr.24 dt.15.03.2022	4,238,193	231	4,238,193			0
			VKB nr.23 dt.15.03.2022	3,000,000	231	3,000,000	602 230 231	2,313,000 200,000 487,000	
			Shkres nr.1661 dt.08.06.2022	30,000	606	30,000	600	30,000	30,000
			Shkres nr.1897 dt.04.7.2022	1,000,000	602	1,000,000	600	1,000,000	1,000,000
			VKB nr.38 dt.08.06.2022	36,992,992	602 230 231	1,000,000 1,000,000 34,992,992	602 231	2,017,000 34,975,992	
			Shkres nr.1969 dt.12.07.2022	14,177,256	602	14,177,256	600	14,177,256	
			VKB nr.45 dt.06.07.2022	2,956,200	602	2,956,200	231	2,956,200	
			Shkres nr.2104	330,000	604	330,000	602	330,000	
			VKB nr.48 dt.18.07.2022	2,000,000	231	2,000,000	602 231	112,807 1,887,193	
			Shkres nr.2704 dt.29.09.2022	5,000	606	5,000	604	5,000	
			Shkres nr.2705 dt.29.09.2022	30,000	606	30,000	600	30,000	
			Shkres nr.2854 dt.13.10.2022	6,500,000	600 602	6,000,000 500,000	600 602	500,000 6,000,000	
			VKB nr.59 dt.14.10.2022	14,400,000	231	14,400,000	231	14,400,000	
			Shtese fondi arsimit VKB nr.53 dt.30.09.2022	618,684	600 601	530,150 88,534			
			Shtese Grandi VKB nr.67 dt.21.12.2022	8,559,000	231	8,559,000			
			Shkrse nr.3721 dt.30.12.2022	3,660,000	606	3,660,000	600 602	1,900,740 1,759,260	
			Totali Viti 2022			158,111,418.28			

Në lekë

-Në hartimi e projekt buxhetit vjetor, nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Belsh dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga sa më sipër konstatojmë se janë kryer ndryshime të vazhdueshme, **ku në vitin 2022** kanë ndodhur ndryshime me vlerë **158,111 mijë lekë**, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit 2022 kanë pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

3.Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Elbasan, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Elbasan, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transferta e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2022 referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në 000/lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
1	600 – Paga	131,208.55	122,371.03	93
2	601 – Sigurime shoqërore	20,742.10	18,449.33	89
3	602 – Shpenzime operative	90,797.20	68,248.60	75
4	Totali shpenzime të tjera – (606, 604, 609)	309,974.20	293,303.50	95
5	Investimet (230 + 231)	302,835.12	232,954.62	77
Totali		855,557.17	735,327.08	85.8

Tabela a4: Plan-Fakt Buxheti 2022

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit rezulton nga 75 % deri në 95 %, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit nuk planifikohen mbi nevojat që Bashkia Belsh ose realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara. Peshën specifike më të madhe në buxhet në raport me totalin e zënë shpenzimet e tjera, ndjekur nga investimet.

Nr.	Përshkrimi	Përqindja në raport me totalin
		Viti 2022
1	Shpenzimet operative	10
2	Investime	35
3	Shpenzime për pagat	15
4	Shpenzime për sigurime Shoqërore	2.5
5	Të tjera shpenzime	37.5

Tabela a5: Përqindja e zërave në raport me totalin

Nga grupi i KLSH konstatohet se, niveli i realizimit të investimeve të planifikuara për vitin **2022** paraqitet në masën **77%**, nga vlera planifikuar prej **302,835 mijë lekë**, është realizuar vlera prej **232,954 mijë lekë**.

Sipas Grupit të KLSH, kjo vjen nga planifikim i procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje mali), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre, nivel ky i cili nuk kalon limitet e 60% për vitin objekt auditimi. Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor), nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku për vitin **2022** ato janë në shumën **328,522 mijë lekë**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime.

Miratimi i buxhetit faktik

Në fund të periudhave ushtrimore nga Bashkia Belsh janë miratuar buxhetet faktik. Në relacionet përfundimtare të zbatimit të buxhetit janë hartuar vetëm realizimin e treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk shoqërohen me analizë faktoriale për realizimet e fondeve dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës.

Fondi rezervë/dhe io kontigjencës

Për vitin **2022**, është miratuar në vlerën 6,000,000 lekë, vlerë e cila është përdorur vetëm në shumën 45,000 lekë.

Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Belsh

Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Belsh ka marrë donacione për periudhën objekt-auditimi përkatësisht **për vitin 2022** në vlerën 22,197,328 lekë. Kjo shumë përfaqëson fonde nga:

1. “Për sigurimin e një kamioni për grumbullimin e mbetjeve dhe kontejnerëve të mbetjeve për Bashkinë Belsh – Ambasada Japoneze në Shqipëri- 9,834,000 lekë
2. “Ndërtimi i një bahçeje në shkollën 9-vjecare Halit Uruci Belsh (Save dhe Children) – 940,000 lekë.
3. Shpenzime operative projekti "Programi GIZ Migrimi për Zhvillim, Shqipëri" – 11,423,328 lekë.

Ndërsa nga Bashkia Belsh gjatë kësaj periudhe janë kryer subvencione, si vijon:

Për vitin 2022, është subvencionuar vlera prej 3,700,000 lekë, vlerë e cila i përket subvencionit për Subvencion për SHA "Green Belsh.

4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimeve gjyqësore dhe detyrimet kontraktore.

Nga sa trajtuar më sipër, KLSH-ja konstaton se për periudhën objekt auditimi nga ana e (Drejtoria të Financës/Buxhet), ka fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizimi i të ardhurave vendore. Kështu për periudhën objekt auditimi 01/01/2022 – 31/12/2022, paraqiten gjithsej **21** fatura me vlerë **328,522 mijë** lekë.

Ky fenomen vjen nga mosrealizimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Me fondet e vitit buxhetor 2022, nuk janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e Linjës apo FZSH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive paraqitet si vijon:

Në lekë

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr./datë	Llog.602	Llog.230+231	Vendime gjyqësore
Viti 2022	328,522,554	31,209,640	Nr. date VKB nr.63 dt.24.12.2022	0	31,209,640	0

Tabela ab: Detyrimet e akumuluar në fund të periudhës

Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2022, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e lartë.

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Në lekë

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2021	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2022-31.12.2022	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022
Investime	47,923,941.00	21,624,745.00	69,548,686.00	38,339,046.00	31,209,640.00
Investime nga FZSH	231,332,750.00	219,635,917.00	450,968,667.00	153,655,753.00	297,312,914.00
Mallra dhe shërbime	1,973,434.00	9,970,297.00	11,943,640.00	11,943,640.00	0
Vendime gjyqësore	0	0	0	0	0

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2021	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2022-31.12.2022	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022
Të tjera	0	673,605.00	0	0	0
Totali	281,230,034.00	251,904,564.00	533,134,598.00	204,612,044.00	328,522,554.00

Tabela a7: Shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të periudhës 31.12.2022

Nga auditimi u konstatua se vlera e detyrimeve të prapambetura ka ardhur në rritje nga viti 2021 në vitin 2022, pasi këto detyrime në datën 31.12.2021 kanë vlerën 281,230,034 lekë, ndërsa në 31.12.2022 kanë vlerën 328,522,554 lekë, pra janë rritur në masën 14%, ose në vlerën 47,292,520 lekë. Edhe pse gjatë vitit 2022 janë likuajduar detyrime të prapambetura në vlerën 204,612,044 lekë, gjatë këtij vit janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 251,904,564 lekë. Kjo situatë tregon se Bashkia Belsh nuk ka marrë masa serioze për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë paguan detyrimet e krijuara ndër vite, nga ana tjetër krijojnë detyrime të reja brenda vitit buxhetor.

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të pa likuiduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se:

Detyrimet e pa likuajduara progresive të prapambetura të Bashkisë Belsh ndaj të tretëve në datën 31.12.2022 kanë vlerën 328,522,554 lekë, prej së cilës vlera 251,904,564 lekë është detyrim që është krijuar vetëm gjatë vitit buxhetor 2022, ndërsa vlera 76,617,990 lekë i përket detyrimeve të krijuara për periudhën 2018-2021 sipas ditarit të bankës dhe urdhërshpenzimeve e dokumentacionit financiar shoqërues të vënë në dispozicion.

-Raportet e Monitorimit

Për vitin 2022, nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre.

5.Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara nëpërmjet FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financë/ Buxhetit për periudhën 01.01.2022– 31.12.2022, në lidhje me investimet publike, u konstatua se:

Tabela mbi financimet e kontratave për investime, burimet e financimit si dhe likuidimet sipas viteve.

- **Për financimet nga Ministritë e linjës dhe donator të tjerë**, janë lidhur për vitin 2022 vetëm 4 kontrata në vlerën 22,816 mijë lekë. Për këto kontrata janë likuiduar në vitin 2022 në vlerën 22,816 mijë lekë.
- **Për financimet nga buxheti i Bashkisë Belsh dhe Grande**. Janë lidhur për vitin 2022 gjithsej 12 kontrata në vlerën 99,310 mijë lekë, për të cilën ka 56,363 mijë lekë likuidim dhe vazhdon të mbetet e pa likuiduar në vlerën 42,946 mijë lekë.

Kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga Ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Belsh nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/ tarifatat vendore. Depozitimi i kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është përcaktuar struktura buxhetore përkatëse sipas planbuxhetit.

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se fondet e akorduara nga Ministritë e Linjës nuk janë të planifikuara në vlerën e plotë në momentin e kryerjes së procedurës, por janë të ndara në periudha. Ndërsa në lidhje me zbatimin e procedurave me fondet e vetë Bashkisë Belsh për vitin 2021-2022 dhe grandeve të qeverisë, mos likuidimi i kontratave nuk vjen nga ndarja me vite të financimit, por nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat vendore dhe planifikimi i procedurave pa një studim të mirëfilltë. Veprime këto në kundërshtim me nenin 40 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012

“Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80-81, të udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime.

Titulli i gjetjes	Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.
Situata:	Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxhetet vjetore gjatë viteve kanë pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë. Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42, 43, 47, 50, 52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253 dhe 354.
Ndikimi/Efekti	Kthim i procesit të planifikimit, buxhetimit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.
Shkaku	Planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Drejtoria Ekonomike, në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Sektorët e tjerë në Bashki, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e të Ardhurave;

Menaxhimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Belsh, kryhet nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, ku për *vitin 2021* është miratuar struktura nga Kryetari i Bashkisë me 9 punonjës, nga të cilët 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 8 inspektorë.

Për *vitin 2022*, paketa fiskale është miratuar me VKB-në nr 62, datë 24.12.2021 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Belsh të vitit 2022”.

1. Të dhëna mbi numrin e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet ndaj të cilëve janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Nr	Lloji i Biznesit	Viti	Gjendja ne fillim	Regjistrime te Reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja ne fund
1	Biznesi i Vogël	2021	415	20	20	415
		2022	415	18	35	398
2	Biznesi i Madh	2021	44	1	1	44
		2022	44	7	3	49
3	Gjithsej	2021	459	21	21	459
		2022	459	25	36	448

Tabela b1: Gjendja e bizneseve për vitin 2022

Nga të dhënat e tabelës:

Për vitin 2022, kanë ushtruar aktivitet 478 subjekte (459 subjekte të biznesit të vogël, 46 subjekte të biznesit të madh) kanë kryer regjistrim si aktivitete të reja 19 biznese, dhe kanë bërë çregjistrim 15 subjekte.

Përsa më sipër konstatohet se:

- Kjo situatë sipas Bashkisë Belsh tregon nivelin e ulët ekonomik të kësaj Bashkie, por sipas mendimit të Grupit të KLSH-së, është edhe puna e pamjaftueshme e strukturave të Sektorit të Tatim Taksave.

- **Nuk janë mbajtur** regjistra manual për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar etj, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompjuterik të licencuar dhe të mbrojtur, veprim që bie në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku thuhet se; “*Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar*”.

- Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe kontrollit fizik të dokumentacionit rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk janë administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore, veprim që bie në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

- **Nga informacioni** i marrë nëpërmjet intervistimit dhe auditimi fizik i dokumentacionit, rezulton se nga Zyra e Taksave Vendore nuk është marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, mbi xhiron e subjekteve, ku mbi bazën e këtyre të dhënave aplikohet dhe taksat vendore sipas llojeve të biznesit (fizik/juridik), pasi referuar VKB tarifatat kanë nivele të ndryshme, veprim në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, kjo për të mundësuar evidentimin e subjekteve që kalojnë nga subjekte me status fizik në subjekte me status juridik, për të cilat taksat e tarifatat vendore kanë vlera të ndryshëm.

2. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2022 (në lekë)

Nr	Lloji i Taksës	2022		
		Plan	Fakt	%
a	B	-	-	0%
I	Te ardhura nga Tatimet	-	-	0%
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	-	-	0%
		71 280 000	39 604 923	
II	Te ardhura nga Taksat			
1	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	17 500 000	15 655 954	89%
2	Taksë mbi truallin	250 000	224 585	90%
3	Taksë Vendore B.Vogël	20 000	22 215	111%
4	Taksë e mjeteve të përdorura	6 700 000	7 168 638	107%
5	Taksa e ndikimit në Infrastrukturë	4 000 000	2 969 368	74%
6	Taksë regjistrimi biznesi	-	-	0%
7	Taksë Tabelë	300 000	171 690	57%
8	Taksë mbi kalimin e pronësisë	-	-	0%
9	Taksë vendore e përkohshme	10 000	-	0%
10	Taksa mbi tokën bujqësore	42 500 000	13 392 473	32%
III	Te ardhura nga Tarifatat	29 365 000	26 820 872	
1	Tarifë pastrimi dhe higjene	15 100 000	13 789 688	91%
2	Tarifë për leje ndërtimi	2 500 000	1 739 803	70%
3	Tarifë zënie hap.publike	3 400 000	3 138 818	92%
4	Tarifë leje zhvillimi	100 000	70 000	70%
5	Tarifë parkim automjete	-	-	0%
6	Tarifë ndricimi	2 830 000	2 042 268	72%
7	Tarifë për leje transporti	290 000	436 179	150%
8	Tarifa të tjera vendore	2 900 000	3 621 074	125%
9	Tarifë gjelbërimi	340 000	350 009	103%
10	Tarifë vërtetimi	105 000	84 837	81%
11	Tarifë vendore ujitje	150 000	134 000	89%
12	Taksë e akteve dhe pullave	-	-	0%

Nr	Lloji I Taksës	2022		
		Plan	Fakt	%
a	B	-	-	0%
13	Qëra nga objekte/ndërtesa	200 000	202 253	101%
14	Qëra trualli	800 000	921 412	115%
15	Tarifë shërbimi për mjete	-	-	0%
16	Tarifë autorizimi urbanistikë	400 000	85 000	21%
17	Tarifë përdorim certifikate	250 000	205 532	82%
18	Tarifë për ujitje kullim	-	-	0%
IV	Te ardhura jo tatimore	1 355 000	1 024 969	
	Te ardhura jo tatimore	800 000	312 566	39%
	Gjoha të policisë bashkiake	100 000	288 325	288%
	Grante nga K.qarkut			
	Kamatvonesë	455 000	424 078	93%
	Të ardhura nga MNZSH	-	-	0%
	Grante korrente buxh.qendro (2%TAP)			
GJITHSEJ (I+II+III+IV)		102 000 000	67 450 765	66%

Tabela b2: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2022

Bashkia Belsh sipas VKB nr.62, datë 24.12.2021, ka miratuar treguesit e planit të të ardhurave, për vitin 2022.

Në mënyrë të përmbledhur planifikimi dhe realizimi i të ardhurat për taksat dhe tarifatat vendore paraqiten në pasqyrën e më poshtme:

(në lekë)

Nr	Përshkrimi	Plan 2022	Fakt 2022	Realiz. %
1	Të ardhura nga taksat	71 280 000	39 604 924	55%
2	Të ardhura nga tarifatat	29 365 000	26 820 872	91%
3	Të ardhura të tjera	1 355 000	1 024 969	75%
4	Të ardhura nga gjobat	-	-	-
5	Tatim i thjeshtuar/fitimin	-	-	-
6	Të ardhura kombëtare	-	-	-
7	Shuma	102 000 000	67 450 765	66 %

Tabela b3: Të ardhurat e planifikuara dhe realizuara 2022

Nga analiza e të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se:

c. Për vitin 2022 të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga **102,000 mijë** lekë të parashikuara, janë realizuar, në vlerën **67,450 mijë** lekë, ose **66%**, me një diferencë në vlerën **33,459 mijë** lekë të pa realizuara. Nga të cilat të ardhurat nga taksat nuk janë realizuar në vlerën 2,028 mijë lekë, ose 52% të planifikimit dh të ardhura nga debitorët nuk janë planifikuar dhe realizuar. *Situatë e cila tregon një nivel të ulët dhe punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve bën që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2022 të prokurohen pa fonde në dispozicion, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe borxhin.*

-Për vitin 2022 vlerën më të lartë të mos realizimit të të ardhurave vendore e zënë të ardhura nga Taksat Vendore në shumën **33,459 mijë** lekë.

- Nga planifikimi i të ardhurave nga arkëtimi i debitorëve të ndryshme nuk është realizuar asnjë e ardhur nga ky zë, për të dy vitet objekt auditimi.

- Të ardhura nga taksat kombëtare për vitin 2022 nuk janë planifikuar, kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Belsh, si dhe mos njohja e kuadrit ligjir që rregullon përfitimin e njësive vendore nga këto taksa.

-Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike, por nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve në përdorim që gjenden në territorin e Bashkisë Belsh. Nga të dhënat e nxjerra nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Belsh në lidhje me sipërfaqen e tokës gjithsej të ndarë sipas ligjit, paraqitet si vijon:

Nr	Bashkia Belsh dhe NJA	Tokë bujqësore gjithsej	Nga e cila				Familjet që kanë marrë tapi	
			Arë	Pemëtore	Vreshta	Ullishte	Nr.	Ha

1	Belsh	36,318,046				1,996	36,318,046
2	Kajan	28,017,051				1,207	28,017,051
3	Grekan	16,304,546				788	16,304,546
4	Fierzë	18,517,528				865	18,517,528
5	Rrasë	7,272,178				432	7,272,178
Totali		106,429,349				5,275	106,429,349

Tabela b4: Të dhënat janë nxjerrë nga zyra e Tatim Taksave

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë së saj dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu nëse vërejmë pasqyrat e mëposhtme do të konstatojmë se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme përse i përket taksës së tokës bujqësore. Kjo tregon se Sektori i Taksave dhe Tarifave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë, dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave, veprim ose mosveprim që bie në kundërshtim me pikën 1 të nenit 23 të ligjit nr. nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku thuhet se; “Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vete deklaram të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka”.

Nr	Bashkia Belsh dhe NJA	Sip e tokes gjithsej ha	Numri I familjeve gjithsej	Marre toke nga AMTP sip.ha	Marre toke e AMTP familje gjithsej
1	Belsh	36,318,046	1996	36,318,046	1,996
2	Kajan	28,017,051	1180	28,017,051	1,207
3	Grekan	16,295,291	788	16,295,291	788
4	Fierzë	18,517,528	865	18,517,528	865
5	Rrasë	7,272,178	419	7,272,178	419
Bashkia Belsh Totali		106,420,094	5,275	10 6,420,094	5,275

Tabela b5: Tokat Bujqësore

Nga tabela sa më sipër vihet re se në Bashkinë Belsh janë posedues të tokës bujqësore sipas ligjit, gjithsej **5,275** familje dhe që duhet ti nënshtrohen taksës për këtë pasuri të paluajtshme sipas kuadrit ligjor.

Në bashkinë Belsh rezulton se toka bujqësore u përket kategorive II deri VII, sipas përkatësisë. Mungojnë regjistra dhe database ku të specifikohen saktë ndarja e fondit të tokës sipas kategorive, por nga analizat e hershme rezultojnë të jenë kategoria II nga vlerësimi i kryer nga Instituti Bujqësor.

Nr.	Kategoria/tokë	Cmimi/ha/vit	Sipërfaqja/ha	Shuma/lekë	Planifikimi taksës/vit 2022
1	Kategoria II	3500	843,376	295,182	
2	Kategoria III	2800	15,176,258	4,249,352	
3	Kategoria IV	2300	22,436,959	5,160,501	
4	Kategoria V	1900	28,737,375	5 460 101	
5	Kategoria VI	1600	17,802,261	2,848,362	
6	Kategoria VII	1400	6,698,243	937,754	
	Shumae llogaritur sipas kategoris		91,694,472	18,951,251	
7	Pa kategori		14,725,622	3,115,848	
	Totali		106,420,094	22,067,099.100% / 70%.15,446,969	42,500,000

Tabela b6: Vlerësimi i tokës sipas sipërfaqes/kategorisë/cmimit

-Nga sa më sipër diferenca në planifikim është **27,053,031** lekë për vitin 2022 (42,500,000 – 15,446,969), gjë e cila ka sjell të ardhura të planifikuara më pak për buxhetin e bashkisë për

vitin 2022 në vlerën **27,053,031** lekë. Sektori i Taksave Vendore, Bashkia Belsh, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, nuk ka ndarje të argumentuar sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, konstatojmë se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se Zyra e Taksave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave, veprim ose mosveprim që bie në kundërshtim me pikën 12 të nenit 23 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Këto veprime kanë çuar në mos planifikimin e saktë të taksës së tokës për diferencën prej 27,053,031 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Belsh.

Titulli i gjetjes	Mos planifikim i rregullt i taksës së tokës
Situata:	Sektori i Taksave Vendore, Bashkia Belsh, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, konstatojmë se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se Zyra e Taksave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave. Këto veprime kanë çuar në mos planifikim të taksës së tokës për diferencën prej 27,052,031 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Belsh.
Kriteri:	Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23.
Ndikimi/Efekti	Mos planifikim i saktë i taksave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.
Shkaku	Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Bashkia Belsh, të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej 27,053,031 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Belsh.

3. Për realizimin e të ardhurave nga sipërfaqet e dhëna me qira nga fondi pyjor dhe kulloror në Bashkinë Belsh, dokumentet e lejeve minerare të dhëna nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që ndodhen në territorin e Bashkisë Belsh:

Dokumentet e Lejeve Minerare të dhëna nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që ndodhen në territorin e Bashkisë Belsh, rezultojnë 4 subjekte.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e Bashkisë Belsh, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në :

VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, përsa i përket arkëtimit të ardhurave nga qiratë për sipërfaqet e tokave pyjore e kullorore dhe Inproduktive që ndodhen në territorin e Bashkisë Belsh.

Referuar pikës 2; lidhjes nr.2, pika 6/1 dhe pika 9/4 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, në të përcaktohet që:

“Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifat dysheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. “lidhja nr.2 “Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive”.

Pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)

Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës **lek/ha/vit 1 vit 2-5 vjet 6-10 vje1 Inproduktive 540 000 / 495 000 / 440 000”.**

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë, për të cilat nuk janë lidhur kontrata qiraje, bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i të Ardhurave, Bashkia Belsh, konstatohet se:

Në territorin e Bashkisë Belsh ushtrojnë aktivitet privat 4 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, subjekte të cilat nuk kanë lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullosore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private.

Në vijim paraqiten subjektet e pajisur me leje minerare nga MIE dhe statusi i tyre për vitin 2022:

Nr	Leje	Data e lejes	Emërtimi i Subjektit	Nipt	Bashkia	Emërtimi i vendburimit	Lloji i mineralit	S=km2	Lloji i lejes	Statusi i lejes
1	850/1	18.09.2015	A.-D. SHPK	J.C	Belsh	Shkambi i Zekthit,Belsh	Gips	0.0319	Shfrytezimi	Aktiv
2	1735	15.12.2014	J. 2010 SHPK	L.F	Belsh	Objekti Perroi Cenes	Gur gelqeror	0.05	Shfrytezimi	Aktiv
3	1847	13.09.2017	H. SHPK	L.G	Belsh	Objekti Cerrage	Gur gelqeror	0.177	Shfrytezimi	Aktiv
4	1746	30.03.2015	I. E.	K.U	Belsh	Objekti Kosoves	Travertina	0.456	Shfrytezimi	Aktiv

Tabela b7: Subjektet e pajisur me leje minerare

U auditua dokumentacioni për periudhën 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe Inproduktive, nga ku konstatohet se nga Bashkia Belsh, nuk është vepruar për të dhënë me qira, sipërfaqet pyjore dhe kullosore për të cilat të lidhte kontrata qiraje, të cilat janë miratuar me leje nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë me subjektet e trajtuara në vijim.

Pasqyra e detyrimeve të subjekteve, periudha 01.01.2022-31.12.2022

Nr	Leje	Data e lejes	Emërtimi i Subjektit	Nipt	Emërtimi i vendburimit	Lloji i mineralit	S=km2	Tarifa lek/ha	Vite shfrytëzimi	Detyrimi
1	850/1	18.09.2015	A. D. SHPK	J.C	Shkambi i Zekthit,Belsh	Gips	0.0319	440,000 Leke/Ha	7	98,252
2	1735	15.12.2014	J. SHPK	L.F	Objekti Perroi Cenes	Gur gelqeror	0.05	440,000 Leke/Ha	8	176,000
3	1847	13.09.2017	H. SHPK	L.G	Objekti Cerrage	Gur gelqeror	0.1777	440,000 Leke/Ha	5	390,940
4	1746	30.03.2015	I. E.	K.U	Objekti Kosoves	Travertina	0.456	440,000 Leke/Ha	7	1,404,480
Shuma e detyrimit							0.7149			2,069,672

Tabela b8: Pasqyra e detyrimeve të subjekteve

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Nga auditimi i kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Belsh, për të cilat nga Bashkia Belsh, nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me

subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore me sipërfaqe totale prej 0.71 ha, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet ku tarifa vjetore është

Emërtimi	31,12,2022	
	Nr.	Vlerë/Lekë
Nga subjektet fizik	147	8 241 248
Nga subjektet juridik	13	1 207 614
Nga ambientet familjarë	1452	5 359 512
Nga taksa e tokës bujqësore	2847	69,946,681
Nga taksa infrast (ALUIZNI)	120	4 520 730
Nga taksa infrast (DPZHT)		
Nga kontratat e plazhit		
Gjopa te ndryshme		
Nga kamat vonesa nëse ka	160	1 600 598
Të tjera		
TOTALI	4,739	90,876,383.00

440,000 lekë/ha/vit në territor tokë Inproduktive, veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6/1, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Belsh, në vlerën 2,069,672lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
-VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 9.

Tabela b9: Niveli i detyrimeve të papaguara në fund të periudhës 2022 paraqitet si vijon:

5. Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022

Më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Belsh në vlerën gjithsej **90,876,383 mijë** lekë, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithsej **4739** subjekte.

Sektori i Taksave dhe Tarifave, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2022, janë gjithsej **debitorë 1,452 familje për vlerën gjithsej 5,359,512 lekë**, konstatohen mangësi pasi nga ana e sektori të tatim taksave vendore nuk është kryer rakordim me zyrën e gjendjes civile për të nxjerrë të dhënat reale të numrit të familjeve në Bashkinë Belsh.

Gjendja në fund e detyrimeve debitorë nuk janë pasqyruar në kontabilitet, nuk ka patur korrespondencë midis sektorit të financës dhe të taksave për të kryer rakordimin dhe pasqyrimin e debitorëve. Për rrjedhojë nuk është pasqyruar në bilanc për vitin 2022, vlera e debitorëve për **90,876,383 lekë**.

Titulli i gjetjes	Detyrime të subjekteve ndaj Bashkisë Belsh.
Situata:	Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Belsh në vlerën gjithsej 90,876,383 lekë, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithsej 160 subjekte në vlerën 9,448,862 lekë, e pakontabilizuar, dhe 1,452 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 5,359,512 lekë, debitorë nga toka bujqësore 2,847

	familje në vlerën 69,946,681 lekë, si dhe nga taksa mbi ndikimin në infrastrukturë 120 subjekte në vlerën 4,520,730 lekë. Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Belsh, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe asnjë procedurë tjetër , ku dhe kjo procedurë që në fillimet e saj rezultoi e dështuar pasi sidomos për abonentët familjarë nuk kanë të deklaruar pranë sektorit të taksave nr. llogarie bankare për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës.
Kriteri:	Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara”, të neneve 88 deri 104, neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.
Ndikimi/Efekti	Veprime që çojnë në mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë Belsh dhe mos kontabilizimi i debitorëve në pasqyrat financiare.
Shkaku	Mos zbatimi i kuadrit ligjor në arkëtimin e detyrimeve nga debitorët.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Belsh të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 160 subjekte në vlerën 9,448,862 lekë, 1,452 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 5,359,512 lekë, debitorë nga toka bujqësore 2,847 familje në vlerën 69,946,681 lekë, si dhe nga taksa mbi ndikimin në infrastrukturë 120 subjekte në vlerën 4,520,730lekë, duke ndjekur rrugët e mëposhtme: T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime në llogarit bankare; - T’i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim pagesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Belsh

Nga ana e Zyrës së Tatim Taksave nuk është zbatuar VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar “Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë”.

Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që tregtojnë karburante në Bashkinë Belsh për vitin 2022, paraqiten 18 subjekte.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në pasqyrën në vijim për subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës,

për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas pasqyrës si më poshtë:

NR	Emërtimi i Subjektit	NIPT	Data e fillimit të Autorizimit	Data e mbarimit të Autorizimit	Shuma për t'u paguar	Pagesa e kryer me këste	Duhet diferenca paarkëtuar.
1	M.V. SHPK	L.S	04.03.2019	03.03.2024	1 000 000	400 000	600 000
2	M. M. O. SHPK	L.T	27.04.2020	26.04.2025	1 000 000	1 000 000	-
3	P. SHPK	K.D	18.12.2019	19.12.2024	1 000 000	1 000 000	-
4	H. SHPK	K.Ë	01.07.2020	30.06.2025	1 000 000	400 000	600 000
5	K. O. SHPK	K.V	29.08.2019	28.08.2024	1 000 000	1 000 000	-
6	M. F. O. SHPK	K.O	13.12.2022	12.12.2027	1 000 000	1 000 000	-
7/11	F. O. SHPK	K.V	11.10.2019	10.10.2021	1 000 000	400 000	-
8	V. F. SHPK	L.P	05.02.2020	04.02.2025	1 000 000	1 000 000	-
9	R. SHPK	K.M	03.02.2020	02.02.2025	1 000 000	1 000 000	-
10	K. O. SHPK	L.T	27.08.2019	26.08.2024	1 000 000	1 000 000	-
11/7	M. SHPK	J.Q	11.10.2021	10.10.2024	1 000 000	600 000	-
12	M. O. SHPK	L.L	26.03.2019	25.03.2024	1 000 000	400 000	600 000
13	Z. SHPK	K.V			1 000 000	-	1 000 000
14	D. O. 2... SHPK	L.J			1 000 000	-	1 000 000
15	G. O. SHPK	L.D	20.02.2014	09.02.2019	1 000 000	-	1 000 000
16	D. 1-O. SHPK	L.E	01.06.2010	31.05.2020	1 000 000	-	1 000 000
17	Z. B. SHPK	L.F	24.12.2021	27.08.2025	100 000	100 000	-
18	G.-O. SHPK	L.N	30.06.2023	29.06.2023	1 000 000	1 000 000	-
Shuma totale					17 100 000	10 300 000	5 800 000

Tabela b10: Subjektet të tregtimit të karburanteve

Nga tabela, shihet se tarifa e pajisjes me autorizim për tregtimin e hidrokarbureve nuk është llogaritur, dhe **vlera prej 5,800,000 lekë, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave të autorizimeve / licencave, për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të konsiderohet të ardhura të munguara e të pa planifikuar për Buxhetin e Bashkisë Belsh.**

Veprim ky i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35, VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9.

VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9.

“15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi.”

Titulli i gjetjes	Mangësi në plotësimin e të dhënave dhe në vjeljen e detyrimeve nga subjektet e tregtimit të hidrokarbureve.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e

	detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Belsh, nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 5,800,000 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Belsh.
Kriteri:	Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35, VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II, kapitulli III, pika 4.
Ndikimi/Efekti	Ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Belsh në vlerën 5,800,000 lekë..
Shkaku	Mos ndjekja e procedurave nga strukturat përgjegjëse. Mangësi në përcaktimin specifik të detyrave dhe mungesë e personelit përgjegjës.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Nga Bashkia Belsh, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifën e plotë për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej 5,800,000 lekë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. A. T.** në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Belsh
2. **Z. A. N.** në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së shërbimeve financiare, të ardhurave, pronave publike, lejeve dhe licencave.
3. **Z. D. P.** në funksionin e Përgjegjësit të Sektorit të të ardhurave.

Ne zbatim të Pikës 2.6 . Astete /pyje kullota U auditua dokumentacioni mbi inventarizimin regjistrimin dhe përdorimin e aseteve në bashkinë Belsh sipas VKM-ve, përkatëse, nga ku rezultoi si më poshtë .

Nga Bashkia Belsh nuk është krijuar një grup për administrimin e aseteve, pra veprime jo në përputhje me Inventari i pronave, në zbatim të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe në mbështetje të Pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr.500, datë 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, nuk janë ngritur grupet e punës, kjo e përcaktuar në misionin dhe detyrat e saj për administrimin e aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre. Nga auditimi sipas dokumentacionit që na u vu në dispozicion dhe deklarimeve verbale të punonjësve; drejtori i menaxhimit të aseteve, drejtori i fondit pyjor dhe kullotave, ish/drejtori i AMTP tokave bujqësore, u konstatua se: Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Belsh dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

-Marrja në dorëzim e aseteve nuk është bërë e trajtuar si më poshtë

Në Bashkisë Belsh, me VKM nr. 886 datë 03.11.2010 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Belsh, të Qarkut Elbasan”, i është miratuar lista inventarit me në total 1306 prona. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se me VKB nr.10 datë 08.02.2010, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Belsh. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe

mbaron me nr. 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtate) dhe përbëhet me 179 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë ndryshuar me;

- Vendimin nr. 322 date 18.05.2022 Bashkisë Belsh i është transferuar pronën me nr.306 nga ministria e mbrojtjes sipas vendimit bashkëlidhur.

Ish Komunës Kajan sot Njësia Administrative Kajan e Bashkisë Belsh, me VKM nr. 71, datë 28.01.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Kajan, të Qarkut Elbasan”, i është miratuar lista paraprake inventarit me 685 prona e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njesisë Administrative Kajan, në Bashkinë Belsh.

Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 97 (nëntëdhjetë e shtatë) procesi i transferimit të pronave në njësinë Administrative Kajan nuk ka përfunduar është ne fazën e inventarizimit.

Ish Komunës Grekan sot Njësia Administrative Grekan e Bashkisë Belsh, me VKM nr. 912, datë 19.12.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Grekan, të Qarkut Elbasan”, i është miratuar lista paraprake inventarit. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 208 (dyqind e tetë) procesi i transferimit të pronave në njësinë Administrative Grekan nuk ka përfunduar është ne fazën e inventarizimit.

Ish Komunës Rrase sot Njësia Administrative Rrase e Bashkisë Belsh, me VKM nr. 699, datë 19.07.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Rrase, të Qarkut Elbasan”, i është miratuar lista paraprake inventarit. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 194 (njëqind e nëntëdhjetë e katër) procesi i transferimit të pronave në njësinë Administrative Rrase nuk ka përfunduar është ne fazën e inventarizimit.

Ish Komunës Fierze sot Njësia Administrative Fierzë e Bashkisë Belsh, me VKM nr. 1526, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Fierzë, të Qarkut Elbasan”, i është miratuar lista paraprake inventarit. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 150 (njëqind e pesëdhjetë) procesi i transferimit të pronave në njësinë Administrative Fierzë nuk ka përfunduar është ne fazën e inventarizimit.

-Në bashkinë Belsh nuk janë hartuar grupe pune si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale përkatëse asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Belsh dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki.

Por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se .

Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nga AITPP-ja, nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

1-VKM nr.886 datë 03.11.2010 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose ne përdorim të Bashkisë Belsh, të qarkut të Elbasanit.

2-VKM nr.71 date 28.01.2008 Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kajan të qarkut të Elbasanit.

3-VKM nr.699 date 19.10.2007 Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Rrase të qarkut të Elbasanit.

4-VKM nr.1526 date 19.11.2008 Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fierze të qarkut të Elbasanit.

5-VKM nr.912 date 19.12.2007 Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Grekan të qarkut të Elbasanit.

Gjithashtu janë të transferuara pyjet dhe kullotat sipas vkm-ve të shoqëruara me inventarët.

1-VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit”.

2-VKM Nr.684, datë 02.09.2020“Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike”.5.Sa prej pronave të kaluara me VKM janë të regjistruara në ASHK Paraqiten si më poshtë: për vitin 2022

Tabela

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2021	Nr. Praktikave të Certifikuara 2022	Prona te pa Rregjistruara
1	Bashkia Belsh	1306	13	2 certifikata pronesie	Pjesa e mbetur e pronave.
2	NJA. Grekan	151	1(pasuri e llojit pyll) Vkm.pyjeve	0	
3	NJA. Fierz	150		0	
4	NJA. Kajan	685		0	
5	NJA. Rrase	194		0	

Nja Belsh

Pasuria nr.219 e llojit “Truall” me sipërfaqe totale 2795 m² , zona kadastrale 1839, fshati Gradishte.

Pasuria nr.218 e llojit “Truall” me sipërfaqe totale 3800 m² , zona kadastrale 1839, Fshati Gradishte.

Për Bashkinë Belsh ka përfunduar procesi i transferimit ndërsa për njësitë Grekan, Fierz, Kajan, Rrase transferimi është në fazën e inventarizimit për këtë arsye nuk mund të aplikohet për tu pajisur me certifikatë pronësie. Në mënyrë të detajuar paraqiten pronat të cilat janë aplikuar për regjistrim në ASHK për periudhën 31.12.2022 si vijon:

Nr	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi i harte	Nr. regjis	Siperfaqia sipas V.K.M.		Data e aplikimit Nr. Dt.	Verteti m ose certifikate Hipotek e	Siperfaqia sipas Faktit	
						Truall	Ndert			Truall	Ndertes a
1	Kullote	3324	76	K-34-112-(27B)				17/10/2022			
2	Kullote	3393	61/16	K-34-112-(12A)				30/11/2022			
3	Pyll	3082	34	K-34-112-(12A) (12B)				30/11/2022			
4	Kullote	3393	61/15	K-34-112-(12A)				30/11/2022			
5	Kullote	3393	68	K-34-112-(12A)				30/11/2022			
6	Kullote	3393	67	K-34-112-(12A)				30/11/2022			
7	Kullote	3393	62	K-34-112-(12A)				30/11/2022			

Nga auditimi rezulton se janë certifikuar 7 pasuri në fondin pyje/kullota

Administrimi dhe inventarizimi Pyje/kullota

Nga auditimi rezulton se Bashkia Belsh që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016, dhe ndryshimeve të bëra sipas –VKM-së, Nr.684, datë 02.09.2020“Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike”.

nuk ka iniciuar asnjë procedurë për verifikimin në terren dhe regjistrimin e kësaj sipërfaqe dhe më pas kalimin në fazën tjetër atë të pajisjes me certifikatën e pronësisë për sipërfaqet pyjore, kullosore dhe shkëmbore që administron. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020, Neni 37 “Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore

1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Procedura e përditësimit mbështetet në:

a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së;

b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës.

Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj.

3. Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik”.

Nga auditimi rezulton se Bashkia Belsh , që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016, nuk ka iniciuar asnjë procedurë për verifikimin në terren dhe regjistrimin e kësaj sipërfaqe dhe më pas kalimin në fazën tjetër atë të pajisjes me certifikatën e pronësisë për sipërfaqet pyjore, kullosore dhe shkëmbore që administron. Nga auditimi rezultoi se janë certifikuar pranë ish/zyrës se hipotekës .

Shfrytëzimi për veprimtari ekonomike i fondit pyjor

Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njësive të qeverisjes vendore (NJQV) është një proces i cili ka nisur që nga viti 2001. Ky proces duhej zbatuar në bazë të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar. Ligji i fundit që trajton problematikën e procesit të pronësisë për NJQV është ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” i cili në nenin 37 përcakton se: “*Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit*”, proces i cili duhet të përfundonte në Nëntor të vitit 2021. Bashkisë Belsh i janë transferuar me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” e ndryshuar, 1209 prona me sipërfaqe totale 23,653 ha. Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Belsh nuk është realizuar inventarizimi i pasurive (pyje/kullota) ku ushtrohet veprimtaria minerare. Pra nuk ka nisur procesi i transferimit të pronës që kalon në tre faza:

1. Identifikimi i statusit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore drejt njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Belsh

2. Problematikat e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore;

3. Identifikimi dhe analizimi i opsioneve të përdorimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore. Nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit u audituan dosjet e subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare në territorin e Bashkisë Belsh të administruara nga Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave.

Grupi i auditimit i është referuar lejeve minerale aktive të paraqitura në faqen zyrtare të AKBN-së .

Viti	Lloji	Afati	Sipërfaqe	Niveli i arkëtimit
2022	Fond Pyjor	10 vjeçar	6.8 ha	68000 leke ne vite

Gjatë 2022 është rinovuar një kontratë për dhënie në përdorim Fondi Pyjor e lidhur në datë 11.10.2022 me nr.2825 prot, ndërmjet Bashkisë Belsh dhe Personit Fizik Bukurosh Kuqja me afat 10 vjeçar. Qëllimi i lidhjes se kësaj kontrate është për ushtrimin e veprimtarisë “Agropylltari” vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes se miratuar.

Për “Agropylltari”

Vlera me bimësi Pyjore 6.8 ha * 10 000 = 68 000leke(gjashtëdhjetë e tetë mijë)

Objekti: Dhënie në përdorim Fondi Pyjor

Vlera: 6.8 ha * 10 000 = 68 000leke(gjashtëdhjetë e tetë mijë).

Subjekti :Personit Fizik Bukurosh Kuqja

Afati 10 vjeçare.

Konkluzion:

Subjektet me objekt veprimtarinë minerare në Bashkinë Belsh , nuk kanë zbatuar parimet e veprimtarisë minerare që rregullon marrëdhëniet midis subjektit dhe titullarit të pronësisë (Bashkisë Belsh), në përputhje me pikën 4 të nenit 4, ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për

Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet e ligjit nr. 9/2013 dhe Ligjit nr. 134/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

- Për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare nuk është miratuar ndryshimi nga fondi pyjor, parakushti për zhvillimin e aktiviteti minerar në Republikën e Shqipërisë, veprim në kundërshtim pikat 3, 5 e 8 të nenit 5 të ligjit 57/2020 “Për Pyjet” (nenin 17 “Heqja e sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar” të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.)

- Bashkia Belsh nuk ka asnjë kontratë të nënshkruar me subjektet që ushtrojnë veprimtari të kryerjes së operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit, në fondin pyjor. Sa më sipër nuk është vepruar në zbatim të pikave 3 e 4 të nenit 25 “Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar” të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”,

“3. Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratave të nënshkruara nga kryetari i bashkisë/organi përgjegjës për zonat e mbrojtura kur përfshihet në këto zona. Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton tjetër zhvillim për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar, objekt kontrate. Rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për këto veprimtari caktohen me udhëzim të ministrit.

Çmimet dhe tarifat për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për pyjet dhe ministrit përgjegjës për financat. Pronarët privatë, për veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor në pronësi të tyre, kanë të drejtë të përdorin çmime dhe tarifa të vendosura në marrëveshje me subjektet e interesuara”.

Bashkia Belsh nuk i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

Gjithashtu ,për rastet e trajtuara sipas tabelës , nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, si dhe nuk është kërkuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Për sa më lart, për mos ngritje të komisionit për marrje në dorëzim dhe inventarizim mos hartimin e kontratave më subjektet që shfrytëzojnë fondin pyjor të pronave sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave mban përgjegjësi kryetari i bashkisë A. T. Drejtori i zhvillimit të Bujqësisë Pyjeve, Mjedisit dhe Pronave Publike z.Q.I R. dhe specialisti i pyjeve K. G.

Titulli i gjetjes	Mbi menaxhimin dhe administrimin e fondit pyjor/kullota
Situata:	Nga komunikimi me Drejtorin e Menaxhimit të Asetve si dhe të Drejtorit të Pyje /Kullota rezulton se nuk janë ngritur grupe pune /apo persona përgjegjës nga kryetari I bashkisë, sipas VKM Nr. 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 22, shtojca me nr.33, në kundërshtim me pikën 64, pika 65, Ministri i Mjedisit dhe kryetarët e bashkisë përcaktojnë personat përgjegjës si anëtarë komisioni të përbashkët brenda 20 ditëve puna nga hyrja në fuqi e këtij vendimi ,për transferimin e pranove nga Ministria e Mjedisit pranë Bashkisë Belsh si dhe pika 66 e ligjit kryetarët e bashkive regjistrojnë

	<i>sipërfaqet e fondit pyjore dhe kullimore të transferuar nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.</i>
Kriteri:	VKM Nr. 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive.
Ndikimi/Efekti	Mos evidentimi i fondit pyje/kullota ,gjë që ndikon në mos menaxhim të fondit pyjore, gjithashtu në krijimin e të ardhurat të bashkisë Belsh
Shkaku	Mos ngritja e grupeve të punës nga Titullari i institucionit.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Titullari i Bashkisë Belsh të marrë të gjitha masat për të filluar procesin e inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave si vijon: - Të ngrejë një grup pune për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre. - Të vendosë komunikim me ASHK-në me qëllim arritjen e një bashkëpunimi për të marrë asistencën e tyre për verifikimin e gjendjes faktike të pronave. - Të angazhojë Drejtorinë Juridike për verifikimin e gjendjes juridike të pronave. - Të dokumentohen me kujdes të gjitha hapat e këtij procesi të gjatë dhe të rëndësishëm për secilën Njësi Administrative dhe në nivel bashkie.

Titulli i gjetjes	Mos vendosja marrëdhënieve kontraktuale me Operatorët Ekonomikë
Situata:	Bashkia BELSH nuk i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore të mbetura. Gjithashtu ,për rastet e trajtuara sipas tabelës , nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, si dhe nuk është kërkuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme. Bashkia Belsh nuk ka asnjë kontratë të nënshkruar me subjektet që ushtrojnë veprimtari të kryerjes së operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit, në fondin pyjor nuk është vepruar në zbatim të pikave 3 e 4 të nenit 25 “Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar” të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”,
Kriteri:	Ligjit Nr.57/2020, “Për pyjet”, Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Udhëzimi nr. 1, datë 16.03.2017, “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore”
Ndikimi/Efekti	Efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkia Belsh.
Shkaku	Mos respektim i kuadrit ligjor për Planifikimin e Zhvillimit të Territorit.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Kryetari i Bashkisë Belsh të vendosën marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale duke aplikuar tarifën dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar.

Pika 3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit “Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.”

Nënpika 3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

Nënpika 3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë;

Nënpika 3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare

Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2022 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
 - Pasqyrat financiare të vitit 2022;
 - Centralizatori /Libri i madh;
 - Ditari i Bankës;
 - Ditari i Arkës;
 - Ditari i Magazinës;
 - Ditari i Pagesave;
 - Ditari i Veprimeve të ndryshme
 - Akt akordimet me Degën e Thesarit Elbasan.
 - Inventarët etj.
- **Kriteret e vlerësimit:**
 - Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
 - Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" , i shfuqizuar;
 - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
 - Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".
 - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Nga auditimi ka rezultuar se:

- Bashkia Belsh ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2021 dhe 2022, mbështetur nënë Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme". Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Elbasan, si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.
- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2022 janë:**
 - Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
 - Pasqyra e performancës financiare (F2);
 - Pasqyra e flukseve monetare (F3);
 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
 - Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ku janë dhënë informacion mbi:
 - Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Belsh me NIPT K48420701I;

- Nëse pasqyrat financiare mbulojnë një njësi ekonomike raportuese individuale apo grup njësisish;
- Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2022-31.12.2022;
- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 30.03.2022;
- Përgatitur nga z. A.N.,
- Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Elbasan me shkresën nr.302prot, datë 29.03.2023 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Belsh z. A. T..
- Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Akt akordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Elbasan të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Belsh, kontabilisti dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Elbasan.

Pasqyrat Financiare viti 2022 (Bashkia Belsh)

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”.

Taeta : Aktivi i Bilancit Kontabël 2022 Bashkia Belsh.

Burimi: Sektori i Financës.

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	3,473,925,289	3,115,360,904
2		I.Aktivët Afatshkurtra	672,734,051.35	482,847,513.48
3		1.Mjete monetare dhe kujalent të tyre	148,553,794.19	96,122,793.23
4	531	Mjete monetare në Arke	0.00	515,000.00
5	512,56	Mjete monetare në Banke	200.00	3,313.00
6	520	Disponibilitete në Thesar	148,553,594.19	95,604,480.23
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera		
9	54	Akreditiv dhe paradhenie		
10	59	Provizione zhvlersimiletra me vlerë (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	33,435,009.86	25,283,592.15
12	31	Materiale	4,774,196.94	1,113,887.23
13	32	Inventar i imet	28,660,812.92	24,169,704.92
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje të mbritura, ose pranet të rezeve		
19	38	Diferencat e magazinit		
20	39	Provizione për zhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari të Arketushme	72,793,944.50	82,184,437.10
22	411	Kliente e llogaritë ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatime të Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogaritë pushtet lokale		
26	433	Fatkeqsinat e rregulluara dhe të paguara		
27	435	Sigurime Shoqërore		
28	436	Sigurime Shëndetësore		
29	437,438,	Organizmatet e jashtme		
30	44	Institucionet e jashtme		
31	465	Efekte për tu arketuar ngjashme të letrave me vlerë		
32	468	Debitoret e ndryshme	57,407,344.00	55,440,044.00
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	15,386,600.50	26,744,393.10
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
35	49	Shuma të parashikuara për zhvlersim (-)		
36		4. Te tjera aktive afatshkurtra	417,951,302.80	279,256,691.00
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes të mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferencat e konvertimit aktive		
40	481	Shpenzime për t'ushperndare në disa ushtrime		

41	486	Shpenzimetepariudhaventardhshme	417,951,302.80	279,256,691.00
42		II.AktivetAfatgjata	2,801,191,237.79	2,632,513,390.89
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	28,903,400.28	24,180,382.28
44	201	Prime teemisionitdheRimbursimittehuave		
45	202	Studimedhekerkime	28,903,400.28	24,180,382.28
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e tengjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjatamateriale	2,323,140,367.51	1,887,437,537.61
48	210	Toka, T,roje, Terene	5,263,276.00	5,263,276.00
49	211	Pyje, Plantacione	7,969,600.00	4,433,200.00
50	212	Ndertesa e Konstruksione	579,258,344.36	461,982,158.76
51	213	Rruge, rrjete, vepraujore	1,644,824,970.47	1,361,437,173.47
52	214	Iinstalimeteknike, makineri e paisje	28,486,288.04	25,578,283.04
53	215	MjeteTransporti	31,325,386.32	5,078,408.32
54	216	RezervaShteterore	0.00	0.00
55	217	Kafshepune e prodhimi	288,000.00	288,000.00
56	218	Inventarekonomik	25,724,502.32	23,377,038.02
57	24	Aktiveafatgjatatedemtuaara		
58	28	CaktimeteAktiveveAfatgjata		
59	25-26	3.Aktive AfatgjataFinanciare	0.00	0.00
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	449,147,470.00	720,895,471.00
63	230	Per AktiveAfatgjata jo materiale		
64	231	Per AktiveAfatgjatamateriale	449,147,470.00	720,895,471.00
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	545,587,475.30	393,988,322.10

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 0 lekë.**
- Aktivet 3,473,925,289.00lekë
- Pasivet 3,473,925,289.00lekë
- Aktivet neto 0 lekë.

I.Aktivet Afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **672,734,051.35lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën **148,553,794.19lekë**
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **33,435,009.86lekë**
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **72,793,944.50lekë.**
- Llogaria e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën **417,951,302.80lekë.**

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në vlerën prej 148,553,594.19 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 95,604,480.23 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 96,122,793.23lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuidimeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 148,553,794.19lekë.(sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”).

Rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogaria nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave

Viti 2022

Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 148,553,794.19lekë. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit është e analizuar si më poshtë: **Tabela: Testimi i llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin ushtrimor 2022**

I.Të trashëguara nga viti 2021	Lekë
Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat:	
Granti i trashëguar	27,895,725.29
Të ardhurat të trashëguara	26,722,365.99
Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)	32,032,194.00

Fondespecifike	4,716,002.00
Jashtelimiti	
Totali	91,366,287.28
II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit	
	Lekë
Granti I vitit	124,982,705.00
Tëardhurat e vitit	102,000,000.00
Të hyra nga mjetet në ruajtje	30,171,662.00
Grantispecifik	66,970,165.00
Shtese Grandi	8,559,000.00
BuxhetiShtetit	
FZHU	
Jashtelimiti	17,709,016.72
Tot.	350,392,548.72
Totali I të ardhurave (I+II)	441,758,836.00
III.Lëvizjetkreditoritëlllogarisë 520	
	Lekë
Paga sigurime (600+601)	151,950,620.00
Shpenzime operative (602)	90,797,188.05
Kthim fondi Donatorit (Tepruar nga realizimi I projektit)	3,446,653.14
Kuota e keshillit qarkut Elbasan	800,000.00
Fondi Emergjence	5,955,000.00
Subvencione (603)	3,700,000.00
Transferta ke individet	4,875,000.00
Investime(231)	109,230,519.09
Studimedheprojekte(230)	8,800,000.00
Dalje per mjeete ne ruajtje (plan)	62,203,856.00
Totali	441,758,836.00
Gjendja debitore (Saldi) (I+II) – III =	0

Tabela: Përpunuar nga audituesi i Klsh-së

Në këtë rast, llogaria 520 “Disponilitete në Thesar” e **rakorduar me të dhënat** e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor **në përputhje** me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës së shpenzimeve e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit duke analizuar dokumentat e nxjerrjes së llogarive nga thesari për çdo muaj, për shumat e llogarive në cdo muaj dhe në total për vitin ushtrimor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i vitit 2022 i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çelje) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

▪ **Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
31	Materiale	4,774,196.94	1,113,887.23	3,660,309.71
32	Objekte inventari	28,660,812.92	24,169,704.92	4,491,108.00
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)			
	Totali	33,435,009.86	25,283,593.15	8,151,417.71

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Belsh në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 33,435,009.86 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 4,774,196.94 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 28,660,812.92 lekë.
- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 8,151,417.71 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 8,151,417.71 lekë.

- Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 4,774,196.94 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022. Gjendja e llogarisë në 31.12.2021 sipas komisionit të inventarizimit të magazinës përbëhet nga:
 - Gazoil
 - Materiale konsumi, kancelarie, elektrike, hidraulike...etj.
- **Llogaria 327 “Objekte inventari”**, ka vlerën 28,660,812.92 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Belsh ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit nr.131 datë 14.11.2022, ku janë përcaktuar Grupet për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Nga inventarizimi nuk kanë rezultuar diferenca.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

- **Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme			
401-408	Furnitor e llogari te lidhura me to	420829801.80	281230034.10	139599767.70
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	8440394.00	17032476.00	-8592082.00
431	Tatime e taksa	419649.00	770608.00	-350959.00
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	0.00	0	
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0.00	0	
435	Sigurime Shoqërore	2848906.00	2299715.00	549191.00
436	Sigurime Shëndetësore	390770.00	316397.00	74373.00
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0.00	0	
464	Detyrime per tu paguar per bl e letrave me vlere	1948300.00	1771700.00	176600.00
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	54842228.00	32032194.00	22810034.00
467	Kreditore te ndryshëm	408382.50	4866854.00	-4458471.50
4342	Te tjera operacione me shtetin	15386600.50	26744393.10	-11357792.60
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0.00	0	
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	0.00	0	
	Totali	560974075.80	420732715.20	140241360.60
	Të tjera aktive afatshkurtra	0.00	0	
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	0.00	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënies me thesarin	0.00	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0.00	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0.00	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	417951302.80	279256691.00	138694611.80
	Totali	978925378.60	699989406.20	278935972.40

Burimi: Sektori i Financës.

- **Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”**, në fund të vitit 2022 është në vlerën 55,459,044 lekë.

Tabela e debitoreve.

Bashkia dhe NjA	Pershkrimi	Nr. Subjekte Fizik/Juridik dhe gjaja balinspektoriat	Gjendja 31.12.2020	Viti 2021			Viti 2022		
				Debi	Kred i	Mbetja 31.12.2021	Debi	Kred i	Mbetja 31.12.2022
Bashkia Belsh	Debitornga KLSH	194				48,326,044	0	0	48,326,044
	DebitorNgaAPP	14				900,000	0	0	900,000
	Gjoba Insp. NdertimidhePolici a Bashkiake	15				6,271,000	57,000	19,000	6,233,000
	Shuma	231				55,497,044.00			55,459,044.00

Burimi: Përpunuar nga audituesi i Klsh-së.

- Nga të dhënat e mësipërme u konstatua që për vitin 2022, njëjti si edhe për viti 2021, në pasqyrat financiare janë pasqyruar “Debitorët e lënë nga Klsh” ndër vite, veprim ky në vlerën 48,326,044 lekë.

Duke analizuar analitikun e paraqitur nga Drejtoria e Financës për llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, vihet re se gjodat nga Inspektoriati i Ndërtimit të vendosura në vite, janë të

pasqyruara në bilanc. Duke theksuar gjobat e mbartura nga viti 2021, si dhe gjobat e vitit 2022 dhe 2021. Nga dokumentacioni i marrë nga Sektori i Aseteve rezulton se, në vitin 2021 debitorët (4 fizik/juridik) që rrjedhin nga gjobat e Inspektoriatit të mbrojtjes së Territorit rezulton se janë trashëguar nga vitet e mëparshme në vlerën 6,000,000 mijë lekë.

Gjobat e detajuara në tabelën e mëposhtme.

Tabela e Gjobave të IMT-së.

Nr	Subjekti fizik/juridik	Vlera
1	I.D.	500,000
2	F. Xh.	500,000
3	V.T.	500,000
4	P. Z.	500,000
5	F.K.S.	500,000
6	D.F. K.	500,000
7	Th. B..	500,000
8	Z. Xh. K.	500,000
9	P.D. A.	500,000
10	N. T.	500,000
11	A. P.	500,000
12	D. S.	500,000
13	E.K.	15,000
14	L.Xh.	1,000
15	Xh. P.	2,000
Totali dero me vitin 2022		6,018,000.00

Burimi: Përpunuar nga audituesi i Klsh-së.

në mijë lekë

Llogaria 4342 “Te tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 15,386,600.50 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 15,386,600.50lekë, në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 32. Vlera prej 15,386,600.50 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Tabela e Llog së Klasës së 4. Të pasivit.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Paga personeli llog 42	8,440,394.00
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	419,649.00
Sigurime shoqërore llog.435	2,848,906.00
Sigurime shëndetësore llog.436	390,770.00
Llogaria nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” (pjeserisht)	408,382.50
Llogaria nr.401-408 “Furnitore e llogari te lidhura me to (pjeserisht)	2,878,499.00
Totali	15,386,600.50

Burimi: Përpunuar nga grupi i Klsh.

Duke analizuar analitikun e paraqitur nga Drejtoria e Financës për llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, nga sistemi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Belsh konstatohet se vlera e debitorëve të nxjerrë nga Klsh (vetëm për taksat dhe tarifat që mblidhen nga Drejtoria e Taksave) për vitin 2021 dhe 2022 për 119 subjekte është në shumën prej 8,391,446 lekë. Shumë kjo, e cila nuk është e pasqyruar në bilanc, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”. *Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.*

Titulli i gjetjes	Kontabilizimi në vlerë më të ulët, për llogarinë nr. 468 “ <i>Debitorë të ndryshëm</i> ”.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, duke analizuar analitikun e paraqitur nga Drejtoria e Financës për llogarinë nr. 468 “ <i>Debitorë të ndryshëm</i> ”, nga sistemi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Belsh konstatohet se vlera e debitorëve të nxjerrë nga Klsh (vetëm për taksat dhe tarifat që mbliidhen nga Drejtoria e Taksave) për vitin 2020 dhe 2021 për 119 subjekte është në shumën prej 8,391,446 lekë. Shumë kjo, e cila nuk është e pasqyruar në bilanc, në llogarinë nr. 468 “ <i>Debitorë të ndryshëm</i> ”
Kriteri:	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “ <i>Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare</i> ”, neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “ <i>Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara</i> ” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 8 “ <i>Të ardhurat</i> ”, pika 8.
Ndikimi/Efekti	Mos kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët.
Shkaku	Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Drejtoria e Financës Bashkia Belsh, të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në shumën prej 8,391,446 lekë, në llogarinë nr. 468 “ <i>Debitorë të ndryshëm</i> ”.

-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën **417,951,302.8 lekë**.

Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime për shpenzime të kryera, por jo të financuara në vitin ushtrimor. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr.401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në pasiv të bilancit në vlerë 417,951,302 lekë e cila përbëhet nga vlerat 328,522,554 për detyrime të prapambetura deklaruar në sistemin e thesarit dhe 89,398,748 lekë për faturat e muajit dhjetor 2022 të cilat nuk kanë përmbushur afatin ligjor për deklarim në sistemin e thesarit.

Tabela për shpenzimet përkatëse :

Burimi: Sektori i Financës.

Titulli i gjetjes	Mbi kontabilizimin e Aktiveve Afatgjata Financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për viti 2022.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB), se në datën 15.07.2016 Bashkia Belsh paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Belsh SHA me NUIS “L63215202R” e cila është shoqëri aksionare me objekt “ <i>Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij</i> ”. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 45,434,140 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 45,434,140 lekë . Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Belsh në “ <i>Ujësjetllës Kanalizime Belsh</i> ” Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2018, 2019 dhe 2020, në llogarinë 26 “ <i>Pjesëmarrje në kapitalet e veta</i> ” në kundërshtim me UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “ <i>Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara</i> ”, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “ <i>Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale</i> ” pikat 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “ <i>Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje</i> ” Në këtë rast, investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 45,434,140

	lekë dhe Investitori është Bashkia Belsh. Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 45,434,140 lekë përbën mos pasqyrim të informacionit financiar. Kjo situatë është në kundërshtim me Ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014, “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pikat 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, duke deformuar informacionin financiar përsa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 dhe 2019 të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.
Kriteri:	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 64, datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 8 “Të ardhurat”, pika 8.
Ndikimi/Efekti	Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar përsa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.
Shkaku	Moszbatimi i kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Nga Bashkia Belsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetës Kanalizime Belsh” SHA me vlerë kontabël 45,434,140 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Shënim: Referuar ekstraktit historik datë 12.04.2023 nuk është bërë kalimi i aksioneve nga Bashkia Belsh në shoqërinë aksionare Ujësjetës Kanalizime Belsh Sh.A. pasi aktualisht bashkia rezulton 100% aksionere e të gjitha kotave. Nga komunikim me drejtorinë e financës dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se shoqëria Ujësjetës Kanalizime Belsh Sh.A. duke qenë se nuk është bërë akoma transferimi i të gjithë dokumenteve të nevojshëm, grupi i auditimit shpreh rezerva në pjesën e përqindjes.

AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 24,180,382.28 lekë në fund të vitit 2021 dhe në vitit 2022 në vlerën 28,903,400.28 lekë.

Gjithashtu sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në fund të vitit ushtrimor 2022 llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 28,903,400.28 lekë.

Analitiku i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime” përbëhet nga disa projekte të Bashkisë Belsh në vlerën 42,792,471 lekë. Për këto aktive ka inventar, si dhe ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv në *përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e*

aktivitet, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”

-Këto studime dhe kërkime janë të mbartura nga vitet e mëparshme nga ish Komunitat (sot njësi ADM) në territorin e Bashkisë Belsh dhe projekte të reja të krijuara nga viti 2015.

Për studimet dhe kërkimet të cilat kanë mbetur gjendje pra në vlerën bruto 102,045,460 lekë, llogaritja e amortizimit bëhet në masën 15%. Nga auditimi i kësaj llogarie rezultoi se **amortizimi në vitin ushtrimor 2022 është kryer** në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, **pika 36** ku citohet: Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.

Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;

- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

Titulli i gjetjes	Mbi rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Jo materiale, si dhe mos kontabilizimi i projekteve të bëra dhuratë në llogarinë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”.
Situata:	Nga auditimi i kontratave të lidhura për investimet në Bashkinë Belsh, rezultoi se, për kontrata punimesh të lidhura nga Bashkia Belsh, projekti është kryer nga operatorë ekonomikë privatë si më poshtë:1. Kontrata “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Seferan”, lidhur në datën 24.01.2019 në vlerën 12,450,730 lekë, nga të dhënat e mara nga Bashkia Belsh rezultoi se projekti është dhuratë me akt dhurimi nr. 2748 datë 29.10.2018. Ky projekt nuk është bërë hyrje në magazinë dhe të paraqitet te pasqyra e pozicionit financiar me vlerën kontabël të vlerësuar në llogarinë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”.2. Kontrata “Sistemim dhe ndërtimi i terreneve sportive në shkollën 9-vjecare Grekan”, lidhur në datën 23.05.2019 në vlerën 3,243,114 lekë, nga të dhënat e mara nga Bashkia Belsh rezultoi se projekti është dhuratë me marrëveshje bashkëpunimi nr. 667 datë 26.02.2019. Ky projekt nuk është bërë hyrje në magazinë dhe të paraqitet te pasqyra e pozicionit financiar me vlerën kontabël të vlerësuar në llogarinë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 57.
Kriteri:	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për

	<i>menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ”, UMF nr. 64, datë 22.07.2014 “ <i>Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar</i> ” dhe Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 8 “ <i>Të ardhurat</i> ”, pika 8.
Ndikimi/Efekti	Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Belsh.
Shkaku	Mozbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Belsh, të bëhet regjistrimi në kontabilitet i 2 projekteve të dhuruara në llogarinë nr. 202 “ <i>Studime dhe Kërkime</i> ” duke u bazuar në dokumentacion shoqërues (marrëveshja/akti i dhurimit), si dhe Titullari i Institucionit të autorizojë rivlerësimin e tyre.

AKTIVETAFATGJATA MATERIALE (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 2,323,140,367 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 1,887,437,537.61 lekë, me një rritje të AAM-ve në shumën 435,702,829.9lekë.

Tabela e Llogarisës Klasës 21 “Aktive Afatgjata Materiale” 7/a

Llog.Kontabel	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2022	Shtesa 2022	Pakësime 2022	Gjendje në fund
	AAGJM	2,453,774,273	511,900,758	2,105,700	2,963,569,331.20
210	Toka ,troje, Terrene	5,263,276			5,263,276.00
211	Pyje, Kullota Plantacione	4,433,200	3,536,400		7,969,600.00
212	Ndërtesa e Konstruksione	577,185,684	140,375,294		717,560,977.60
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,752,432,358	342,916,384	928,800	2,094,419,942.00
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	45,520,660	4,601,720	93,500	50,028,879.60
215	Mjete transporti	34,297,923	17,511,960	910,800	50,899,083.00
216	Rezerva shtetërore	0	-	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	288000	-	0	288000
218	Inventar ekonomik	34,353,172.70	2,959,000.30	172,600	37,139,573.00
219	Amortizimi i AAGJM (-)	-	-	-	-

Burimi: Sektori I finances.

Tabela përmbledhëse e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”(Vlera Historike)

Emertimi	Llog.212	
	2020 dhe 2021	
	Nr. Aktiveve	Vlera
<i>Bashkia Belsh</i>	51	650,135,330.00
<i>Njësia Fierze</i>	8	29,171,641.00
<i>Njësia Grekan</i>	12	14,167,978.00
<i>Njësia Kajan</i>	10	18,369,310.00
<i>Njësia Rrase</i>	2	5,716,718.00
Shuma	83	717,560,977.00

Burimi: Përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Analitiku i llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” përbëhet nga 83 ndërtesa dhe konstruksion, ku për Bashkinë Belsh janë 51 në vlerën 650,135,330 lekë, për NJA Fierze janë 8 aktive në vlerën 29,171,641 lekë, për NJA Grekan 12 aktive në vlerën 14,167,978 lekë, NJA Kajan 10 aktive në vlerën 18,369,310 lekë dhe NJA Rrae 2 aktive me vlerë 5,716,718 .

Për këto aktive ndodhet një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv në përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e

sektorit publik”, pika 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

-Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 1,644,824,970 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën neto prej 136,1437,173.47 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 2,094,419,942 lekë.

Analitiku i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përbëhet nga 73 objekte, në vlerën totale 2,094,419,942. Për këto aktive ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv në përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

-Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 31,325,386 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 5078408.32 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 34,297,923 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 61,560,583 lekë.

Tabela: Analitiku i llogarisë nr.215 “Mjete transporti”

LLOGARIA 215					
	Emertimi	Njesia	Cmimi	Sasia	Vlefte
1	Makine plehrash	copë	2,990,400	1	2,990,400
2	Kamion Benz EL65-57B	cope	2882027	1	2882027
3	Furnizim dhe vendosje autovinc per kamionin e bashkise Belsh	cope	910800	1	910800
4	Esklavator me Zinxhira	cope	9,055,196	1	9,055,196
5	Makine Autoveture	cope	2,388,000	1	2,388,000
6	Kamion Transport Inertesh	copë	4,908,000	1	4,908,000
7	Zjarrfikse Renault	cope	3,828,000	1	3,828,000
8	Automjet Autoshkalle	cope	850,000	1	850,000
9	Makina Benz AA 810 LV	cope	700,000	1	700,000
10	Makine Zjarrfikese Man El5580B	cope	850,000	1	850,000
11	Fadroma	cope	2,990,000	1	2,990,000
12	Veture tip Benz	cope	999,000	1	999,000
13	Autovetura Benz 250D	cope	946,500	1	946,500
14	Automjet me pirun	Cope	1,256,000	1	1,256,000
15	Makine teknologjike	cope	9,917,400	1	9917400
16	Bicikleta elektrike	cope	102,000	3	306000
17	Bicikleta Mali	cope	30,600	20	612000
18	Kanoa milo	cope	144,000	2	288000

19	kanoa semik	cope	132,000	2	264000
20	kanoa SF 1007	cope	126,000	2	252000
21	Kanoa SF1006	cope	111,600	4	446400
22	Kanoa SF 1004	cope	114,000	2	228000
23	Kanoa Happiness	cope	121,200	4	484800
24	Kanoa by sup 069	cope	105,600	3	316800
25	Lopata	cope	5,400	15	81000
26	Sendile per kajak	cope	18,000	3	54000
27	Top I fryre me ajer	cope	54,000	2	108000
28	Cilinder argetues	cope	26,400	2	52800
29	Ëind sup Fëës	cope	156,000	2	312000
					61,560,583.00

Burimi: Sektori i Financës.

... në mijë lekë.

Analitiku i llogarisënr.215 “Mjete transporti” përbëhet nga 29 mjete, në vlerën totale 61,560,583 lekë. Për këto aktive ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv në përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

-Llogaria nr.218 “Inventar ekonomik”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 25,724,502.00 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 23,377,038.02 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 34,353,172.70 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 37,139,573.00 lekë. Gjatë vitit ushtrimor kemi pasur shtesa në llogari të materialeve në vlerën 2,786,401.00 lekë.

- Gjendja e llogarisë nr.219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Belsh në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën (673,329,609) lekë.

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto të tyre”

Nr.	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica
Reference	Neto	Historike		Historike		Historike	Akumuluar	Neto
Llogarije								
b	3	4	5	6	7	8	9	10
20	24,180,382	8,350,075	3,627,057	0	0	51,142,546	22,239,146	28,903,400.28
201	0					0	0	0.00
202	24,180,382	8,350,075.00	3,627,057			51,142,546	22,239,146	28,903,400
203	0					0	0	0.00
21- 28	1,887,437,538	522,562,258	84,950,728.00	2,105,700	197,000	2,974,230,831	651,090,464	2,323,140,367.51
210	5,263,276					5,263,276	0	5,263,276
211	4,433,200	3,536,400.00				7,969,600	0	7,969,600
212	461,982,159	140,375,293.60	23,099,108.00			717,560,978	138,302,633	579,258,344
213	1,361,437,173	342,916,384.00	58,599,787.00	928,800.00		2,094,419,942	449,594,972	1,644,824,970
214	25,578,283	4,601,720.00	1,692,215.00	93,500.00	92,000.00	50,028,880	21,542,592	28,486,288

215	5,078,408	28,173,460.00	1,015,682.00	910,800.00		61,560,583	30,235,197	31,325,386
216	0	0.00		0.00		0	0	0
217	288,000	0		0.00		288,000	0	288,000
218	23,377,038	2,959,000.30	543,936.00	172,600.00	105,000.00	37,139,573	11,415,071	25,724,502
24	0					0	0	0
28	0					0	0	0
	1,911,617,919.89	530,912,333	88,577,785	2,105,700	197,000	3,025,373,377	673,329,609	2,352,043,768

Burimi: Sektori I Financës.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë sipas normave të amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh. Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2021 për klasat e aktiveve është përlllogaritur në vlerën prej (425,071,008) lekë, duke debituar llogarinë nr.1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në kredi të llogarive nr.2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 138,302,633.00 lekë, llogarisë nr.2194 “Amortizim makineri dhe pajisje” në vlerën 21,542,592 lekë, llogarisë nr.2195 “Amortizim mjete transporti” në vlerën 30,225,197 lekë, llogarisë nr.2198 “Amortizim inventar ekonomik” në vlerën 11,415,071 lekë. Pikësimet gjatë vitit ushtrimor 2022 nuk ka pasur.

-Inventarizimi i aktiveve për vitin ushtrimor 2022, Bashkia Belsh.

Është kryer inventarizimi i aktiveve afatshkurtra, bazuar në urdhrat e Kryetarit të Bashkisë Belsh. nr.3421 date 04.11.2021, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit, komisionit të vlerësimit dhe komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të pasurisë së bashkisë dhe Njësi Administrative për vitin 2022, në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Komisionet e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të bashkisë.

Me Urdhrin nr. 11 date 07.02.2023 është ngritur nga Titullari komisioni për nxjerrjet jashtë përdorimit të inventarit të imët e materialet. Urdhri është për daljen jashtë përdorimit dhe shkarkimin nga kontabilitetit për inventarët si më poshtë:

Viti 2022	Inventar i imët	Inventar	Inventar ekonomik
	llogaria 327-1	llogaria 214	llogaria 218
Bashkia Belsh	1,603,142	2,885,300	181,600

Janë hartuar relacionet mbi vlerësimin e inventarëve të Bashkisë Belsh dhe Njësi Administrative, si dhe janë firmosur nga Nëpunësi Autorizues. Janë hartuar procesverbalet e vlerësimit për materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, si dhe këto procesverbale janë miratuar dhe janë me firmën e Titullarit të Bashkisë Belsh.

Në relacionet e vlerësimit thuhet që materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi janë të pa përdorshme, kanë humbur cilësitë e tyre të përdorimit në kushtet teknike si dhe nuk mund të riparohen për tu a rikthyer vlerën, megjithëse nuk u ka kaluar afati vlefshmërisë. Komisioni në këto kushte ka vlerësuar se këto materiale duhet të nxirren jashtë përdorimit nëpërmjet asgjësimit fizik

Me Urdhrin nr. 11 date 07.02.2023, është ngritur komisioni i asgjësimit të aktiveve për vitin 2022 për Bashkinë Belsh, e përbërë nga: (O. U.) kryetare, (O. R.) anëtare, (D. P.) anëtar, (A. H.) anëtare (K. G.) anëtar. Pas procedurës së asgjësimit nga bashkia është bërë kërkesë për fillimin e procedurës së Ankandit, sipas Udhëzimit nr.30, dt 27.12.2011 ‘Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Prokurimit’, pika 109 ku citohet: “Aktivet të cilat pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand

ndërmarrjeve që i grumbullojnë”. Sasia totale e hekurishteve me qëllim shitjen në ankand është 1.359 kg+69.27 kg =1,428.27 kg hekurishte. Gjithashtu bashkëlidhur dokumenteve dhe një kopje të flet hyrjes së hekurishteve në magazinë, në vlerën totale 1731,75 lekë.

AKTIVET AFATGJATA FINANCIARE

Gjendja e llogarisë nr.231 “Investime në proces”

Gjendja e llogarisë nr.231 “Shpenzime për rritjen e Aktiveve Afatgjata të Trupëzuara” në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën prej 449,147,470 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 720,895,471 lekë.

Sipas analitikëve të paraqitur nga Drejtori e Ekonomisë për vitin 2021 paraqiten 43 Investime në proces, ndërsa për vitin 2022 paraqiten 26 Investime në proces.

➤ **PASIVET (DETYRIMET)** **Bilanci kontabël Bashkia Belsh**

65	B	PASIVET(DETYRIMET)	545,587,475.30	393,988,322.10
66		I.Pasivet Afat shkurtra	545,587,475.30	393,988,322.10
67		1. Llogari te Pagushme	545,587,475.30	393,988,322.10
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	420,829,801.80	281,230,034.10
69	42	Detyrime ndaj personelit	8,440,394.00	17,032,476.00
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	419,649.00	770,608.00
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	2,848,906.00	2,299,715.00
76	436	Sigurime Shendetsore	390,770.00	316,397.00
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	1,948,300.00	1,771,700.00
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	54,842,228.00	32,032,194.00
82	467	Kreditore te ndryshëm	408,382.50	4,866,854.00
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	55,459,044.00	53,668,344.00
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0.00	0.00
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0.00	0.00
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16,17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,928,337,813.84	2,721,372,582.27
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,928,337,813.56	2,721,372,581.99
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,385,478,977.37	1,936,904,825
99	12	Rezultatet e mbartura	0.00	1,887,193.00
100	85	Rezultati I Vepimtarise Ushtrimore	93,711,366.19	61,685,093.23
101	111	Rezerva	0.00	0.00
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve	73,584,381.00	55,958,198.00

	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime	0.00	0.00
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	375,563,089.00	664,937,273.00
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0.00	0.00
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0.00	0.00
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0.00	0.00
107		Te Tjera	0.00	0.00
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	3,473,925,289	3,115,360,904

Burimi: Sektori i Financës.

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Belsh më 31.12.2022, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Tabela e pasiveve afatshkurtra.

Llog	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
42	Detyrimendajpersonelit	8,440,394.0	17,032,476.0	-8,592,082.00
431	Detyrimendajshitetit per tatimtaksa	419,649.0	770,608.0	-350,959.00
435	SigurimeShoqerore	2,848,906.0	2,299,715.0	549,191.00
436	SigurimeShendetsore	390,770.0	316,397.0	74,373.00
464	Det.pertupaguar per bl.letrave me vlere	1,948,300.0	1,771,700.0	176,600.00
466	Kreditore permjete ne ruajtje	54,842,228.0	32,032,194.0	22,810,034.00
467	Kreditoretendryshem	408,382.5	4,866,854.0	-4,458,471.50
		69,298,629.5	59,089,944.0	10,208,685.50

Burimi:Përpunuar nga grupi i Klsh-së

***Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit ushtrimor 2022 është në vlerën 420,829,801.80 lekë.**

Tabela e llog 401-408

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”	
Celje e vitit 2021	281,230,034.10
Shtesa (K)	344,211,811.00
Pakësime (D)	204,612,044.00
Gjendja në 31.12.2022 (K)	420,829,801.80

Burimi: Përpunuar nga grupi i Klsh

***Gjendja e llogarisë 467 në shumën 408,382.50 lekë përbëhet nga detyrimi për shpërblim këshilltarë & kryetar fshati 2022.**

Tabela e Kreditorëve të ndryshëm.

467	Kreditore te ndryshem				
4	Keshilltar shperblime viti 2022				408,382.50
	Kreditore te ndryshem shuma 4				408,382.50

Burimi: Sektori i Financës.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Belsh, paraqitet në vlerën 8,440,394 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të muajit Dhjetor.

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

Tabela e urdhër-shpenzimeve:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
01	13.01.2023	6,352,485
02	13.01.2023	10,000
03	13.01.2023	195,804
04	13.01.2023	232,350
05	13.01.2023	1,371,937
06	13.01.2023	223,040

07	13.01.2023	54,778
	Shuma	8,440,394.00

Burimi: Përpunuar nga grupi i Klsh-së

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 419,649 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Tabela e urdhër-shpenzimeve:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
12	16.01.2023	347,581
		72,068
	Totali	419,649.00

Burimi: Përpunuar nga grupi i Klsh-së

- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatësisht në vlerat 1,125,695 lekë dhe 1,723,211 lekë.

Tabela e urdhër-shpenzimeve:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
08	16.01.2023	1,723,211
09	16.01.2023	1,125,695
10	16.01.2023	195,385
11	16.01.2023	195,385
	Totali	2,848,906

Burimi: Përpunuar nga grupi i Klsh-së

-**Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”,** nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël prej 54,842,228 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit Belsh.

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

Llogaritë e financimit nga buxheti i shtetit për vitin 2022 (grant) paraqitet në shumën prej 261,053,887 lekë. Të ardhurat e realizuara nga Bashkia Belsh për vitin 2022 janë 67,371,823.34 lekë nga të cilat: Të ardhurat tatimore në vlerën 62,990,346 lekë dhe të ardhurat jo tatimore në vlerën 4,381,477 lekë, sipas aktit të rakordimit me degën e Thesarit Belsh.

-**Llogaria nr.7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 22,215 lekë e cila referuar dhe akt akordimit me thesarin. Nga viti 2021 ky zë vjen me rritje nga vlera 422,701 lekë.

-**Llogaria nr.7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 29,048,427 lekë me një shtesë prej 28,136,892 nga viti 2021.

-**Llogaria nr.7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 11,230,235 lekë, ku sipas aktrakordimit me thesarin në të përfshihen:

Tabela analitike e llojit të ardhurave të Bashkisë:

N.r.	Art.	LLOJI I TË ARDHURAVE	Totali
1	7002100	- Takse vendore mbi biznesin e vogel	22,215.00
2	7002200	- Tatim i thjeshtuar nbi fitimin	96,299.00
3	7020100	- Tatim mbi token bujqesore	13,392,473.00
4	7020200	- Tatim mbi ndertesat	15,655,954.00
5	7033016	- Takse vjetore automjete	7,168,638.00
6	7035001	- Takse regjistrim bizn.	14,125.00
7	7035002	- Takse zenie haps. publike	3,138,818.00
8	7035003	- Takse vend.ndik.infrastruktures nga ndertimet e reja dhe legalizimet	2,969,368.00
9	7035009	- Takse vendore e tabelës	171,690.00
10	7035013	- Tarif Gjelbrimi	350,009.00

11	7035015	- Takse e perkohshme vendore per infrastrukturen arsimore	200.00
12	7035023	- Tarif Ndricimi	2,042,268.00
13	7035025	- Taks Trualli	224,585.00
14	7035026	- Taks vendore per ujin	134,000.00
15	7035028	- Tarife per perdorim certificate	205,532.00
16	7035029	- Tarife per autorizim urbanistik	85,000.00
17	7035033	- Tarif per Vertetim	84,837.00
18	7035032	- Tarife per leje zhvillimi	70,000.00
19	7035040	- Tarif per Leje Ndertimi	1,739,803.34
20	7109200	- Te ardhura nga qera per troje	921,412.00
21	7109600	- Te ardhura nga qera per ndertesat	202,253.00
22	7110106	- Tarifa per leje transporti	436,179.00
23	7110501	- Tarifa pastrimi dhe higjene	13,789,688.00
24	7035014	- Taksa vendore e pastrimit	75,000.00
25	7110599	- Te tjera tarifa administrative dhe rregullatore te njesive vendore	3,621,074.00
26	7113009	- Te ardhura miratim projekti MNZSH	33,000.00
27	7113011	- Te ardhura nga Sherbim MNZSH	15,000.00
28	7115420	- Te tjera Gjoha	288,325.00
29	7115500	- Kamat Vonesa	424,078.00
		Totali	67,371,823.34

Burimi: Sektori i Financës.

-Llogaria nr.7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 1,123,665 lekë.

-Llogaria nr.711 “Të ardhurat nga shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare” pasqyrohet në bilancin e vitit 2022 për vlerën kontabël 18,607,344 lekë.

Llogaritë e shpenzimeve të konstatuara sipas Pasqyrë së Performancës Financiare, sipas natyrës dhe klasifikimit të këtij formati rakordojnë me shumat e rezultuar në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor me akt rakordimet e thesarit.

Pika .4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

4.4. Auditim mbi hartimin e zbatimit e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve;

4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara;

4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);

4.4. Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomik fitues).

Të përgjithshme:

U auditua Regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve,

Kërkesat e administruara nga sektorët përkatës ,

Grupi i KLSH-së, referuar të djënave të marrë në subject reulton se për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar **15** procedura prokurimi, me fond limit 176 ,102 ,109 mijë. Nga auditimi i 15 procedurave të prokurimit publik, u audituan 4 procedura me vlere 53,684,136 lekë ose 30% e fondit limit.

a- Në **15** u audituan **4** procedura të trajtuara si mëposhtë .

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit, në Bashkinë Belsh, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit 01.01.2022-

Nr.	Emertimi i procedurave	Vlera e perlogaritur	Vlera Fituese				
			Mallra	Sherbime	Investime	Dif përdorur /pa	%
1.	"Blerje makine teknologjike dhe kontenier për mbledhjen e mjeteve urbane".	9 800 000	9 223 000			577000	94.
2.	"Furnizimi dhe vendosje tabela për sinjalistikën rrugore".	2 495 554	2 122 400			373154	85
3.	"Hartimi dhe zbatim i planit promocial, si dhe organizim pakete eventesh dhe aktivitetesh promocial dhe turistike Javën e Hapur".	2 967 669		2 730 255		237414	92
4.	"Ndërtim i tregut Bujqësor-blegtoral Belsh"	24 941 052			18 270 845	6670207	73
5.	"Paketë shërbimi, mirëmbajtje për angazhimin, implementimin dhe certifikimin e destinacioneve të gjelbërta dhe të qëndrueshme".	1 830 000		1 714 200		115800	93
6.	"Pemë dekorative për vitin 2022".	3 490 000	2 947 000			543000	84
7.	"Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të shërbimit".	3 325 200		2 651 100		674100	79
8.	"Sistemi dhe asfaltim i rrugës Belsh-Hysë"	61 000 000			39 993 336	21,006,664	65
9.	"Blerje artikuj ushqimor për Qendrën Sociale Ditore për moshën e tretë "Nderim Brezash".	1 352 000	1 299 225			52775	96
10.	"Blerje materiale për rikonstruksionin e pjesshëm të molit dhe stolit në sheshin Ansambli Rilindja Belsh"	2 529 470	2 100 100			429370	83
11.	"Fuqizimi i ofertës turistike me anë të zgjidhjeve ekologjike mjeteve lundruese"	3 549 497	3 291 500			257997	92
12.	"Fuqizimi i ofertes turistike me anë të zgjidhjeve ekologjike, blerje mjete motorrike"	6 666 400	6 499 000			167400	97
13.	"Karburant dhe vaj".	8 000 000	8 000 000			0	100
14.	Rikonstruksioni i Rruges "Rrasë-Hysgjokaj, Pajallinj, Beqiraj, Gradisht".	41 666 667			27 671 948	13994719	66.
15.	"Blerje pajisje elektronike dhe elektrike per zyrat e Bashkise Belsh".	2 488 600	2 148 890			339710	86
	Shuma totale	176 ,102 ,109	37,631 ,115	7 ,095 ,555	85 ,936 ,129	45,439,310	74%

31.12.2022, ku janë realizuar 15 tendera nga të cilët 3 tendera investime dhe 11 mallra shërbime nga grupi I auditimit u audituan audituar **4 tendera mallra shërbime me fond limit** në vlerën **74,538,497 lekë pa TVSH** dhe kontrata të lidhura në vlerën lekë pa TVSH në vlerën **53,684,136lekë pa TVSh** ose në masën **72 %**, e fondit limit, me ulje nga FL në vlerë 21,486,361 lekë nga fondi limit.

Tabela me prokurimit për vitin 2022,

Tabela e prokurimeve për vitin 2022, mallra shërbime/investime

Burimi Bashkia Belsh

Punoi grupi Klsh

Nga objektet e prokuruar për periudhën e auditimit, u vendos për t'u audituar nga grupi i auditimit mallra /sherbime si vijon: Për periudhën e auditimit e auditimit (01.01.2022-31.12.2022), u parashikuan për tu audituar **4 (katër)** procedura prokurimi me FL në vlerën **74,538,497 lekë pa TVSH** dhe kontrata të lidhura në vlerën **53,684,136 lekë pa TVSh**, pa TVSH me ulje nga FL në vlerën 21,486.361 **me pak se fondi limit** .

4.1 Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrat të prokurimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, është hartuar Regjistri i parashikimeve për vitet 2022 si dhe Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitet 2022.

Nga auditimi rezultoi se: NJP dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu II regjistri i parashikimeve dhe realizimeve Neni 3 Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik ku cilësohet: "1. Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, AK është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrat vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së".

Dërgimi i regjistrat të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 285, neni 6. Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet/shoqëritë me kapital mbi 50% shtetëror

apo çdo autoritet/ent kontraktor tjetër jobuxhetor përgatisin regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, bazuar në programet e zhvillimit ekonomik dhe në çdo rast jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo programet e zhvillimit ekonomik nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse,

Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit ka patur ndryshim të regjistrin të parashikimeve, për të cilat është bërë buxheti i tyre. Të gjitha ndryshimet janë hedhur në SPE, referuar VKM nr. 285 datë 19.5.2021, me ndryshime, neni 3, pika 7 ku cilësohet: “7. Autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste kur këto ndryshime vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrin. Çdo ndryshim i regjistrin të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti ose enti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik, dhe publikimi i tij nga APP-ja bëhet brenda 3 (tri) ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem”

Auditimi i proceduarave të prokurimit

1. Procedura : Fuqizimi i ofertës turistike me anë të zgjidhjeve ekologjike, blerje mjete motorike”

1.Urdhër Prokurimi : Nr.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1.R. D. 2.A. L. 3.J. T.	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: 1.A. H. 2.M. E. 3.A. H.
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,666,400 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE: A. Z. sh.p.k 6,499,000	7.Diferenca me fondin limit: -167,400
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 12.08.2022	9.Burimi Financimit:	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 6 OE 1.: “A. Z. sh.p.k 2.A. M. sh.p.k
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Belsh
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së prokurimit

Kjo procedurë është tender i “E hapur”, me vlerë 6,666,400 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.

Mbi përcaktimin e blerjes , Në dosjen e prokurimit administrohet dokument për iniciimin e kryerjes së blerjes mallra.

Mbi përlogaritjen e fondit limit :

- Për argumentimin e fondit limit, në dosje ka dokumentacionin dhe kërkesat e adhurava nga sektori përkatës.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr.1235 prot, datë 26.04.2022, - Nga verifikimi i kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të vendosura, u konstatua se ato nuk janë konform DST. “Fuqizimi i ofertës turistike me anë të zgjidhjeve ekologjike blerje mjete lundruese”

Pjese e këtij procesverbali është:

- **Oferta (studimi i tregut)**
- **Specifikimet teknike**

Afati i lëvrimit do të jetë 10 dite nga momenti i lidhjes se kontratës.

Kriteret e veçanta

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 9001:2015** për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (e vlefshme) ose ekuivalente të tij. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ

i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kërkesat e cilësisë, pika 1 ISO 9001:2015: Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e investimit/kontratës.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie, që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së pajisjeve/ mjeteve objekt prokurimi, për një periudhë jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të mallit pranë autoritetit kontraktor.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.**

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Objekt i kësaj procedurë janë blerje mjeteve si :

- AUTOBUS ELEKTRIK
- STACIONI I KARIKIMIT
- MOTORR
- MOTORR ATTIVA - 4 VENDESH

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë:

Mbi vlersimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E Hapur”, “Mallra”. Në dosje administrohet procesverbal për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë **17.03.2022**. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	A. T.	6, 499, 000 lekë
2	A. M.	6, 660, 000 lekë

Burimi
Punoi:

i

të

dhënave:

SPE
KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot, datë 28.04.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. T. dhe është hedhur në sistem.

Sipas KVO-së, kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në DT dhe janë kualifikuar:

A. T. 6, 499, 000 lekë
A. M. 6, 660, 000 lekë

Në bazë të vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, operatori ekonomik A.M. shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë ligjor për të dëshmuar plotësimin e kërkesave për kualifikim të kërkuara sipas DST. Konkretisht:

-Operatori nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për sigurimin e ofertës, sipas Shtojcës 3; kërkesë e cila bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Operatori ekonomik ka ngarkuar ne SPE Pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe jo vërtetim xhiro vjetore. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Operatori nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e pikës 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (e vlefshme) ose ekuivalente e tij... - Kërkesat e cilësisë, pika 1 ISO 9001:2015:

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie, që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së pajisjeve/ mjeteve objekt prokurimi, për një periudhë jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të mallit pranë autoritetit kontraktor e cila garanton autoritetin kontraktor në cilësinë e mallit që do të dorëzohet.

Në lidhje me operatorin e shpallur fitues A. Z., për kriterin se OE duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, rezulton se:

-A. T. shpk ka dorëzuar një kontratë për punë të ngjashme me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit të Bashkisë Tiranë, në vlerën 1,230,000 lekë pa TVSH, e cila është nën fashën minimale prej 20% (1,333,280 lekë). Po, ashtu ka përcjellë disa fatura tatimore fotokopje për mallra motoçikleta që nuk lidhen me natyrën e mallrave të prokuruar, në këto kushte.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues **operatori A. T.**, **ka mangësi në dokumentacionin sipas specifikimeve teknike.**

Veprime jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 pika 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. si dhe dokumentet standarde(DST)

KVO ka bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me vlerë 6,499,000,lekë me TVSH me OE “A. Z.” Sh.P.K.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi. Komisioni përcaktimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta si dhe *komisioni i vlerësimit të ofertave* A. H, M. E, A. H.

Pretendimi i subjektit: sipas obesvaionit të sjelle nëpërmes emailit datë 21.12.2023, nga Komisioni i vlersimit të ofertave , A. H, M. E, A. H.

Bashkëlidhur nuk është përcjellë dokumentacion justifikues dhe vërtetues ,janë shprehur në observacion për fat tatimore me vlerat përkatëse, ndërkohë që bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pas shqyrtimit të observacionit, grupi i auditimit nuk merr në konsiderate observacionin e paraqitur nga subjekti.

2. Procedura: Fuqizimi i ofertës turistike me anë të zgjidhjeve ekologjike, blerje mjete lundruese ”

1.Urdhër Prokurimi : Nr.2792 datë 07.10.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. R. D. 2.A. L. 3.J. T.	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: 1.A. H. 2.O. R. 3.D. P.
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Ehapur Thjeshtuar ”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 3,549,497 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE: A.2. me vlerë 3,291,500lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit: -257,997
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 20.10.2022	9.Burimi Financimit: Bashkia	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 6 OE 1. “L. sh.p.k 2. A. Z.sh.p.k 3. A. 2 SHPK
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Burimi Bashkia Belsh
Punoi grupi KLSH-së

Hartimi i fondit limit

Me urdhrin nr.2356 datë 25.08.2022 ,është ngrit komisioni i përbërë nga V. I .,B. P., P. T. në përlllogaritjen e fondit limit janë referuar tre ofertave, me procesverbalin nr . 2793 datë 07.10.2022, Përlllogaritja e fondit limit si dhe caktimi i kriterëve të veçanta, Në këtë procedurë kanë marrë pjesë:

Operatori ekonomik **L. sh.p.k** me ofertë 2,980, 203lekë pa tvsh
Operatori ekonomik **A. Z. sh.p.k** me ofertë 3 479 065lekë pa tvsh
Operatori ekonomik **A. 2. SHPK** me ofertë 3,291,500 lekë pa tvsh

Në bazë të vlerësimit të KVO është skualifikuar ofertuesi L. për arsyet si mëposhtë:
Operatori ekonomik L. i cili nuk ka arritur të paraqes dokumentacion të plotë e të saktë ligjor që dëshmon plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim.

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorëzuar ne SPE nga operatori ekonomik L. SHPK është vërejtur se OE nuk ka përmbushur kriterin për punë të ngjashme prej 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, te cilat janë mallra të ndryshme nga ato që Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në DST. Nga auditimi konstatohet se OE L. ka sjellë një vërtetim datë 12.04.2021 për realizim punimesh me Ujësjiellësin e Tiranës në vlerën 133,096,140 lekë.

Komisioni vlerësimit të ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin A. 2.” P.F, i cili nuk ka kontrata të ngjashme, për krzerjen e shërbimit,

KVO ka bërë propozim tek Titullari i AK për lidhjen e kontratës kontratës me operatorin **A. 2. në vlerë 3,291,500 lekë pa tvsh.**

Veprime jo në përputhje me VKM-së, nr. 285 datë 19,05,2021 neni 40 pika 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.si dhe dokumentet standarde(DST)

Për këto veprime mbajë përgjegjësi, komisioni i vlerësimit të ofertave. A. H. ,O. R., D.P.

Pretendimi i subjektit:

sipas obesrvaionit të sjelle nëpërmes emailit datë 21.12.2023 nga Komisioni i vlerësimit të ofertave , A. H, M. E, A. H.

Bashkëlidhur është paraqitur nje raport i përgatitur nga KVO, që nuk ka dokumentacion vërtetues dhe argumentues .

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pas shqyrtimit të observacionit, grupi i auditimit nuk merr në konsiderate observacionin, e paraqitur nga subjekti.

3. Procedura me objekt “Sistemim dhe Asfaltim i Belsh-Stanaj”

1.Urdhër Prokurimi : Nr.184 datë 24.06.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur “	1.A. L. 2.J. T. 3.R. D.	1.M. B. 2.M. E. 3.A. H.
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 61,000,000 - lekë pa tvsh	24.Oferta fituese: B. 2. I. SHPK Vlera me 39, 993, 336 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit: 21,006,664 ,lekë
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 12.08.2022	9.Burimi Financimit:	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 24 OE Kualifikuar 22 operatore kualifikuar 2 skualifikuar OE 1. “ B. 2. I. SHPK OE Fitues
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar: *Kjo procedurë është tender i “E hapur”, me vlerë 61, 000, 000 pa TVSH dhe 73’200’000 Leke me TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.*

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij blerje:
Në dosjen e prokurimit administrohet dokument për inicimin e kryerjes punë.

Mbi përlogaritjen e fondit limit :

Për argumentimin e fondit limit, në dosje nuk administroheshin kërkesat dokumentacionin dhe kërkesat e ardhura nga Drejtoritë përkatëse. Por ndodhej në një tjetër dosje .

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr.1235 prot, datë 26.04.2022,

- Nga verifikimi i kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të vendosura,

Hartimi i projekteve dhe preventivit: Projektet dhe preventivi janë hartuar nga Studio Projektuese E.–G në vitin 2022, Titullari ka ngritur urdhrin nr. Për marrjen në dorëzim të projektit dhe preventivit.

Vlerësimi dhe Renditja Përfundimtare e ofertave.

Sa më sipër, në përfundim të kësaj procedure shqyrtimi dhe vlerësimi, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të kërkesave të neni 92 i Ligjit nr.162/2020”Për Prokurimin Publik”, dhe neni 82 i Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Rregullat të Prokurimi Publik”, **vendos (me tre vota pro):**

1. Të vlerësojë si të vlefshëm B. **2. shpk** me Nipt L.L & **I. SHPK** me Nipt J.Ë.
2. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **C. R. 2... shpk** me Nipt K.V.
3. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **N. shpk** me Nipt J.U .
4. Të vlerësojë si të vlefshëm B. **S. N. shpk** me Nipt L.P & **E. shpk** me Nipt K.P.
5. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **V. H. shpk** me Nipt K.C .
6. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **B. shpk** me Nipt K.E.
7. Të vlerësojë si të vlefshëm B. **L.T.E C. shpk** me Nipt L.F.
8. Të vlerësojë si të pa vlefshëm Operatori ekonomik **F. sh.p.k** me Nipt K.C.
9. Të vlerësojë si të pa vlefshëm Operatori ekonomik **B. sh.p.k** me Nipt J.B.
10. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **A. -2. CO sh.p.k** me Nipt K.C.
11. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **D. C. sh.p.k** me Nipt K.J.
12. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **Ll. sh.p.k** me Nipt K.K .
13. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatoriekonomik **SH.-AL sh.p.k** me Nipt K.N.
14. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **B. Nsh.p.k** me Nipt K.O.

15. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **I. sh.p.k** me Nipt J.L.
16. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **M. sh.p.k** me Nipt L.C.
17. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **RR. G. sh.p.k** me NiptK.H .
18. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **Z. sh.p.k** me Nipt J.K.
19. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **B. sh.p.k** me Nipt J.V.
20. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **C. sh.p.k** me Nipt J.S
21. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **G. sh.p.k** me Nipt K.A.
22. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **K.M.K sh.p.k** me Nipt L.E
23. Të vlerësojë si të vlefshëm Operatori ekonomik **SH. 07 sh.p.k** me Nipt K.Ë.

Skualifikuar 2 OE si më poshtë.

1. *Operatori ekonomik B. sh.p.k* nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë ligjor për të dëshmuar plotësimin e kërkesave për kualifikim të kërkuara sipas DST. Konkretisht:
2. **Operatori** nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e pikës **2. Kriteret e veçanta të kualifikimit** pika 1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**
b. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1; Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 te DST).

Është vlersuar dhe shpall fitues operatori ekonomik

me ofertë me te ulët dhe që plotëson kushte është kualifikuar operator Fitues. B. **2N shpk** me **Nipt L.L & I. SHPK** me **Nipt J.Ë** të renditur i pari Kvo ku shprehet se : OE rezulton se plotëson të gjitha kushtet e vendosura nga Njësia e Hartimit të dokumentacionit dhe është shpallur fitues.

KVO ka bërë propozim tek Titullari i AK për lidhjen e kontratës kontratës me operatorin **B. 2. I. SHPK** në Vlerë **39, 993, 336 lekë pa tvsh. Me një diference nga fondi limit prej 21,000,664 lekë.**

Nga auditimi rezultoi se dokumentacioni dhe vlerësimi është bërë sipas specifikimeve teknike por rezulton se oferta me e ulët është në vlerë 39,378,820,4 me një diferencë prej 614,515 lekë, nga operatori fitues më të ultë për këto duhej kërkuar informacion I detajuar dhe justifikues për OE fitues për justifikim dhe përmbushje me sukses të shërbimit ndaj institucionit në përputhje me kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Pretendimi i subjektit:

sipas obesrvaionit të sjelle nëpërmes emailit datë 21.12.2023,nga Komisioni i vlerësimit të ofertave , M. B.,A. H. M. E. (larguar)

Bashkëlidhur është paraqitur observacioni me argumentim për përlogaritjen e ofertës me të ulte pr vlersimin e procedurës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pas shqyrtimit të observacionit, grupi i auditimit merr në konsiderate observacionin, e paraqitur nga subjekti.

4.Procedura ”Pemë Dekorative për vitin 2022”,

Fondi limit:**3,490,000(tete milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë)** lekë pa TVSH, Burim financimi: Buxheti I Bashkisë.

Procedura e prokurimit do të jetë: **“E hapur e Thjeshtuar”** (me mjete elektronike) Mall.

“		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.9/1 datë 08.02.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1.D. A. 2.K. G. 3.M. H.	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: 1.E. D. 2.N. Q. 3.E. Gj.
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ‘‘Ehapur Thjeshtuar ‘‘		

5.Fondi Limit (pa Tvsh) 3,490,000 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE: A –K. me vlerë 2, 947, 000 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit: -543,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 07.03.2022	9.Burimi Financimit: Bashkia	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 1 OE 1 A-K. shpk
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar: *Kjo procedurë është tender i “E hapur Thjeshtuar”, me vlerë 3,490,000 lekë, pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.*

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij blerje;

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet dokument për inicimin e kryerjes mallra ,

Mbi përlogaritjen e fondit limit ;

Fondi limit është hartuar mbi bazë të testimi të tregut të cilat janë evidentuar në procesverbalin pa nr. prot., datë 03,02,2022, por të pa argumentuara ligjërisht.

-Nuk është hartimi I (Project-plani)si dhe plan vendosja e pemëve dekorative

-Nuk janë hartuar kosto të ndara sipas zërave (preventive) për hapjen e gropave për mbjelljen e pemëve, situacion punimesh të detajuar, situacioni me vendosje zëra punimesh si hapje gropash dhe mbjellje e cila është me ditë pune Pra harta ku janë mbjellë duhet te jetë pjesë e DST ku mbi këtë bazë do të përcaktohej dhe nr i punëtoreve për kryerjen e këtij shërbimi , pasi kontrata është përbërë furnizimi/mbjellje, për këto veprime mbanë përgjegjësi grupi i hartimit të fondit limit dhe përcaktimit të kriterëve.

z. K. G,

z.D. A,

z.M. H.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike:

Për llogaritjen e fondit limit , caktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit , ka vendosur specifikimet si më poshtë.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

3 ISO 14001:2015 mbi “Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit”

Argumentimi :

4 *Është standardi më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Rikonstruksioni I objektit konkret, përveçse kërkojnë një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen si ndotja e ajrit nga pluhurat e kantierit ndotja akustike dhe mjedisore nga makineritë etj., aq me tepër qe kemi te bëjmë me dy objekte brenda ne qytet. Për këtë arsye çdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e ambientit. Është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.*

Kjo kërkesë e mësipërme nuk është sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 44, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, *vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

2.3.2 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

a) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licence nga QKL Kodi II.4 për “Prodhim dhe Tregtim i farave dhe fidanëve”.

b. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licence nga QKL Kodi III.7.A për “Shërbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullota”.

c. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licence nga QKL Kodi II.5.A për “Tregtim me pakicë të produkteve të mbrojtjes së bimëve”.

d. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licence nga QKL Kodi II.8.B për “Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore 3D”.

këto kërkesa b, dhe kërkesa d, janë të pa argumentuara dhe nuk kane lidhje me objektin e kontratës përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të bëhet argumentimi i specifikimeve teknike dhe për çdo rast të dokumentojë dhe argumentojë përzgjedhjen e procedurës së prokurimit.

Sipas Preventivi.

Në pikën b, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licence nga QKL, Kodi III.7.A për “Shërbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullota”.

Shërbimi po kryhet në zona urbane dhe jo ne pyje kullota si dhe pika d, Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore. 3D”.

2.3.4 Numri i punonjësve: Numri mesatar i punonjësve të siguar duhet të jetë jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Nëntor 2021 – Dhjetor 2021 e vërtetuar kjo me listë pagesat për çdo muaj.

2.3.5 Këto kërkesa janë të pa justifikuara pasi numri i pemëve që do mbillen është 1400 për të cilat vetëm një punëtorë me 22 ditë në muaj realizon 28 copë, në ditë për tre muaj që është kontrata i bie që 28/3 9 copë në ditë. Pra kërkesa minimale e punëtorëve nuk do të ishte më shumë se 2 punëtorë këtu shtuar dhe drejtuesin teknik dhe një agronom pra ne total sipas preventivit tuaj 4 ose 5 punonjës por jo 10 që janë kërkuar nga subjekti . Në këtë rast kemi shkelej të parimit si dhe diskriminim të pjesëmarrësve.

-Nuk kemi analizë të çmimeve por vetëm një çmim në total dhe për këtë vendosja e numrit të punonjësve është e pa argumentuar .

Duke vendosur këto kushte jeni në kushte të diskriminimit të procedurës veprime që bien në kundërshtim me VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3.6. Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetë deklarimit):

Pra si përfundim nga sa më sipër konstatohet se disa prej kriterëve të vendosura nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërishit pasi nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, certifikatat e kërkuara, licencat etj, si dhe nuk janë vendosur në kushte situacione preventive dhe kosto për kryerjen e kësaj praktike. *Veprime për të cilat mban përgjegjësi Z. A. T, me detyrë Kryetar i Bashkisë Belsh ,z. Q. R. Kryetar komisioni , z. K. G. dhe z. N. T. anëtar.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, në të cilin citohet se;

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

nenin 3, parimet e përgjithshme në të cilat citohet se;

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5 ku përcaktohet se;

Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mos diskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 83, pika 2/b, në të cilin citohet se;

Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

..çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 2, “Dokumentimi i procesit”, ku citohet se

a) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;

Kreu X, neni 40, pika 3 e cila citon se;

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

.. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre..

Neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”

2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: e lartë.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin

e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara, gjithashtu të bëhet argumentimi i specifikimeve teknike.

Nr.	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion me vinc me kapacitet mbajtës Jo me pak se 3 ton.	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamion me kapacitet mbajtës 3.5-5.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1

Nga auditimi rezultoi se nga njësia e hartimit të dokumenteve dhe specifikimeve teknike nuk është kërkuar në dokumente standarde situacion /hartëzimi pra koordinatat se ku dhe si do të mbillen pemët dekorative , preventivi nuk është i detajuar por vetëm me vlera të përgjithshëm si më poshtë.

Nr.	Emendimi / përshkrimi i punës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	F.V. Rrap, perimetror 35-40cm, h=10	copë	60	14900	894 000
2	F.V. Sali, Vazo 40-50cm, h=1.5-2 m	copë	1200	1090	1 308 000
3	F.V. Rrap, perimetror 18-16cm, h=4-5 m	copë	30	11500	345 000
4	F.V. Margjola, perimetror 18-20cm, h=4-5 m	copë	40	11500	460 000
5	F.V. Geshlerja, perimetror 18-18 cm, h=3.5-4 m	copë	20	5000	100 000
6	F.V. Rrap, perimetror 16-18 cm, h=4-4.5m	copë	80	5000	400 000
Shuma					3 496 000
Tvsh					692 000
TOTALI					4 188 000

Siç shihet dhe nga tabela preventivi është thjeshte me njesi, sasi ,çmim .

Kontrata nëshkruar me nr. 116/2 datë 08.02.2022, në kushte është përcaktuar të realizoje furnizimin dhe vendosjen e pemëve për një periudhe kohore 3 muaj, nga data e lidhjes së kontratës.

Marrja në dorëzim me urdhrin nr.116/10 datë 10.03.2022, për pemë dekorative komisioni i përbërë nga

-Q. R. Kryetar

-K. G. anëtar

-N. T. anëtar

-Bashkëlidhur ndodhet fh nr.10 datë 06.04.2022 në vlerë 3,536,400 lekë me tvsh.

-Procesverbali i marrjes në dorëzim në datë 04.04.2022, i firmosur nga komisioni si dhe administratori i firmës **A -K** shpk,

-Rezultoni se marrja e mallit në dorëzim nuk ka asnjë dokumentacionin bashkëlidhur, që të vërtetoje kryerjen e këtij shërbimi si, skica /harta, situacionet, projekt plani, koordinatat ku është kryer mbjellja e pemëve dekorative, foto apo procesverbal të mbajtura nga grup pune për mbjelljen, nuk kemi dokumentacion që vërteton kryerjen e këtij shërbimi, veprime pa dokumentacion janë veprime fiktive nga bashki Belsh, veprime këto në kundërshtim me **Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kreu III.** Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre pika 35,pikab. Dokumente vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyre kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet dhe të tjera akte me natyre verifikues shpenzimi, si dhe me Ligjin nr Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin pika 26."Dokument financiar" është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi komisioni i përlogaritjes së fondit limit dhe caktimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim Komisioni i përbërë nga -D. A, K. G, M. H, si dhe komisioni i marrjes në dorëzim Q. R. Kryetar, K. G. anëtar, N. T. anëtar, si dhe punonjësit e lartë përmendura sipas praktikave të trajtuara në Raport Përfundimtarë Auditimi.

Për sa është trajtuar në Akt-Konstatim nr.4. datë 15,12.2023,

Titulli i gjetjes	Nuk janë argumentuar specifikimet teknike teknikisht dhe ligjërish
Situata:	Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit me objekt, <i>Pemë Dekorative për vitin 2022, janë vendosur kushte jo në përputhje me pikën 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 44, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.</i>
Kriteri:	Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
Ndikimi/Efekti	Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.
Shkaku	Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrit të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlogaritjen e vlerës së kontratës, të bëhet argumentimi i specifikimeve teknike sipas natyrës së prokurimit.

Pretendimi i subjektit:

Sipas observacionit të sjelle me nr.3548 datë 21.12.2023, nga Komisioni i llogaritjes së fondit limit si dhe komisioni i marrjes në dorëzim ,K. G. D. A. M. H. si dhe Q. R. , K. G, N. T. në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim.

Bashkëlidhur janë paraqitur dokumente që nuk janë vërtetues dhe argumentues pasi: paraqitur bashkëlidhur gjenden disa foto me ngjyra por nuk kanë të përcaktuar vend ndodhjen e tyre , nuk ka pv të paraqitura me nr datë pv të vendosjes së pemëve, pasi dhe në observacioni bini në kundërshtim me argumentimin tuaj ku shpreheni furnizimi dhe vendosja (mbjellja) janë parashikuar të behën për një afat 20 ditor dhe jo 3 muaj të llogaritur nga ju, kjo gjë është pasqyruar edhe tek shtojca 6 e DST.

Pastaj shpreheni se: *Gjatë specifikimeve për vendosjen e numrit te punëtorëve është marrë parasysh edhe koha optimale për mbjelljen e pemëve që është periudha **dhjetor- mars**, duke qenë në muajin e fundit të kësaj periudhe është menduar që subjekti të ketë burimet njerëzore për kryerjen e punimeve brenda kësaj periudhë që zënia e pemëve të jete sa me i larte. Atëherë 20 dite apo 3 muaj ?*

Përsa i përket dhe anës teknike, praktike të procedurës për hapje gropash dhe mbjellja e pemëve ju theksojmë se pasi bëhet hapja e gropave është e nevojshme qe ato te rrinë të hapura për disa dite. kjo për arsye qe sistemi i tokës të rivendoset ne gjendje optimale për mbjellje,. Qëllimi e lënies hapur të gropave si dhe dheu i nxjerr nga to, bëhet që sistemi i tokës të rivendoset në gjendje optimale për mbjelle dhe me anë të kontaktit me ajrin , rrezatimin

diellor, atmosferën, të largojnë lagështinë e tepërt dhe të jene në kushte optimale për mbjelljen e pemëve dhe rritjen e sigurisë për zënien e tyre.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

*Pas shqyrtimit të observacionit, Bashkëlidhur janë paraqitur dokumente që nuk janë vërtetues dhe argumentues pasi: paraqitur bashkëlidhur gjenden disa foto me ngjyra por nuk kanë të përcaktuar vend ndodhjen e tyre , data e mbjelljes, nuk ka pv të paraqitura me nr datë pv të vendosjes së pemëve, pasi dhe në observacioni bini në kundërshtim me argumentimin tuaj ku shpreheni furnizimi dhe vendosja (mbjellja) janë parashikuar të behën për një afat 20 ditor dhe jo 3 muaj të llogaritur nga ju, kjo gjë është pasqyruar edhe tek shtojca 6 e DST. **Pastaj shpreheni se:** Gjatë specifikimeve për vendosjen e numrit te punëtore është mare parasysh edhe koha optimale për mbjelljen e pemëve që është periudha **dhjetor- mars**, duke qenë në muajin e fundit të kësaj periudhe është menduar që subjekti të ketë burimet njerëzore për kryerjen e punimeve brenda kësaj periudhe që zënia e pemëve të jete sa me i larte. Atëherë 20 dite apo 3 muaj ?*

Përsa i përket dhe anës teknike, praktike te procedurës për hapje gropash dhe mbjellja e pemëve ju theksojmë se pasi behet hapja e gropave është e nevojshme qe ato te rrinë te hapura për disa dite. kjo për arsye qe sistemi i tokës te rivendoset ne gjendje optimale për mbjelle. Në observacion nuk janë paraqitur foto të mbjelljeve të pemëve, data dhe pv sipas ditëve dhe zonave të miratuara nga grupi i pmarrjes në dorzim, por është një pv i marrjes në dforzim vetëm me nr pemësh dhe sai ne total.

*Për këto mangësi jemi shprehur që nuk i plotësoni, si dhe nuk i keni të paraqitura që në hartimin e dokumenteve standarde DST , si dhe marrja në dorëzim është e pa dokumentuar. **Grupi i auditimit** pasi shqyrtoi dokumentacionin nuk merr në konsiderate observacionin, e paraqitur nga subjekti.*

Në zbatim të pikës nr.4.3 të programit të auditimit Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, blerjeve me vlera të vogla.

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
- Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”
- Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”
- etj....

Në zbatim të pikës nr. 4, të programit të auditimit

4,2, Urdhrat për ngritjen e komisioneve të prokurimeve me vlera të vogla për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

-Procedurat e prokurimeve me vlera të vogla me zgjedhje për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

-Dokumentacion plotësues/justifikues si fatura, transaksione bankare, fletë-hyrje në magazinë etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar dhe aksesit në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) konstatohet se:

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 janë realizuar 31 procedura prokurimi me vlera të vogla, me fond limit 18,098,493.00 lekë pa tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 14,157,355.88 lekë pa tvsh.(Të detajuara në aneksin nr. 1)Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:- Me Urdhrin nr. 06, nr. 94 prot, datë 12.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë Belsh, z. A. T., “Për krijimin e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël”, është krijuar komisioni për Prokurimin me vlerë të vogël si më poshtë:

1. J. T. Kryetar
2. M. E. Anëtar
3. A. L. Anëtar

Me përzgjedhje u audituan 7 procedura prokurimit me vlerë të vogël si më poshtë:

Nr.	Urdhër-Shpenzimi		Urdhër-Prokurimi		Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Procedura Prokurimit	Vlera e kontratës	OE i shpallur fitues
	nr.	datë	nr.	datë					
1			2827	12.10.2023	Marrje Autoveturë me qera	807,120	Bl.Vlere vogël	544,000	B. B.
2	233	22.06.2022	554/1	17.02.2022	Kancelari	583,330	Bl.Vlere vogël	448,900	E. L.
3	502	28.04.2022	2492/1	12.09.2022	Kancelari	104,550	Bl.Vlere vogël	100,000	I.S. O.
4	1618	12.12.2022	3003	26.10.2022	Marrje Makineri me qera	739,900	Bl.Vlere vogël	711,998.58	HB G. C.
5	359	15.09.2022	2362/1	26.08.2022	Blerje Bileta Avioni	500,000	Bl.Vlere vogël	33,950	E. T. G.
6	294	28.07.2022	1721/1	13.06.2022	Shërbim Transport Autobuz	1,000,000	Bl.Vlere vogël	840,000	Z. T.
7	405	11.04.2022	1361/1	10.05.2022	Blerje Vegla Pune	500,000	Bl.Vlere vogël	394,600	E. L.

Referuar të dhënave si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion për vitin 2022 janë audituar dosjet e prokurimit si më poshtë.

1. Me Urdhër Prokurimi nr. 2827 prot, datë 12.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë Belsh z. A. T. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. J. T. (kryetar i komisionit), znj. M. E. dhe znj. A. L. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Marrje me qera autoveturë në funksion të administratës së bashkisë Belsh”** me fond limit 807,120 lekë pa tvsh.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 14.10.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik “B. B.” me vlerë 544,000 lekë pa tvsh i cili është i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar.

• **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Grupi i auditimit e ka parë këtë procedurë si jo eficiente, efektive dhe pa ekonomicitet pasi mendon se janë shpenzime të shtuara për institucionin marrja e një makine me qira për nevojat e administratës së këtij Institucioni dhe mosvënia në funksion e automjeteve të cilat janë në pronësi të tij.

- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të subjektit shihet se kontrolli teknik i mjetit të marrë me qira është kryer në datë 12.08.2019 dhe me një afat 1 vjeçar. Pra mjeti nuk e ka dokumentacionin të vlefshëm dhe brenda afateve të lejuara, pasi kontrata është firmosur më datë 14.10. 2022.

Për sa më sipër, sikurse citohet në ftesën për ofertë, të gjitha detyrimet duhet të jenë të shlyera. Për sa i përket kontrollit teknik këto detyrime janë të papaguara.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë A. T., datë 06.10.2022 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim si më poshtë:

1. M. B.
2. E. F.
3. V. I.

Pretendimi i subjektit:

Mbi procedurën e prokurimit me objekt: “ Marrje me qira një autoveturë në funksion të administratës së Bashkisë Belsh ”

- Në rastin konkret referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik të mjetit, ka konstatuar se operatori ekonomik fitues e ka kontrollin teknik të vlefshëm deri më datë 21.01.2024 sipas certifikatës e cila ka afat 2 vjeçar nga 21.01.2022 deri me 21.01.2024, pra mjeti ka dokumentacion te rregullt për periudhën e kryerjes së shërbimit.

(bashkangjitur certifikata e kontrollit teknik.)

Oëndrimi i grupit të auditimit:

Ky observacion në konsideratë pas verifikimit të dokumentit justifikues të kontrollit teknik.

2. Me Urdhër Prokurimi nr. 554/1 prot, datë 17.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë Belsh z. A. T. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. J. T.(kryetar i komisionit), znj. M. E.dhe znj. A. L.(Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt “**Kancelari**” me fond limit 583,330 lekë pa t.v.sh.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 18.02.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik “E. L.” me vlerë 448,900 lekë pa tvsh i cili është i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 13/2022, datë 25.02.2022, në shumën 538,680 lekë me tvsh, likuidimi e së cilës është bërë në R. B.me Urdhër – Shpenzimi nr. 233 datë 22.06.2022.

• **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

3. Me Urdhër Prokurimi nr. 2492/1 prot, datë 12.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Belsh z. A. T. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. J. T.(kryetar i komisionit), znj. M. E.dhe znj. A. L.(Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt “**Kancelari**” me fond limit 104,550 lekë pa t.v.sh.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 14.09.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik “I. S. O. ” me vlerë 100,000 lekë pa tvsh i cili është i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 12445/2022, datë 19.09.2022, në shumën 120,000 lekë me tvsh, likuidimi e së cilës është bërë në P. C.B.me Urdhër – Shpenzimi nr. 502 datë 12.12.2022.

• **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

4. Me Urdhër Prokurimi nr. 3003 prot, datë 26.10.2022, të Kryetarit të Bashkisë Belsh z. A. T. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. J. T.(kryetar i komisionit), znj. M. E.dhe znj. A. L.(Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt “**Marrje me qera mjete për**

sistemimin, asfaltimin e rrugëve të fshatit Idrizaj dhe fshatit Hardhi” me fond limit 739,900 lekë pa t.v.sh.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 28.10.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik “HB G. C. Sh.P.K” me vlerë 711,998.58 lekë pa tvsh i cili është i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 3/2023, datë 04.01.2023, në shumën 854,398 lekë me tvsh, likuidimi e së cilës është bërë në C.B.me Urdhër – Shpenzimi nr. 337 datë 24.08.2023.

• **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

- Pas verifikimit të fushës së veprimtarisë sipas ekstraktit të QKB-së grupi i auditimit konstatoi që subjekti “HB G. C. Sh.P.K” nuk ka objekt të aktivitetit të tij dhënien me qira të mjeteve për sistemimin, asfaltimin e rrugëve, veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni nr. 25, pika 2, gërma (a) “operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv”

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion grupi i auditimit ka konstatuar se nuk është bërë argumentimi i përlllogaritjes së fondit limit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni nr. 76, Pika 2, “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.”

Pretendimi i subjektit:

Për vlerësimin e ofertave në procedurës së tenderit: “Marrje me qira mjete për Sistemimin, Asfaltimin e Rrugëve te Fshatit Idrizaj dh Fshatit Hardhi”

Komisioni I blerjeve te vogla argumenton:

Në mbështetje të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, të nenit 56 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Ligji Nr.10296 datë 8.7.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", si dhe Udhëzim Nr. 05 datë 25.06.2021, “ Mbi përdorimin e procedurës se prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, sqarojmë:

-Nisur nga natyra e shërbimit që është kryer nga këto mjete (asfaltoshtruese dhe rrulngjeshës) të cilat janë makineri të rënda për punime ndërtimi rruge, referuar ekstraktit të OE i cili ka të përcaktuar në objektit veprimtari, makineri e mjete të të gjitha llojeve në fushën e ndërtimit si dhe transport i makinerive të rënda... etje, Komisioni e ka kualifikuar duke e quajtur objekt të ngjashëm me objektin e prokuruar si dhe operatori ekonomik fitues ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar kërkesave të vendosura në Ftesën për ofertë dhe ka realizuar me sukses këtë kontratë.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Ky observacion nuk merret në konsideratë pasi pas verifikimit të fushës së veprimtarisë sipas ekstraktit të QKB-së grupi i auditimit ka konstatuar që subjekti “HB G. C. Sh.P.K” nuk ka objekt të aktivitetit të tij dhënien me qira të mjeteve për sistemimin, asfaltimin e rrugëve, dhe këto janë veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku shprehet qartë në nenin nr. 25, pika 2, gërma (a) se “operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv”. Në këtë procedurë prokurimi, sipas ekstraktit të QKB-së, OF “HB. G. C. Sh.P.K” nuk e ka dhënien me qira të mjeteve për sistemimin, asfaltimin e rrugëve, objekt të veprimtarisë së tij.

Pretendimi i subjektit:

Për sa i përket pikës së dytë, Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me Urdhër nr. 2941 Prot datë 20.10.2023 u bazua në përlllogaritjen e fondit për këtë procedurë prokurimi në Manualin e çmimeve te vitit 2015 sipas nr analizës 3.229/1 objekt prokurimi duke marrë shkas në bazë të specifikimeve të përcaktuara si dhe në nevojat e institucionit sipas Akt verifikimit me datë 20.10.2022. Me observacionin nr 971/4 datë 15.01,2024, nga komisioni blerjeve të vogla janë përcjellë shpjegimet, (Bashkangjitur do të gjeni urdhrin e ngritur, preventivin dhe akt verifikimin.)

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Ky observacion, pas verifikimit të dokumentit justifikues merret pjesërisht në konsideratë pasi grupi i auditimit mendon se përlllogaritja e fondit limit duhet të kryhet në mënyrë më të detajuar dhe më të specifikuar.

Titulli i gjetjes	Parregullsi në Procedurën e Prokurimit me Blerje të Vogël
Situata:	- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “ Marrje me qera mjete për sistemimin, asfaltimin e rrugëve të fshatit Idrizaj dhe fshatit Hardhi ” me fond limit 739,900 lekë pa t.v.sh u konstatua se OE fitues, “HB. G. C. Sh.P.K” nuk ka objekt të aktivitetit të tij dhënien me qira të mjeteve për sistemimin, asfaltimin e rrugëve.
Kriteri:	- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
Ndikimi/Efekti	Risk për mosfunksionimin dhe marrjen e shërbimit.
Shkaku	Moszbatim i përcaktimeve ligjore
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla në Bashkinë Belsh të ndjek procedurat e prokurimit në zbatim të përcaktimeve ligjore.

5. Me Urdhër Prokurimi nr. 2362/1 prot, datë 26.08.2022, të Kryetarit të Bashkisë Belsh z. A. T. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. J. T.(kryetar i komisionit), znj. M. E.dhe znj. A. L.(Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt “**Blerje Bileta Avioni për udhëtim jashtë shteti**” me fond limit 50,000 lekë pa t.v.sh.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 26.08.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik “E. T. G.” me vlerë 33,950 lekë pa tvsh i cili është i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar.

• **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të

Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

6. Me Urdhër Prokurimi nr. 1721/1 prot, datë 13.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Belsh z. A. T. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. J. T.(kryetar i komisionit), znj. M. E.dhe znj. A. L.(Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Shërbim Transporti me autobus për aktivitet artistik-kulturor në Poloni”** me fond limit 1,000,000 lekë pa t.v.sh.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 20.06.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik “Z. T.” me vlerë 840,000 lekë pa tvsh i cili është i renditur i katërti në klasifikimin përfundimtar.

Operatori “B. Sh.p.k.” u tërhoq me kërkesën e tij.

Operatori “L. Xh.” nuk u paraqit brenda afateve kohore të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.

Operatori “T. K.” u tërhoq me kërkesën e tij.

• **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

- Nuk ka dokumentacion justifikues për pjesëmarrjen e Ansambli “Folklori ndër Breza” në festivalin e zhvilluar në qytetin Elk në Poloni, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika nr. 36, “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim te dyfishte si dhe atë te mashtrimeve.”.

Titulli i gjetjes	Mos dokumentim argumentues ligjor.
Situata:	- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim Transporti me autobus për aktivitet artistik-kulturor në Poloni” me fond limit 1,000,000 lekë pa t.v.sh për ansamblin “Folklori ndër breza” u konstatua mungesa e dokumentacionit justifikues për marrjen apo kryerjen e këtij shërbimi.
Kriteri:	- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,
Ndikimi/Efekti	Risk për mosfunksionimin dhe marrjen e shërbimit.
Shkaku	Moszbatim i përcaktimeve ligjore
Rëndësia	E Mesme
Rekomandim	Drejtoria e financave së bashku me Drejtorinë e Shërbimeve në Bashkinë Belsh të marrë masa që për çdo Procedurë Prokurimi të bashkëngjisë dokumentacionin justifikues për kryerjen e shërbimit.

7. Me Urdhër Prokurimi nr. 1361/1 prot, datë 10.05.2022, të Kryetarit të Bashkisë Belsh z. A. T. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. J. T.(kryetar i komisionit), znj. M. E.dhe znj. A. L.(Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje vegla pune dhe pajisje ndihmëse për punonjësit e shërbimit”** me fond limit 500,000 lekë pa t.v.sh.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 11.05.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik “E. L.” me vlerë 394,600 lekë pa tvsh i cili është i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 69/2022, datë 07.06.2022, në shumën 473,520 lekë me tvsh, likuidimi e së cilës është bërë në Raiffeisen Bank. me Urdhër – Shpenzimi nr. 465 datë 24.11.2022.

• **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

Titulli i gjetjes	Parregullsi në zhvillimin e procedurave të prokurimeve me vlera të vogla.
Situata:	<i>Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022</i> janë realizuar 31 procedura prokurimi me vlera të vogla, me fond limit 18,098,493.00 lekë pa tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 14,157,355.88 lekë pa tvsh. Me përzgjedhje janë audituar në total 7 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën 4,234,900 lekë pa tvsh dhe realizim kontrate në vlerën 3,073,449 lekë pa tvsh ose në masën 23% të totalit të vlerës së fondit limit. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë: Referuar të dhënave të sipërpërmendura mbi auditimin e procedurave të prokurimeve me vlera të vogla janë, në 7 procedurat e prokurimit janë konstatuar parregullsitë si më poshtë: -Në 7 raste dosjet e procedurave të prokurimit me vlera të vogla nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara. -Në 4 raste kanë rezultuar vonesa nga Bashkia Belsh në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorë ekonomikë duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.
Kriteri:	- Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7 - “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.
Ndikimi/Efekti	Risk mbi mosfunksionimin dhe marrjen e duhur të shërbimit
Shkaku	Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Drejtoria e Financës në Bashkinë Belsh të marrë masa që për çdo rast, likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale. -Të gjitha aktet e hartuara në lidhje me procedurat e prokurimit, të kalojnë përmes arkivës së institucionit, me qëllim evidentimin e rrjedhshmërisë së veprimeve gjithashtu pas përfundimit të çdo procedure të kryhet arkivimi i tyre.

Në zbatim të pikës 5. të programit të auditimit, me objekt “Auditim mbi organizimin dhe funksionimin dhe zhvillimin e territorit”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se;

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Belsh dhe Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor janë miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Auditimi konsiston në këto fusha;

- 1.Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura;
- 2.Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve;

3. Dhënia e Certifikatës së Përdorimit.

-Referuar të dhënave të sistemit elektronik e-Lejet për Bashkinë Belsh rezulton se për afatin e periudhës së auditimit 01.01.2022-31.12.2022 ka pasur 112 aplikime në sistem për leje të ndryshme: si leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, certifikata përdorimi etj, përkatësisht 25 aplikime për leje zhvillimi, 3 leje ndërtimi (leje ndërtimi për objekte të reja me sipërfaqe të reja me sipërfaqe më të madhe se 250 m2), 21 certifikata përdorimi, 24 deklarata paraprake për kryerje punimesh etj, të evidentuara në tabelën përmbledhëse.

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	25	15	10
Leje ndërtimi mbi 250 m2	3	3	0
Leje ndërtimi deri në 250 m2	18	14	4
Deklarata paraprake për kryerje punimesh	20	20	0
Rikonstruksion	1	1	0
Certifikatë përdorimi	21	13	8
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m2	0	0	0
Shtesë në objekt ekzistues më e madhe se 250 m2	0	0	0
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	0	0	0
Ndryshim funksioni	0	0	0
Njoftim fillim punimesh	24	16	8
Shtyrje afati leje përdorimi	0	0	0

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Belsh, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 janë miratuar 3 leje, 13 certifikata përdorimi, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m2 si dhe certifikatat e përdorimit.

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Nr. Data e lëshimit të lejes	Preventivi
1.	Objekt banimi 2 kate dhe 1 kat nëntokë	H. Q.-O. Q.	Nr.1544/4 prot., datë 23.06.2022	8,667,479 lekë
2.	Banesë 2 kate me cati të pashfryshhtëzueshme +podrum	S. B.	Nr.1522/5 prot., datë 20.06.2022	12,096,753 lekë
3.	Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore	A. J.	Nr.381/5 prot., datë 25.03.2022	13,798, 870 lekë
4.	Godinë shërbimi 1 kat e fabrika përpunimi të ullirit dhe kantinë për prodhimin e rakisë	A. H.	Nr.3250/4 prot., datë 21.11.2022	Certifikatë përdorimi
5.	Ndërtim magazinë 1 kat	E. C.	Nr. 1065/5 prot., datë 28.04.2022	Certifikatë përdorimi
6.	Prishja e banesës ekzistuese +ndërtim i ri objekt 2 kat	F. Xh.	Nr. 2374/4 prot., datë 30.08.2022	Certifikatë përdorimi

Përpunoi: Grupi i auditimit

➤ Nga auditimi mbi dhënien e lejes së ndërtimit (H. Q.- O. Q.) për objektin “objekt banimi 2 kate dhe 1 kat nëntokë” rezultoi, si vijon:

-Aplikimi për leje "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2" nr. AN290520220003, datë 29.05.2022.

Dokumente në sistem e e-Leje, rezultojnë:

- Formati i Aplikimit, i nënshkruar elektronikisht;
- Certifikatë e Pronësisë, kartela e pasurisë;

- Deklaratat e përgjegjësive profesionale;
- Licencat;
- Prokura;
- Plan Vendosija e Strukturës;
- Plan Rilevimi;
- Projekti dhe Relacioni Arkitektonik;
- Projekti dhe Relacioni Konstruktiv;
- Projekti dhe Relacioni i MKZ-së;
- Projekti dhe Relacioni Elektrik;
- Projekti dhe Relacioni Hidroteknik;
- Projekti dhe relacion ngrohje-ftohje;
- Certifikata Paraprake e Eficencës Energjitike;
- Preventiv Punimesh;
- Leja e Zhvillimit;
- Grafik Punimesh;
- Kopje e policës së sigurimit;
- Ekstrakti i QKB-së;
- Shkresa e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit (bashkia Belsh) me nr. 1544/1 prot., datë 01.06.2022 (Në shkresën e bashkisë Belsh përmendet se aplikimi është i plotë).
- Shkresë nga Bashkia Belsh për përlogaritje “Taksën e Infrastrukturës“ me vlerë 86,674,79 lekë.

Miratimi i Lejes së Ndërtimit:

- Agjencia e Zhvillimit të Territorit;
- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST);
- Agjencia për Eficencën e Energjisë.

Miratime nga institucione të ndryshme në heshtje.

- Drejtoria Vendore ASHK Elbasan;
- OSHEE Elbasan;
- PMNZSH Belsh;
- Ujësjetës Kanalizime Belsh.

Për objektin “objekt banimi 2 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë” nga Kryetari i Bashkisë Belsh është lëshuar Leje Ndërtimi me nr. 1544/4 prot., datë 23.06.2022, bazuar në raportin teknik me zhvillues H. Q. – O. Q, me afat kohor zbatimi 1 vit.

Nga auditimi rezultoi se;

- Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit, Bashkia Belsh nuk i është kërkuar mendim të gjitha institucioneve;
- Mungon studimi sizmiko-geologjik i projektit;
- Përditësimi i kartelës së pasurisë nuk është i tre-mujorit të fundit.

- Nga auditimi mbi dhënien e lejes së ndërtimit (S. B.) për objektin “banesë 2 kate me çati të pashfrytëzueshme +podrum” rezultoi, si vijon:

-Aplikimi për leje "Leje ndërtimi" nr. Nr. AN240520220079, datë 24.05.2022.

Dokumente në sistem e e-leje, rezultojnë:

- Formati i Aplikimit, i nënshkruar elektronikisht;
- Certifikata e Pronësisë, kartela e pasurisë;
- Deklaratat e përgjegjësive profesionale;
- Licencat;
- Prokura;
- Plan Vendosija e Strukturës;
- Plan Rilevimi;
- Projekti dhe Relacioni Arkitektonik;

- Projekti dhe Relacioni Konstruktiv;
- Projekti dhe Relacioni i MKZ-së;
- Projekti dhe Relacioni Elektrik;
- Projekti dhe Relacioni Hidroteknik;
- Certifikata Paraprake e Eficencës Energjitike;
- Preventiv Punimesh;
- Leja e Zhvillimit;
- Grafik Punimesh;
- Kopje e policës së sigurimit;
- Ekstrakti i QKB-së;
- Shkresa e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit (bashkia Belsh) me nr. 1522/2 prot., datë 30.05.2022 (Në shkresën e bashkisë Belsh përmendet se aplikimi është i plotë.)
- Shkresë nga Bashkia Belsh për përlllogaritje “Taksën e Infrastrukturës“ me vlerë 120,967,53 lekë.

Miratimi i Lejes së Ndërtimit:

- Agjencia e Zhvillimit të Territorit;
- Agjencia për Eficencën e Energjisë;
- Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- OSHEE Elbasan.

Miratime nga institucione të ndryshme në heshtje.

- Drejtoria Vendore ASHK Elbasan;
- PMNZSH Belsh;
- Ujësjetës Kanalizime Belsh.

Për objektin “ banesë 2 kate me çati të pashfrytëzueshme +podrum” nga Kryetari i Bashkisë Belsh është lëshuar Leje Ndërtimi me nr. 1522/5 prot., datë 20.06.2022, bazuar në raportin teknik me zhvillues **S. B.**

Nga auditimi rezultoi se;

- Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit, Bashkia Belsh nuk i është kërkuar mendim të gjitha institucioneve;
- Mungon raporti sizmiko-gjeologjik i projektit.

- Nga auditimi mbi dhënien e Lejes së ndërtimit (**A. J.**) për objektin “Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore ” rezultoi, si vijon:

Aplikimi për leje "leje ndërtimi" nr. AN010220220033, datë 01.02.2022.

Dokumente në sistem e e-leje, rezultojnë:

- Formati i Aplikimit, i nënshkruar elektronikisht;
- Prokure e posaçme;
- Certifikatë e Pronësisë, kartela e pasurisë;
- Leja e Zhvillimit;
- Deklaratat e përgjegjësive profesionale;
- Licencat;
- Plan Vendosi e Strukturës;
- Plan Rilevimi;
- Projekti & Relacioni Arkitektonik;
- Projekti & Relacioni Konstruktiv;
- Projekti & Relacioni i MKZ;
- Projekti dhe Relacioni Elektrik;
- Projekti dhe Relacioni Hidraulik;
- Raporti i Auditimit të Energjisë;
- Certifikatë e Performancës së Energjisë;
- Certifikatë e Audituesit Energjitik;
- Preventiv Punimesh;

-Grafik Punimesh;
-Kopje e policës së sigurimit;
-Ekstrakti i QKB-së;
-Shkresa e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit (bashkia Belsh) me nr. 381/2 prot., datë 15.02.2022 (Në shkresën e bashkisë Belsh përmendet se aplikimi është i plotë.)

-Shkresë nga Bashkia Belsh për përlogaritje “Taksën e Infrastrukturës“ me vlerë 413,966 lekë.

Për objektin “Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore” nga Kryetari i Bashkisë Belsh është lëshuar Leje Ndërtimi me nr. 381/5 prot., datë 25.03.2022 bazuar në raportin teknik me zhvillues A. J.

Miratimi i Lejes së Ndërtimit:

-Ujësjetllës Kanalizime Belsh;
-Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
-Operatori i Sistemit të Transmetimit;
-Agjencia e Zhvillimit të Territorit;
-PMNZSH Belsh.

Miratime nga institucione të ndryshme në heshtje.

-Drejtoria Vendore ASHK Elbasan;
-OSHEE Elbasan.

-Agjencia Kombëtare e Mjedisit *projekti duhet të nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis(VNM) .

-Vendim i VNM paraprake.

Nga auditimi rezultoi se;

-Kartela e pasurisë nuk është e tre mujorit të fundit;
-Mungon raporti sizmiko-geologjik i projektit;
-Nuk i është kërkuar mendim Këshillit Kombëtar të Territorit;
-Nga ana e Bashkisë Belsh është tejkualuar afati 5 ditor për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar, për çështjen e përmbushjes së formës dhe konformitetit të projektit me dokumentet e planifikimit.

- Nga auditimi mbi dhënien e certifikatës së përdorimit (A. H.) për objektin “godinë shërbimi 1 kat, fabrika e përpunimit të ullirit dhe kantinë për prodhimin e rakisë” rezultoi, si vijon:

-Aplikimi për leje "Certifikatë përdorimi" nr. AN141120220041, datë 14.11.2022.

Dokumente në sistem e e-leje, rezultojnë:

-Formati i Aplikimit, i nënshkruar elektronikisht;
-Leje Ndërtimi;
-Kontratë me firmën e ndërtimit;
-Kontratë me mbikëqyrësin e punimeve;
-Licencat;
-Plan vendosja;
-Situacioni Përfundimtar;
-Akt – Kontrolllet;
-Akt – Kolaudimi;
-Deklarata teknike e sipërmarrësit;
-Fotografi të objektit;
-Njoftim Fillim Punimesh;
-Njoftim Përfundimesh punimesh;
-Procesverbal për punimet e ndërtimit;
-Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrësit;
-Vërtetim i OSHEE;
-Vërtetim i MKZ;

-Vërtetim i Ujësjetllës –Kanalizime Belsh, sh.a;

-Siguracioni i Objektit.

Për objektin “Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore” nga Kryetari i Bashkisë Belsh është lëshuar Certifikatë përdorimi me nr. 3250/4 prot , datë 21.11.2022 bazuar në raportin teknik me zhvillues **A. H.**

Nga auditimi rezultoi se;

-Mungon dokumenti për menaxhimin e mbetjeve urbane.

- Nga auditimi mbi dhënien e certifikatës së përdorimit (**E. C.**) për objektin “ndërtim magazinë 1 kat + ndërtim ekspozite 2 kat” rezultoi, si vijon:

-Aplikimi për leje "Certifikatë përdorimi" nr. AN1104202200081, datë 11.04.2022.

Dokumente në sistem e e-leje, rezultojnë:

-Formati i Aplikimit, i nënshkruar elektronikisht;

-Leje Ndërtimi;

-Kontratë me firmën e ndërtimit;

-Kontratë me mbikëqyrësin e punimeve;

-Licencat;

-Plan vendosje e objektit;

-Akt –Kontrollet;

-Akt –Kolaudimi;

-Deklarata teknike e sipërmarrësit;

-Fotografi të objektit;

-Njoftim Fillim Punimesh;

-Njoftim Përfundim punimesh;

-Procesverbal për punimet e ndërtimit;

-Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrësit;

-Vërtetim i OSHEE;

-Vërtetim i MKZ;

-Vërtetim i Ujësjetllës – Kanalizime Belsh, sh.a;

-Siguracioni i Objektit.

Për objektin “Ndërtim magazinë 1 kat ” nga Kryetari i Bashkisë Belsh është lëshuar Certifikatë përdorimi me nr. 1065/5 prot., datë 28.04.2022, bazuar në raportin teknik me zhvillues **E. C.** Nga auditimi rezultoi se;

-Mungon dokumenti për menaxhimin e mbetjeve urbane.

- Nga auditimi mbi dhënien e certifikatës së përdorimit (**F. Xh.**) për objektin “prishja e banesës ekzistuese 1 kat +ndërtim i objektit të ri 2 kat” rezultoi, si vijon:

-Aplikimi për leje "Certifikatë përdorimi" nr. AN260820220026, datë 26.08.2022.

Dokumente në sistem e e-leje, rezultojnë:

-Formati i Aplikimit, i nënshkruar elektronikisht;

-Leje Ndërtimi;

-Kontratë me firmën e ndërtimit;

-Kontratë me mbikëqyrësin e punimeve;

-Licencat;

-Plan vendosja e objektit;

-Situacioni Përfundimtar;

-Akt–Kolaudimi;

-Deklarata teknike e sipërmarrësit;

-Fotografi të objektit;

-Njoftim Fillim Punimesh;

-Njoftim Përfundimesh punimesh;

-Procesverbal për punimet e ndërtimit;

-Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrësit;

-Vërtetim i OSHEE;

- Vërtetim i MKZ;
- Vërtetim i Ujësjiellës–Kanalizime Belsh, sh.a;
- Siguracioni i Objektivit.

Për objektin “prishja e banesës ekzistuese +ndërtim i objektivit 2 kat” nga Kryetari i Bashkisë Belsh është lëshuar Certifikatë përdorimi me nr. nr. 2374/4 prot., datë 30.08.2022 bazuar në raportin teknik me zhvillues **F. Xh.**

Nga auditimi rezultoi se ;

-Mungon dokumenti për menaxhimin e mbetjeve urbane.

Trajtimi i observacioneve

Me shkresën me nr.971/2 prot., datë 26.12.2023, bashkia Belsh ka dërguar observacionet si vijon: Me observacionin nr 971/4 datë 15,01,2024, nga punonjësit e urbanistikës ku kanë dhënë shpjegime për rastet kur nuk është marre mendim nga institucionet pasi jo në cdo rastë tipologjia e ndërtimit i përket fushës për marrje mendimi

-Pretendimet e subjektivit:

Lidhur me pikën e programit të auditimit për organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e territorit Bashkia Belsh, z.A. H, z.V. I, z.R. D, z.P. T, z.S. K, kanë paraqitur dokumente shoqërues justifikues për subjektivitet: H. Q – O. Q, S. B., A. J., E. C, F. Xh.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të bëra më sipër, sqarojmë se grupi i auditimit i merr pjesërisht në konsideratë dokumentacionin e paraqitur dhe u reflektuan në Raport Përfundimtarë.

Titulli i gjetjes	Nuk është kërkuar mendimi i të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në tre raste nuk është kërkuar mendimi i të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, më konkretisht: - Për objektin “Objekt banimi 2 kate dhe 1 kat nëntokë”; (nuk është kërkuar mendimi i AKM); - Për objektin “Banesë 2 kate me çati të pa shfrytëzueshme + podrum”; (nuk është kërkuar mendimi i AKM); - Për objektin “Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore (nuk është kërkuar mendim Këshillit Kombëtar të Territorit).
Kriteri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: - VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 21
Ndikimi/Efekti	Miratimi i lejeve të ndërtimit në mungesë të mendimit të të autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, duke mos respektuar mendimin e tyre, krijon kushte të favorshme për një zhvillim të pakontrolluar, duke cënuar zhvillimin e kontrolluar urban, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.
Shkaku	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Belsh.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Nga DPKZHT Belsh të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Titulli i gjetjes	Projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues.
--------------------------	---

Situata:	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 3 rastet e audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, më konkretisht: -Për objektin “Objekt banimi 2 kate dhe 1 kat nëntokë”; -Për objektin “Banesë 2 kate me çati të pashfrytëzueshme +podrum”; -Për objektin “Objektin 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore”; mungon studimi sizmik dhe gjeologjik.
Kriteri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: - VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, pika 1
Ndikimi/Efekti	Mangësitë në projektin ndërtimor, ndikojnë në cilësinë dhe garantimin e ndërtimeve sipas standardeve, kushteve higjieno-sanitare dhe të sigurisë.
Shkaku	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Belsh
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Nga DPKZHT Belsh të merren masa të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi me mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij.

Titulli i gjetjes	Përditësimi i dokumentacionit kadastral.
Situata:	Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se dokumentacioni i pronësisë i ngarkuar në sistemin e-leje për aplikimin e lejes së ndërtimit nuk ishte i plotë. Kartela e pasurisë nuk ishte e 3-mujorit të fundit, më konkretisht: Për objektin " Objekt banimi 2 kate dhe 1 kat nëntokë ", kartela e pasurisë nuk është e 3-mujorit të fundit; Për objektin "Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore", kartela e pasurisë nuk është e 3-mujorit të fundit.
Kriteri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: VKM nr. 408, Neni 15, pika 1.b.
Ndikimi/Efekti	Mospasqyrimi i plotë i dokumentacionit të pronësisë në aplikimin për leje ndërtimi, ndikon në mosrespektimin e kriterëve, kondicioneve urbane të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
Shkaku	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Belsh
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Nga DPKZHT Belsh të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Titulli i gjetjes	Dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me certifikate përdorimi nuk është i plotë.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në 2 raste, dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me certifikatë përdorimi nuk është i plotë, më konkretisht: -Për objektin “Certifikatë përdorimi për godinë shërbimi 1 kat , fabrika përpunimi të ullirit dhe kantinë për prodhimin e rakisë”, mungon akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane. -Për objektin “Certifikatë përdorimi për ndërtim magazinë 1 kat + ndërtim ekspozite 2 kat”, mungon akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane. -Për objektin “prishja e banesës ekzistuese 1 kat +ndërtim i objektit të ri 2 kat” mungon akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane.
KriteFri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

	- VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/2.
Ndikimi/Efekti	Mangësitë në dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me certifikatë përdorimi, ndikojnë në mosdhënien e sigurisë së plotë se objekti është ndërtuar sipas kriterëve ligjore, duke cënuar standardet e zhvillimit të kontrolluar, ato të mjedisit, sigurisë dhe higjeno-sanitare.
Shkaku	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Belsh
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Bashkia Belsh dhe DPKZHT të marrë masa të mos miratojnë asnjë certifikatë përdorimi deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

- 1.A. T., me detyrë kryetar i Bashkisë Belsh;
- 2.A. H, me detyrë drejtor i Planifikimit , Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit;
- 3.R. D, me detyrë specialist i lejeve dhe projekteve;
- 4.P. T, me detyrë specialist i lejeve dhe projekteve;
- 5.S K, me detyrë specialist i lejeve dhe projekteve.

Në zbatim të pikës 6, të Programit të Auditimit, u auditua organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Belsh (IMTV).

6.1 Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

6.2 Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative, dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMT.

6.3 Auditim mbi procedurat e ndjekura nga IMT lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit të Bashkisë sipas dispozitave ligjore të nenit 81-Inspektimi, pika 3, të Në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 3, kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga:

- a) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore përkatëse;
- b) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.⁴

Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Belsh (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 68, datë 24.12.2021, i ndryshuar “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Belsh”, e cila përbëhet nga 2(dy) punonjës me detyrë inspektor dhe 1(një) përgjegjës sektori.

Nga auditimi rezulton se, nga ana e Bashkisë Belsh për periudhën objekt auditimi janë bërë përkatësisht 2 (dy) shpallje për 2 (dy) pozicione inspektorë, përkatësisht shkresa me nr. 2076 prot., datë 25.07.2022 dhe shkresa me nr.888 prot., datë 24.03.2022.

Në 2 kërkesat e bashkisë Belsh drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit citohet se “*bashkia Belsh ka vendosur të shpallë procedurën e konkurrimit për grupin e pozicioneve të shpallura për konkurrim “Iloji i diplomës Shkenca inxhinierike” në Shkencat e Natyrës dhe diploma e nivelit Bachelor në "Shkenca e Natyrës”.*

Për të dyja shpalljet e publikuara nuk ka patur kandidatë fitues. Nga auditimi u konstatua se bashkia Belsh ka kufizuar kriterin e diplomës vetëm në shkenca inxhinierike , duke

⁴ Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4.

përfundim nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Belsh nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

"Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit."

Si përfundim, nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Belsh nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

Titulli i gjetjes	Mos funksionim i IMTV-së në Bashkinë Belsh
Situata:	Referuar Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 68, datë 24.12.2021 i ndryshuar "Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Belsh", struktura e IMTV Belsh përbëhet nga 2(dy) punonjës me detyrë inspektor dhe 1(një) përgjegjës sektori. Nga ana e Bashkisë Belsh për periudhën objekt auditimi janë bërë përkatësisht 2 (dy) shpallje për 2 (dy) pozicione inspektorë, përkatësisht shkresa me nr. 2076 prot., datë 25.07.2022 dhe shkresa me nr.888 prot., datë 24.03.2022. Në 2 kërkesat e bashkisë Belsh drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit citohet se " <i>bashkia Belsh ka vendosur të shpallë procedurën e konkurrimit për grupin e pozicioneve të shpallura për konkurrim " lloji i diplomës Shkenca inxhinierike" në Shkencat e Natyrës dhe diploma e nivelit Bachelor në "Shkenca e Natyrës"</i> . Për të dyja shpalljet e publikuara nuk ka patur kandidatë fitues. Nga auditimi u konstatua se bashkia Belsh ka kufizuar kriterin e diplomës vetëm në shkenca inxhinierike , duke përjashtuar arsimin e lartë në fushat e drejtësisë, arkitekturës, urbanistikës etj.
Kriteri:	Ligji nr.9780, datë 06.07.2007 " Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme ", i ndryshuar neni 11
Ndikimi/Efekti	Nuk kryhet kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
Shkaku	Bashkia Belsh nuk ka zbatuar detyrimet ligjore në kërkesat për shpallje për vende të lira pune, duke kufizuar kriterin e diplomës.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	Kryetari i Bashkisë Belsh të marrë të gjitha masat për të plotësuar strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit konform legjislacionit në fuqi, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1.A. T., me detyrë kryetar i Bashkisë Belsh
- 2.A. S, me detyrë drejtor i Burimeve Njerëzore.

7. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Gjatë procesit të auditimit për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31,12,2022 në subjektin Bashkia Belsh, nuk u konstatuan problematika të tjera për t'i bërë pjesë të këtij raporti të auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga 71 vende pune me status të nëpunësit civil, një devijim në strukturën organizative të Bashkisë Belsh duke bërë një mbivendosje me punonjës në pozicione të ndryshme të strukturës, por duke mos plotësuar vendet vakante sipas detyrave funksionale dhe sipas strukturës organizative të kësaj bashkie, ku:

-54 punonjës kanë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në vendin e punës dhe kategorisë që i korrespondon.

-17 vendet që janë vakante në pozicionin e nëpunësit civil, janë plotësuar me punonjës të cilët nuk i përkasin kategorisë së vendeve vakante por thjeshtë janë punësuar për të plotësuar numrin e punonjësve, i cili është miratuar me Vendimin nr. 68 të Këshillit Bashkiak, datë 24.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”.

-Bashkia Belsh nuk ka hartuar programe trajnimi për punonjësit, duke mos garantuar ngritjen dhe zhvillimin profesional të tyre dhe kryerjen e detyrave funksionale me profesionalizimin e duhur. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neni nr. 42, pika nr.3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për rekrutimin e punonjësve dhe plotësimin e vendeve vakante sipas detyrave funksionale, nëpërmjet shpalljeve në Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

Deri më 31.03.2024

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Kryetari i Bashkisë Belsh dhe zëvendës kryetarët nuk janë pjesë e grupit të menaxhimit strategjik, duke bërë që personat kryesor të institucionit të mos jenë të përfshirë në veprimtarinë e punës së këtij grupi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Neni nr. 27, pika nr.2.

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që kryetar i e grupit të menaxhimit strategjik, të jetë vetë Ai, si dhe të përfshihen në këtë grup edhe zëvendës kryetarët e bashkisë.

Deri më 28.02.2024

3 .Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Belsh, nuk ka ngritur strukturë për kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe nuk ka lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi.”. Në këto kushte, titullari i njësisë publike nuk ka një strukturë e cila duhet ti jap mbështetje dhe këshilla për realizimin e objektivave, të kryej auditimin e veprimtarisë së institucionit, duke dhënë rekomandim për përmirësimin punës dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike, etj.

Veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 dhe VKM nr. 83 datë 03/02/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3.*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 116-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, nëpërmjet ngritjes së kësaj strukture brenda institucionit, ose nëpërmjet lidhjes së kontratës me Njësi të Auditit të Brendshëm me institucion tjetër, sipas rregullave të kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analizës së llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari nuk paraqet vlerën e saktë, pasi në të nuk është pasqyruar vlera prej 8,391,446 lekë, për 119 subjekte debitor të nxjerrë nga KLSH-ja (vetëm për taksat dhe tarifat

që mbliidhen nga Drejtoria e Taksave) për vitin 2020 dhe 2021. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2,2,faqe 53-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Belsh në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore të marrin masa për pasqyrimin në kontabilitet llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” vlerën e debitorëve të paparaqitur prej 8,391,446 lekë për 119 subjekte dalë nga auditimet në vite të KLSH-së, në kundërshtim me pikën 2 e nenit 89, e ligjit nr.9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në bashkinë Belsh në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në datën 15.07.2016 Bashkia Belsh, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Belsh SHA me NUIS “L63215202R” e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij*”. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 45,434,140 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **45,434,140 lekë**.

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Belsh në “Ujësjellës Kanalizime Belsh” Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2018, 2019 dhe 2020, në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

Në këtë rast, investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) **45,434,140 lekë** dhe Investitori është Bashkia Belsh. Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **45,434,140 lekë** përbën mos pasqyrim të informacionit financiar. Kjo situatë është në kundërshtim UMF nr. 5 me disa ndryshime në UMF nr. 8 datë 28.02.2022 për Përgatitjen e programit afata mesem Vendore 2023-2025, UMF nr. 64 datë 22.07.2014, “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, duke deformuar informacionin financiar përsa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 dhe 2019 të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,3, faqe 55-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Bashkia Belsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të marrin masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Belsh” SHA me vlerë kontabël 45,434,140 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi : Nga analizimi i llog. 202 “*Studime dhe kërkime*”, rezulton se nuk është përfshirë vlera e dy projekteve prej 15,693,844 lekë 15,693,844 lekë, *konkretisht:*

1. Projekti i objektit “*Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Seferan*”, me vlerë 12,450,730 lekë, si dhuratë me akt dhurimin nr. 2748 datë 29.10.2018, projekt i cili nuk është bërë hyrje në magazinë dhe të paraqitej te pasqyra e pozicionit financiar.

2. Projekti me objekt “*Sistemim dhe ndërtimi i terreneve sportive në shkollën 9-vjecare Grekan*”, lidhur në datën 23.05.2019 në vlerën 3,243,114 lekë, si dhuratë me marrëveshje bashkëpunimi nr. 667 datë 26.02.2019, projekt i cili nuk është bërë hyrje në magazinë dhe nuk është paraqit në pasqyra e pozicionit financiar.

Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 57 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,4, faqe 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillim, Kontroll Territorit të marrë masa për rivlerësimin e 2 projekteve të dhuruara duke regjistruar në kontabilitet në llogarinë nr. 202 “*Studime dhe Kërkime*”, ose nëse ato janë vënë në zbatim të kapitalizohen me vlerën e objektit sipas llogarive përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, u konstatua se në procedurën e prokurimit me objekt “Pemë Dekorative për vitin 2022”, kriteret e veçanta të dokumenteve të tenderit nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, si dhe nuk janë të argumentuara teknikisht, veprime në kundërshtim me nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu në procedurën e prokurimit me objekt “Fuqizimi i ofertës turistike me anë të zgjidhjeve ekologjike, blerje mjete motorike”, me fond limit 6,666,400 lekë, operatori ekonomik A. Z. SHPK është kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit, veprime në kundërshtim me nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 3, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2023, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. **Operatori i shpallur fitues A. Z. shpk nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të DST në lidhje me punët e ngjashme.** A. Z. shpk ka dorëzuar një kontratë për punë të ngjashme me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit të Bashkisë Tiranë, në vlerën 1,230,000 lekë pa TVSH, e cila është nën fashën minimale prej 20%(1,333,280 lekë). Po, ashtu ka përcjellë disa fatura tatimore fotokopje për mallra motoçikleta që nuk lidhen me natyrën e mallrave të prokuruar. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues **operatori A. Z.”, P.F, ku ka mangësi në dokumentacionin sipas specifikimeve teknike.** Veprime jo në përputhje me VKM nr.285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 pika *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 68-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa për eliminimin e vendosjes së kriterëve të veçanta në dokumentet e tenderit, të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, si dhe shmangien e kualifikimit dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit.

-Njësia e hartimit të dokumentacionit, komisioni i vlerësimit të ofertave të marrë masa që të përfshijë vlerën numerike minimale për punë të ngjashme, ku të vlerësohet edhe përputhshmëria e punimeve të kryera me natyrën e objektit të investimit të prokuruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim Transporti me autobus për aktivitet artistik-kulturor në Poloni” me fond limit 1,000,000 lekë pa t.v.sh për ansamblin “Folklori ndër breza” u konstatua se nuk ishte bashkëlidhur i gjithë dokumentacionit për kryerjen e këtij shërbimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4,3, faqe 82-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financave së bashku me Drejtorinë e Shërbimeve në Bashkinë Belsh, të marrin masa që për çdo Procedurë Prokurimi të bashkëngjisë dokumentacionin justifikues për kryerjen e shërbimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Belsh janë transferuar 13 ekonomi pyjore/kullosore. Nga këto janë regjistruar vetëm 7 ekonomi pyjore, ndërsa 6 ekonomi, nuk janë regjistruar në DVASHK Belsh, veprime në kundërshtim me VKM-së,

nr. 433 datë 08.06.2006 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit”, të ndryshuar. Gjithashtu nga Sektori i Pyjeve nuk janë marrë masa për të miratuar plane mbarështimi për menaxhimin e tyre me qëllim dhënien në përdorim, sipas parashikimeve të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” dhe Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 43-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve/Kullota, të marri masa për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim dhe regjistrimin e ekonomive pyjore, si dhe të një numri të madhe të pronave të pa inventarizuara dhe të pa reregjistruara, çka bën të pa qartë numrin e pronave sipas listave të inventarëve, pronë të bashkisë, për verifikim në terren në nëse këto prona janë të lira të zaptuara ose dhe të tjetërsuara nga palë të treta.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, miratimi i procedurave të lejeve të ndërtimit, në tre raste nuk është kërkuar mendimi i të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, më konkretisht: -Për objektin “Objekt banimi 2 kate dhe 1 kat nëntokë”, (nuk është kërkuar mendimi i AKM); -Për objektin “Banesë 2 kate me çati të pashfrytëzueshme +podrum”, (nuk është kërkuar mendimi i AKM);-Për objektin “Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore“ (nuk është kërkuar mendim Këshillit Kombëtar të Territorit), kjo në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 21.

po në 3 raset e audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, më konkretisht:

-Për objektin “Objekt banimi 2 kate dhe 1 kat nëntokë”;

-Për objektin “Banesë 2 kate me çati të pashfrytëzueshme +podrum”;

-Për objektin “Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore”, mungon studimi sizmik dhe gjeologjik, kjo në kundërshtim me VKM nr. 1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi", pika 5.

-për lejet e ndërtimit dokumentacioni i pronësisë i ngarkuar në sistem për aplikimin nuk ishte i plotë. Kartela e pasurisë nuk ishte e 3-mujorit të fundit, më konkretisht:

-Për objektin " Objekt banimi 2 kate dhe 1 kat nëntokë", kartela e pasurisë nuk është e 3-mujorit të fundit;

-Për objektin "Objekt 1 kat për përpunimin e produkteve bujqësore", kartela e pasurisë nuk është e 3-mujorit të fundit, kjo në kundërshtim me VKM 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 15, pika 1.b.(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 81-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1.Rekomandimi:Nga DPKZHT Belsh, të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

- Nga DPKZHT të merren masa për të kërkuar studimin sizmik dhe gjeologjik të projektit, në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi.

- Nga DPKZHT Belsh të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për procedurat e miratimit të certifikatave të përdorimit, në 2 raste, dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me certifikatë përdorimi nuk është i plotë, më konkretisht:

-Për objektin “Certifikatë përdorimi për godinë shërbimi 1 kat, fabrika përpunimi të ullirit dhe kantinë për prodhimin e rakisë”, mungon akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane.

-Për objektin “Ndërtim magazinë 1 kat+ndërtim ekspozite 2 kat”, mungon akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane.

-Për objektin “Prishja e banesës ekzistuese 1 kat +ndërtim i objektit të ri 2 kat” mungon akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane, kjo në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 81-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandimi: Bashkia Belsh dhe DPKZHT të marrë masa të mos miratojë asnjë certifikatë përdorimi deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 68, datë 24.12.2021, i ndryshuar “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Belsh”, struktura e IMTV Belsh përbëhet nga 2(dy) punonjës me detyrë inspektor dhe 1(një) përgjegjës sektori. Nga ana e Bashkisë Belsh për periudhën objekt auditimi janë bërë përkatësisht 2 (dy) shpallje për 2 (dy) pozicione inspektorë, përkatësisht shkresa me nr. 2076 prot., datë 25.07.2022 dhe shkresa me nr.888 prot., datë 24.03.2022. Në 2 kërkesat e bashkisë Belsh drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit citohet se “*bashkia Belsh ka vendosur të shpallë procedurën e konkurrimit për grupin e pozicioneve të shpallura për konkurrim “ lloji i diplomës Shkenca inxhinierisë” në Shkencat e Natyrës dhe diploma e nivelit Bachelor në “Shkenca e Natyrës”*. Për të dyja shpalljet e publikuara nuk ka patur kandidatë fitues.

Nga auditimi u konstatua se bashkia Belsh ka kufizuar kriterin e diplomës vetëm në shkenca inxhinierisë ,duke përjashtuar arsimin e lartë në fushat e drejtësisë, arkitekturës, urbanistikës etj, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.9780, datë 06.07.2007 “ Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme “, i ndryshuar neni 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 92-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh të marrë të gjitha masat për të plotësuar strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, me procedurë konkurrimi, ku fusha e arsimit të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ,Bashkia BELSH nuk i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullësor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore të mbetura.

Gjithashtu, nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, si dhe nuk është kërkuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme. Bashkia Belsh nuk ka asnjë kontratë të nënshkruar me subjektet që ushtrojnë veprimtari të kryerjes së operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit, në fondin pyjor nuk është vepruar në zbatim të pikave 3 e 4 të nenit 25 “Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar” të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa dhe të vendosë marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale duke aplikuar tarifatat dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se janë kryer shpenzime të shtuara për institucionin, si marrja e një makine me qira për nevojat e administratës ndërkohë nuk janë

vënë në funksion automjeteve të cilat janë në pronësi të tij. *Më hollësisht trajtuar në pikën 4,1, faqe 38-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

